

AUTORITETET RREGULLUESE TË MEDIAVE DHE PLURALIZMI MEDIATIK PUBLIKIM RAJONAL



Liria e shprehjes dhe liria e mediave në
Evropën Juglindore

www.coe.int/en/web/freedom-expression

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

AUTORITETET RREGULLUESE TË MEDIAVE DHE PLURALIZMI MEDIATIK PUBLIKIM RAJONAL

Autore/Redaktore:

Asja Rokša-Zubčević

Kontribues:

Jadranka Vojvodić

Magdalena Davidovska-Dovleva

Maida Ćulahović

Mirand Tafarshiku

Robert Tomljenović

Sami Nezaj

Saša Simović

dhe

Iva Nenadić

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

**Regional publication
MEDIA REGULATORY AUTHORITIES
AND MEDIA PLURALISM**

Author/Editor: Asja Rokša-Zubčević
Contributors: Jadranka Vojvodić,
Magdalena Davidovska-Dovleva,
Maida Čulahović, Mirand Tafarshiku,
Robert Tomljenović, Sami Nežaj,
Saša Simović and Iva Nenadić.

Ky publikim është përgatitur në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022", dhe projekti "Liria e shprehjes dhe liria e medias në Evropën juglindore (JUFREX 2)" dhe "Liria e shprehjes dhe liria e mediave në Kosovë *¹ (JUFREX 2)".

Riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë) është i autorizuar, përveç Qeëllimeve komerciale, përderisa ruhet integriteti i tekstit, pjesa e shkëputur nuk përdoret jashtë kontekstit, nuk ofron informata të paplota ose nuk çorienton lexuesin lidhur me natyrën, fushëveprimin ose përmbajtjen e tekstit. Teksti burimor duhet gjithnjë të njihet si në vijim: "©Këshilli i Evropës, viti i publikimit".

Të gjitha kërkesat tjera lidhur me riprodhimin/perkthimin e tërë dokumentit apo pjesëve të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë për Komunikim, Këshilli i Evropës F-67075 Strasbourg Cedex or publishing@coe.int).

© Këshilli i Evropës, maj 2021
Të gjitha të drejtat e rezervuara. Licencuar sipas kritereve të Bashkimit Evropian.

Foto: Shutterstock

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu janë përgjegjësi e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merren si pasqyrim i qëndrimit zyrtar të asnjërës palë.

* Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

“Nëse i gjithë njerëzimi, me përjashtim të një personi, do të ishte i një mendimi, njerëzimi nuk do arsyetohej që ta heshte atë person, më shumë se që do të arsyetohej ai person, po ta kishte fuqinë, që ta heshte gjithë njerëzimin.”

John Stuart Mill

Tabela e përmbajtjes

Mirënjohje	6
Përmbledhje ekzekutive	7
Lista e shkurtesave	10
1. Hyrje	11
2. Të kuptuarit e pluralizmit mediatik dhe rëndësisë së tij	13
3. Korniza legjislative dhe institucionale për pluralizëm mediatik	17
4. Pluralizmi mediatik dhe roli i autoriteteve rregullatore të medias	25
5. Shikimi përpara - nga transmetimi te algoritmet	41
6. Rekomandime dhe konkluzione	46
Shtojcat	
Shtojcat 1: Vështrim i përgjithshëm i kornizës ligjore të vendeve pjesëmarrëse	55
Shtojcat 2: Raste që lidhen me pluralizmin e mediave	99
Shtojcat 3: Masat legjislative të parashikuara	110
Bibliografia dhe Burimet	115

Mirënjohje

Këshilli i Evropës dëshiron të falënderojë autoritetet kombëtare rregullative në fushën e medias elektronike nga Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia për përfshirjen e tyre në përgatitjen e këtij publikimi. Falënderim dhe mirënjohje e veçantë i takon Asja Rokša - Zubčević për autorësinë e këtij botimi dhe bashkërendimin e kontributeve nga përfituesit e projektit.

Po ashtu, mirënjohje për përfshirjen e tyre u shprehet edhe pjesëmarrësve të tjerë nga autoritetet rregullative të mediave kombëtare: Iva Nenadić, Jadranka Vojvodić, Magdalena Davidovska - Dovleva, Maida Čulahović, Milan Todorović, Mirand Tafarshiku, Robert Tomljenović, Sami Nezaj, Sara Xhumbari dhe Saša Simović.

Ashtu si në aktivitetet e mëparshme, bashkëpunimi i autoriteteve rregullatore të medias nga ky rajon, i cili karakterizohet nga përkushtimi, iniciativa, përgjegjshmëria dhe puna në ekip, shoqëruar me marrëdhëniet e ngushta dhe miqësore midis kolegëve, ka rezultuar në krijimin e këtij botimi të vlefshëm.

Veç kësaj, Këshilli i Evropës dëshiron ta falënderojë Iva Nenadić për kontributin e saj dhe ekspertizën e çmueshme, që në mënyrë të veçantë i ka dhënë vlerë shtesë kontekstit të synuar të këtij publikimi.

Përmbledhje ekzekutive

Inciativa “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, është një program bashkëpunimi, me fushëveprim që lidhet me këshillat e ekspertëve për çështjet legjislative dhe të politikave, përfshirë vlerësimin e përafrimit të legjislacionit dhe/ose dokumenteve të politikave me standardet e Këshillit të Evropës, në fusha të ndryshme, përfshirë lirinë e shprehjes dhe mediave. Përfituesit e këtij projekti përfshijnë, mes tjerash, autoritetet rregullatore të medias nga Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Brenda fushëveprimit të projektit, përfituesit pranojnë rëndësinë e temës së pluralizmit mediatic si tipar i rëndësishëm demokratik për t’u zhvilluar dhe ruajtur, pasi përfaqëson një përbërës thelbësor të skeletit demokratik¹. Kjo është arsyeja pse është rënë dakord të përgatitet ky botim, i cili adreson çështjen e pluralizmit të mediave duke e parë atë përmes prizmit të standardeve evropiane, kornizave legjislative dhe institucionale, praktikës ekzistuese dhe masave të propozuara drejt rritjes së diversitetit, si dhe rolit dhe aktiviteteve të autoriteteve rregullatore të medias në këtë fushë.

Ky botim vëren se peizazhi bashkëkohor i medias nëpër botë duket të ketë ofertë të pasur (i ndihmuar nga përparimet teknologjike që zhvillohen me një ritëm të shpejtë), por efektet aktuale ndaj pluralizmit dhe diversitetit të medias duket se janë jashtëzakonisht të pafavorshme, me polarizime të qarta dhe të rrezikshme dhe paradigmat e tregut mediatic të karakterizuara nga efekti i tyre negativ në premisat themelore të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe rrezikimin e përgjithshëm të strukturës demokratike. Për fat të keq, gjatë pandemisë COVID-19, këto çështje janë bërë gjithnjë e më problematike dhe kanë treguar fuqinë e keqkuptimeve, dezinformimit dhe manipulimit. Shoqëritë janë gjetur në një krizë të pluralizmit dhe vlerave demokratike, e cila demonstroi nevojën për të adresuar kërcënimet ndaj proceseve demokratike duke zbatuar në mënyrë aktive dhe efektive aktivitete për të trajtuar këto probleme. Brenda këtij konteksti, politikat e medias synojnë të mbrojnë dhe promovojnë shumëllojshmërinë e shprehjeve kulturore duke futur botën elektronike nën petkun e saj me synim krijimin e kushteve të favorshme për mbrojtjen dhe promovimin e larmisë së shprehjeve kulturore.

Publikimi ka gjetur që mekanizmat legjislativë dhe rregullatorë në lidhje me pluralizmin e mediave në këtë rajon nuk kanë arritur të kalibrohen në realitetet e tanishme të medias digjitale, të cilat ende janë të përcaktuara për mjedisin e mediave

1 Ndonëse Kroacia nuk është përfituese e projektit, Agjencia kroate për media elektronike merr pjesë në aktivitetet e JUFREX 2, duke shkëmbyer përvojat e veta dhe përkrah kolegët në rajon.

analoge dhe, ndonjëherë, me natyrë të rregullimit të tepërt, ndërsa në praktikë ato nuk duket se ndryshojnë mjedisin mediatik. Karakterizuar nga një bollëk mediash, rajoni thuhet se ka mungesë diversiteti, por mungon një metodë e qëndrueshme dhe e unifikuar e matjes. Autoritetet rregullatore të mediave përfituese merren kryesisht me çështjet e pronësisë së mediave të licencuara.

Mekanizmat rregullues të përmbajtjes për shërbimet mediatike lineare dhe jolineare janë vendosur dhe implementuar, me hapat fillestarë drejt krijimit të mekanizmave bashkërrregullues. Transmetuesit publikë ekzistojnë, por ndonjëherë, duket se janë shumë të politizuar. Përmbajtja e mediave kombëtare tejkalon kufijtë dhe shpërndahet në të gjithë rajonin. Disa media të lajmeve me pronësi të huaj janë të pranishme dhe ofrojnë mbulim kombëtar si dhe rajonal të lajmeve. Ekzistojnë shembuj të dukshëm të iniciativave drejt veprimtarive për edukim medial dhe informues dhe fondeve të pluralizmit mediatik. Janë vërejtur masa të ndryshme mbështetëse për përfituesit gjatë pandemisë COVID-19 dhe kjo duhet përgëzuar. Megjithatë, ekziston një mungesë e theksuar e transparencës së plotë të pronësisë së mediave dhe institucionet përkatëse shtetërore të ngarkuara me çështjet e konkurrencës kanë ngecur në zbatimin e çështjeve të lidhura me përqendrimin e mediave. Përderisa mediat tradicionale ende mbahen të forta, rajoni po përjeton gjithashtu oferta të reja mediatike, me përgjigje ligjore dhe rregullatore ndaj sfidave për pluralizmin aktual të mediave qysh në fillimet e tyre. Me transpozimin e AVMSD-së së rishikuar, e cila është e detyrueshme për të gjitha shtetet e përfituesve, ato do të drejtohen në fushën e rregullimit të mediave elektronike (online), megjithëse të kufizuara në shtrirje dhe qëllim.

Informatat e marra nga autoritetet rregullatore të mediave për qëllimin e këtij botimi sugjerojnë që politikat përkatëse në të gjithë rajonin duhet të parashikojnë rregullim të paanshëm dhe të bazuar në prova, zbatim të pajtueshmërisë me ligjin dhe standarde profesionale, si dhe të mekanizmave efektivë vetërrregullues dhe bashkërrregullues në kombinim me krijimin e matjeve të rregullta të pluralizmit të mediave. Duhet të kërkohet qëndrueshmëria e mediave të pavarura dhe profesionale të shërbimit publik, së bashku me zhvillimin e mëtejshëm të bazave transparente dhe të barabarta të tregut për të gjithë aktorët privatë dhe publikë dhe forcimin e transparencës së pronësisë së mediave dhe parandalimin e efekteve negative të përqendrimit të mediave. Për sa i përket përmbajtjes mediatike, rregullimi nuk duhet të ndërlihdet vetëm me përqindje dhe kuota, por me përqendrimin e nevojshëm në dimensionin cilësor duke zbatuar masa për të siguruar përmbajtje cilësore. Roli i rregullatorëve mund të ndryshojë nga nxitja e skemave të financimit, siç është bërë në disa vende të rajonit, deri te sigurimi i dominimit të përmbajtjes me vlerë të shërbimit publik.

Përkitazi me platformat elektronike, është bërë e qartë se një lloj moderimi i përmbajtjes po bëhet i nevojshëm, por duhet të jetë proporcional dhe në përputhje me parimet e lirisë së shprehjes. Një sistem i drejtë dhe transparent i subvencioneve publike për media sugjerohet të zhvillohet më tej, në mënyrë që të nxisë integritetin profesional të gazetarëve dhe edukimin medial. Një përpilim i duhur (i ekuilibruar) i fondeve të ndryshme, transparenca e pronësisë dhe parandalimi i përqendrimit duhet të rregullohen dhe të zbatohen në mënyrë efikase. (Ri)përkufizimi i rolit të ARM-ve në fushën e monitorimit dhe zbatimit të parandalimit dhe financimit të

përqendrimin dhe/ose transparencës së pronësisë duhet të formulohet me kujdes. Ai duhet të plotësojë rolet dhe detyrimet e autoriteteve të tjera kompetente (p.sh., mbrojtja e konkurrencës) dhe të sigurohet nga burimet e nevojshme njerëzore dhe fuqitë efektive të zbatimit. Duke pranuar rëndësinë e nismave për edukim medial dhe të skemave vetërregulluese dhe bashkërregulluese, aktet legjislative në të gjithë rajonin duhet të përcaktojnë objektivat e bashkërregullimit dhe rolin e qartë të ARM-ve dhe organeve të bashkërregulluese të përfshira në proces, si dhe në nismat e edukimit medial.

Nevoja dhe rëndësia e bashkëpunimit të ARM-ve në të gjitha nivelet (rajonale dhe veçanërisht në nivelin ndërkombëtar) me përfshirjen e të gjithë palëve të interesit, është thelbësore dhe jetike për zhvillimet dhe përmirësimet e mëtejshme në këtë drejtim. Përfituesit ndjekin zhvillimet në masat e propozuara evropiane dhe masa të tjera (supra) nacionale paralele me ato nga AVMSD-ja e rishikuar (p.sh., procesi i vazhdueshëm në lidhje me Aktin e Shërbimit Digjital të BE-së) dhe propozime të ndryshme rregullatore kombëtare. Ndonëse të vogla për sa i përket matjes së treguesve të tregut, ARM-të nga ky rajon duhet të kenë ndikim në atë që është një trend i dukshëm drejt ndryshimeve strukturore që ndodhin në horizontin e politikave publike në lidhje me liritë e mediave.

Ka shumë punë për të bërë në periudhën e ardhshme, gjë që kërkon vullnet politik dhe një qasje gjithëpërfshirëse. Të gjitha palët e interesit, nga ligjvënësit kombëtarë dhe qeveritë deri te organizatat supranacionale dhe ndërkombëtare duhet të përfshihen në përpjekjet për të ruajtur pluralizmin e mediave. Për më tepër, interesat e tregut duhet patjetër të plotësohen me interesa të të drejtave të njeriut, dhe t'i kushtohet më shumë vëmendje interesit publik. Në këtë aspekt, parimet e të drejtave të njeriut duhet të ofrojnë udhëzime të qarta për drejtimin në të cilin ligjet, rregulloret dhe veprimet e politikave do të adresonin në mënyrë efektive sfida të ndryshme aktuale dhe të ringjallnin pluralizmin e medias. Prandaj, ky botim ofron një ndryshim në përqafimin e politikave publike dhe një qasje bashkëpunuese kombëtare dhe ndërkombëtare për këto çështje, ku nevojitet një mori e madhe akterësh dhe palësh të interesuara. ARM-të, qeveritë dhe parlamentet, komisionet zgjedhore dhe agjencitë për mbrojtjen e të dhënave, së bashku me mediat, akademinë dhe verifikuesit e fakteve dhe platformat në internet kanë nevojë për përpjekje të përbashkëta për të përmirësuar demokracinë duke rindërtuar besimin në proceset demokratike dhe duke qëndruar larg censurës. Përderisa e bëjnë këtë, shoqëritë duhet të sigurohen që të mos hyjnë në fushën e shtypjes së mediave digjitale, duke respektuar të drejtat dhe liritë, dhe duke u përpjekur që në mënyrë të kujdesshme, të hapur dhe të sinqertë të krijohen zgjidhje të qëndrueshme.

Lista e Shkurtesave

- AEM HR – Agjencia për Media Elektronike, Kroaci
- AEM ME – Agjencia për Media Elektronike, Mali i Zi
 - AMA – Autoriteti i Mediave Audiovizive, Shqipëri
 - AVM – Media Audiovizive
- AVMSD – Direktiva e Shërbimit të Mediave Audiovizive
 - AVMU – Agjencia për Shërbime të Mediave Audio dhe Audiovizive, Maqedonia e Veriut
- Përfituesit – Përfituesit e JUFREX: Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia ndërsa janë përfitues - në kontekstin e këtij publikimi u referohet autoriteteve rregullatore të mediave që marrin pjesë në këtë projekt
- CMPF – Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias
 - KiE – Këshilli i Evropës
 - CRA – Agjencia Rregullative e Komunikimit, Bosnjë dhe Hercegovinë
 - KE – Komisioni Evropian
- KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- GjEDNj – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
 - BE – Bashkimi Evropian
 - TIK – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
 - KMC – Komisioni i Pavarur për Media, Kosovë*
 - MPM – Monitorues i Pluralizmit të Mediave
 - MRA – Autoriteti Rregullativ për Media
- MSI-MED – Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Pluralizmin e Mediave dhe Transparencën e Pronësisë së Mediave
- MSI-REF – Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Mjedisin dhe Reformën në Media
 - OTT – Platformat përmes internetit (over-the-top)
 - REM – Autoriteti Rregullator për Media Elektronike, Serbi
 - RTSH – Radio Televizioni Shqiptar
- UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
 - VOD – Video sipas kërkesës
 - VSP – Platforma e Ndarjes së Videove
 - RTV – Radio dhe Televizion
 - RTS – Radio Televizioni Publik i Serbisë

1. Hyrje

“Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, u mundëson përfituesve të përmbushin agjendat e tyre të reformës në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe në përputhje me standardet evropiane, duke përfshirë aty ku është e nevojshme brenda kornizës së procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program tre-vjeçar përfshinë veprime në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Serbi, Turqi si dhe në Kosovë* dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës nga maji i vitit 2019.

Nën këtë ombrellë, veprimi “Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Evropën Jug-Lindore (JUFREX)”, i cili bazohet në projektin e mëparshëm “Forcimi i ekspertizës gjyqësore për lirinë e shprehjes dhe mediave në Evropën Juglindore” (JUFREX), mbështetë bashkëpunimin e frytshëm të agjencive rregullatore të mediave (ARM-ve) përmes ngjarjeve rajonale dhe publikimeve të përbashkëta. Gjatë konferencës së organizuar në shtator 2019, u ra dakord për të përgatitur një publikim që pasqyron formatin e dy publikimeve të mëhershme: Autoritetet rregullatore të mediave dhe gjuha e urrejtjes² dhe autoritetet rregullatore të medias dhe mbrojtja e të miturve³. Këtë herë, ARM-të vendosën të trajtojnë çështjen e pluralizmit të mediave duke e parë atë përmes prizmit të standardeve evropiane, kornizave legjislative dhe institucionale, si dhe roleve, përgjegjësi dhe aktiviteteve të autoriteteve rregullatore të mediave në këtë fushë, duke prezantuar praktikat ekzistuese dhe duke promovuar vlerat evropiane, si dhe duke treguar shembuj pozitivë në këtë fushë. Për të mbledhur kornizat dhe praktikat kombëtare, redaktorja ka përgatitur një pyetësor për përfituesit, duke lehtësuar mbledhjen e informacioneve përkatëse⁴.

Ky publikim është në dispozicion në të dy formatet: elektronike dhe të shtypur dhe ndonëse është shkruar në anglisht, ai do të përkthehet në gjuhët e të gjithë përfituesve të JUFREX.

Ai do të ndahet me përfaqësuesit e degëve gjyqësore kombëtare të përfituesve dhe do t’u shpërndahet gjerësisht palëve të ndryshme të interesit, përfshirë parlamentet, institucionet akademike, organet vetërregulluese dhe gazetarët.

2 <https://rm.coe.int/media-regulatory-authorities-and-hate-speech/16807338f5>.

3 <https://rm.coe.int/media-regulatory-authorities-and-protection-of-minors/1680972898>.

4 SHËNIM: Ky publikim është përgatitur gjatë vitit 2020, por është përditësuar më tej në prill të vitit 2021, duke përfshirë përditësime shtesë të marra nga përfituesit, për të pasqyruar dhe përfshirë ndryshimet që mund të kenë ndodhur që nga mbledhja origjinale e të dhënave përkatëse dhe duke marrë parasysh faktin që të gjithë përfituesit janë aktualisht në procesin e transpozimit të AVMSD-së së rishikuar.

Qëllimi kryesor i këtij botimi është t'i kontribuojë të kuptuarit më të mirë të konceptit të pluralizmit mediatik, rëndësisë dhe ndërlidhjes me politikën institucionale dhe rolin kyç të ARM-ve në këtë fushë. Ai po ashtu thekson nevojën për të përfshirë palë të ndryshme të interesit për të nxitur një mjedis të pasur mediatik si te mediat tradicionale ashtu edhe ato elektronike (offline dhe online) për të siguruar larminë e mendimeve dhe zërave, ndërsa adreson masat për të shmangur një përqendrim mediash që mund të dëmtojë pluralizmin e mediave dhe të zbehë të drejtën për liri të shprehjes. Ai duhet të përfaqësojë një mjet të dobishëm dhe të rëndësishëm në aktivitetet e mëtejshme jo vetëm të organeve rregullative, por brenda fushës më të gjerë të palëve të interesit në shoqëri.

2. Të kuptuarit e pluralizmit mediatik dhe rëndësisë së tij

Pyetja kryesore për pluralizmin është: “Si shpërndahen fuqia dhe ndikimi”. Përderisa grupe individësh përpiqen të maksimizojnë interesat e tyre, është bashkëjetesa e interesave të shumëllojshme dhe konkurruese që përbën bazën për një ekuilibër demokratik. Pluralizmi mediatik, në një kuptim shumë të thjeshtë dhe pa marrë parasysh dimensionin ekonomik, nënkupton larminë e zërave, mendimeve dhe çështjeve të debatuar publikisht, por edhe shumësinë e mediave dhe bashkëjetesën (sidomos në kontekstin evropian) të mediave publike, private dhe të komunitetit. Ky publikim me qëllim ka lënë jashtë referencat dhe përqendrimin në dimensionet ekonomike të pluralizmit mediatik, duke u përqendruar në larminë e zërave dhe mediave, duke pasur parasysh faktin se një botim tjetër i Këshillit të Evropës: “Pluralizmi i pronësisë së Mediave në mjedisin e ri të mediave⁵”, i përgatitur fillimisht për AVMU, autoritetin rregullator të mediave në Maqedoninë e Veriut, por duke përfshirë informacionin nga përfituesit, mbulon aspektet ekonomike dhe të biznesit. Është një term që nënkupton pluralizmin brenda mediave po aq sa brenda vetë shoqërive.

Pluralizmi mediatik është i lidhur me larminë e pronësisë së medias, dhe për këtë arsye, parandalimin e përqendrimit të medias. Kjo është një linjë logjike dhe e domosdoshme e të menduarit pasi mediat kanë rëndësi thelbësore kulturore dhe shoqërore. Aspekti ekonomik/afarist, si dhe çështjet e përqendrimit që lidhen me pluralizmin e medias gjithashtu kanë domethënie të madhe, por ky publikim është hartuar për t’u përqendruar në aspektet kulturore/shoqërore/politike dhe ligjore të pluralizmit të medias dhe mëton të qëndrojë larg çështjeve të biznesit dhe përqendrimit sa më shumë që të jetë e mundur. Pa dyshim se sektori i medias kontribuon në formësimin e identiteteve dhe vlerave të projektit, përveç që është sektor i biznesit dhe nxitës i inovacionit. Andaj, natyra e të mirave dhe shërbimeve mediatike është komplekse dhe nuk mund të përkufizohet vetëm si të mira kulturore dhe as thjesht si të mira ekonomike. Në mënyrë të pashmangshme, kushtet e tregut ndikojnë shumë në gjendjen e pluralizmit mediatik, veçanërisht kohët e fundit, kështu që një prejke e lehtë e këtyre çështjeve do të sigurohet më tej në tekst.

5 <https://rm.coe.int/hf37-study-media-ownership-eng/16809f0272>.

Nocioni i rëndësisë së fjalës së lirë dhe një shumësi zërash dhe mendimesh daton qysh para shumë kohësh. Mes tjerash, John Milton do të argumentonte, në kundërshtimet e tij për licencimin/censurimin para publikimit se mungesa e pikëpamjeve dhe ideve të ofruara për njerëzit dobësojnë aftësinë e tyre për të njohur dhe konfirmuar të vërtetat duke përdorur arsyen e tyre. Ai besonte se të vërtetat duhet të njihen me përdorimin e arsyes sesa me pranimin e autoritetit: *“po të mos ketë një sfond të gjerë idesh, përfshirë disa ide false, për debat racional, aftësia e njerëzve për të arsyetuar nuk do të lulëzojë”*⁶ Milton, si John Stuart Mill, Thomas Jefferson dhe mbështetës të tjerë të konceptit të tregut të lirë të ideve mbështeteshin në premisën e arsyes dhe racionale. Sipas mendimit të Mill: *“nëse njerëzit nuk lihen të jetojnë ashtu siç dëshirojnë në mënyrën që e zgjedhin; civilizimi nuk mund të përparojë; e vërteta nuk do të dalë në dritë për mungesë të një tregu të lirë të ideve... Shoqëria do të shtypet nga pesha e “mediokritetit kolektiv””*⁷. Megjithatë, ai po ashtu thekson se një luftë zhvillohet gjithmonë midis kërkesave konkurruese të autoritetit dhe lirisë. Ai pohonte se ne nuk mund ta kemi këtë të fundit pa të parën pasi që: *“E gjitha që e bën ekzistencën të vlefshme për këdo varet nga zbatimi i kufizimeve ndaj veprimeve të njerëzve të tjerë. Prandaj, disa rregulla të sjelljes duhet të caktohen - me ligj në radhë të parë dhe përmes pikëpamjeve për shumë gjëra që nuk janë subjekte të përshtatshme për funksionimin e ligjit”*⁸ Bota e sotme, ashtu si epokat e tjera në histori, tregon shenja të një bollëku të inferioritetit si për nga meritat ashtu edhe arsyet, duke filluar, për shembull, nga rritja në rrjete sociale e numrit të atyre që besojnë se toka është e rrafshët në shekullin XXI deri te një sërë këshillash të pakonceptueshme për “shërimin” e COVID-19, si pirja e zbardhuesve, etj. Kjo e bën edhe më të fortë rastin për të theksuar rëndësinë e pluralizmit mediatic, por edhe miratimin dhe zbatimin e politikave rreth tij.

Nocione komplekse, si pluralizmi mediatic, shpesh duhet të shpjegohen me çfarë ato mbulojnë, përfshijnë dhe referohen, të cilat do të provohen edhe këtu. Pa ndonjë pretendim për të ofruar një përkufizim të qëndrueshëm, ky publikim thjesht do të theksojë se pluralizmi mediatic është një mjet dhe kusht i paracaktuar i së drejtës për lirinë e shprehjes⁹.

Pluralizmi mediatic nuk ka të bëjë vetëm me shumësinë e furnizimit me media dhe shumëllojshmërinë e lajmeve dhe informacioneve që ofrohen për të gjitha audiencat, por edhe për qasjen në burime të ndryshme të lajmeve dhe ideve, pasurinë e pikëpamjeve të ndryshme dhe të ndryshme, pavarësinë editoriale të redaksive, gjithëpërfshirjen dhe një klimë politike që respekton lirinë e medias. Pluralizmi mediatic ka të bëjë me të gjitha këto gjëra kolektivisht, një bashkim i objektivave të

6 <https://www.mtsu.edu/first-amendment/article/1259/john-milton>.

7 I. Berlin, ‘Two Concepts of Liberty’, in Four Essays on Liberty, Oxford 1969. Cf. W. Galston, Liberal Pluralism, Cambridge 2002, p. 6, available at: https://cactus.dixie.edu/green/B_Readings/I_Berlin%20Two%20Concepts%20of%20Liberty.pdf.

8 Mill, J.S., On Liberty. Indianapolis: Hackett Publishing.1978.

9 Nga shumë burime të përkufizimit të pluralizmit mediatic, njëri që e mbulon më së miri është nga Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për vendet anëtare përkritazi me masat për të promovuar pluralizmin e mediave, i cili e përcakton atë si: “shumëllojshmëria e furnizimit me media, e pasqyruar, për shembull, në ekzistencën e një shumësie të mediave të pavarura dhe autonome (në përgjithësi të njohura si pluralizëm strukturor) si dhe një larmi të llojeve dhe përbajtjeve mediatiche (pikëpamjet dhe mendimet) të vëna në dispozicion të publikut”

politikave publike i krijuar për të siguruar pasurinë dhe larminë e një numri zërash dhe mendimesh. Pluralizmi mediatik është i rëndësishëm sepse është përbërës thelbësor i strukturës demokratike. Ai përfaqon pavarësinë editoriale dhe siguron një peizazh të pasur, të larmishëm dhe transparent mediatik që promovon lirinë e shprehjes që kontribuon në opinione që dalin nga informimi i mirë i publikut dhe garanton që gazetarët janë të lirë të kryejnë rolin e tyre mbikëqyrës. Pluralizmi mediatik mbështet përfaqësime të ndryshme kulturore dhe ofron mënyra të ndryshme të ndërveprimit dhe përdorimit të tij. Është jetike që njerëzit të jenë në gjendje të gëzojnë të drejtat e tyre të njohura ligjërisht të cilat, përveç lirisë së shprehjes, përfshijnë një gamë të tërë të të drejtave dhe lirive, si e drejta për të votuar (dhe për t'u zgjedhur), e drejta e përgjigjes, e drejta e privatësisë. Fundja, pluralizmi mediatik është katalizator i dialogut publik midis shoqërisë, politikës dhe medias.

Shfaqja dhe zhvillimi i shpejtë i mediave dhe platformave të ndryshme në internet për grumbullimin dhe shpërndarjen e tyre zbuluan se pluralizmi i medias, përveç shumëllojshmërisë së burimeve dhe përmbajtjes, kërkon pa dyshim që të trajtohet edhe nga një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm: diversiteti në ekspozim - ndaj burimeve dhe përmbajtjes. Ai mbulon çështje të tilla si mundësia e zbulimit, gjetjes dhe qasjes në informacione dhe përfaqëson një aspekt që po bëhet gjithnjë e më sfidues për t'u siguruar. Asnjë nga këto aspekte nuk mund të sigurojë pluralizmin e vërtetë: është e mundur që të ketë një bollëk mediash, por shumë pak larmi përmbajtjeje, dhe gjithashtu, një bollëk burimesh që nuk janë të qasshme nga popullata. Këto gjëra, si pasojë, ndikojnë negativisht në diskursin publik.

Një nga shembujt e identifikimit të çështjeve me rëndësi për pluralizmin mediatik dhe matjen e tij është Monitorimi i Pluralizmit Mediatic¹⁰ (MPM), një mjet i zhvilluar nga Qendra për Pluralizmin e Mediave dhe Lirinë e Medias (CMPF), bashkë-financuar nga BE-ja, për të vlerësuar rreziqet për pluralizmin e medias në vendet anëtare të BE-së dhe vendet kandidatë.

Treguesit e përdorur nga MPM mbulojnë katër fusha kryesore:

- mbrojtjen themelore;
- pluralizmin e tregut;
- pavarësinë politike; dhe
- gjithëpërfshirjen sociale.

Ky instrument përmban ndryshore që mbulojnë pyetje juridike, ekonomike dhe socio-politike të matura sipas një shkalle rreziku (të ulët, të mesëm dhe të lartë). Treguesit janë përshtatur, që nga viti 2020, për të vlerësuar dimensionin tradicional dhe atë elektronik të pluralizmit mediatik. Ai me të vërtetë është përditësuar për të pasqyruar ndryshimet monumentale të krijuara nga interneti dhe mënyrat e ndryshme si bëhet grumbullimi, prodhimi, shpërndarja dhe konsumi i lajmeve dhe informacioneve (çështje që trajtohen në Kapitullin 5 të këtij publikimi). Monitori i fundit i Pluralizmit Mediatic 2020¹¹, që mbulonte periudhën 2018-2019, tregon disa tendenca shqetësuese, duke përfshirë kërcënimin në rritje të qëndrueshmërisë së

10 <https://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor/>.


11 <https://cmpf.eui.eu/mpm2020-results/>.

modeleve të biznesit të botuesve të mediave të lajmeve, të cilat ndikohen nga roli dëmtues i ndërmjetësve të internetit (motorët e kërkimit dhe rrjetet sociale) aftësia e të cilave për reklama të shënjestruara i ka larguar të ardhurat nga publikuesit e lajmeve tradicionale. Për më tepër, përqendrimi i pronësisë rrezikon pluralizmin e tregut dhe përfaqëson një rrezik të lartë të ndikimit mbi përmbajtjen editoriale nga interesat komerciale dhe të pronarëve në pjesën më të madhe të Evropës. Përqendrimi i lartë i ndërmjetësve të internetit, me dy kryesuesit që komandojnë më shumë se gjysmën e tregut në të gjitha vendet dhe dy të tretat e tregut të reklamave digjitale në shumicën e vendeve, e vë qëndrueshmërinë ekonomike të gazetarisë cilësore në rrezik të konsiderueshëm. Për më tepër, rreziqet ndaj pluralizmit të mediave shoqërohen me vëzhgime dhe kërcënime në internet për gazetarët, qasje të pamjaftueshme në internet dhe disponueshmëri të broadbendit dhe zbatim joefektiv të neutralitetit të rrjetit.

Skema e mëposhtme në Grafikon 1 parashikon një listë jo të plotë të kushteve që ndikojnë në pluralizmin mediatic dhe janë të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë në lidhje me pluralizmin mediatic, me ngjyrën e kaltër që tregon kushtet e favorshme për lulëzimin e pluralizmit mediatic, në krahasim me ato të paraqitura me të kuqe, nga treguesit e Monitorimit të lartpërmendur të Pluralizmit Mediatic.

Grafiku 1: Kushtet që ndikojnë në pluralizmin mediatic

(Frymëzuar nga kriteret e Monitorimit të Pluralizmit Mediatic)



3. Korniza legjislative dhe institucionale për pluralizëm mediatik

Një kornizë ligjore dhe institucionale që mbron pluralizmin e mediave është e pranishme në të gjitha nivelet e politikave dhe qeverisjes, nga legjislacionet kombëtare deri te nivelet supranacionale dhe ndërkombëtare. Duke qenë të shumta si për nga vëllimi ashtu edhe nga substanca për përshkrim të holësishëm, disa prej tyre janë përmendur shkurt në vazhdim, në një listë jo të plotë.

BASHKIMI EVROPIAN

Pluralizmi mediatik kodifikohet me nenin 11 të Kartës Evropiane për të Drejta Themelore¹², i cili, përveç garantimit të së drejtës për lirinë e shprehjes, parasheh edhe respektimin e lirisë dhe pluralizmit të mediave. Komisioni Evropian e vendos këtë temë lart në rendin e ditës, duke u përqendruar në aktivitete të shumta në këtë drejtim. Për shembull, Komisioni Evropian ka lehtësuar krijimin e Qendrës Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias (ECPMF)¹³ misioni i së cilës është të promovojë, ruajë dhe mbrojë pluralizmin mediatik. Ai bashkë-finanon Qendrën e lartpërmendur për Pluralizmin e Mediave dhe Lirinë e Medias (CMPF)¹⁴, që synon të zhvillojë linja inovative dhe relevante të kërkimit përkitazi me lirinë e medias dhe pluralizmin në Evropë.

Në vitin 2016, Komisioni Evropian organizoi një Kolokium për të Drejtat Themelore kushtuar Pluralizmit të Medias dhe Demokracisë, duke rezultuar me publikimin e raporteve të shumta¹⁵. Këto raporte theksojnë nevojën për bashkëpunim të ngushtë dhe marrje përsipër nga të gjitha palët e përfshira për të mbrojtur dhe promovuar media të lira dhe pluraliste për të mirën e të gjithë evropianëve dhe demokracive evropiane. Veprimet e mëposhtme janë paraparë për të adresuar çështjet e pluralizmit të medias:

- Mbrojtja e lirisë dhe pavarësisë së mediave nga presioni politik;
- Ruajtja e pavarësisë financiare të mediave në Bashkimin Evropian;

12 <https://fra.europa.eu/en/eu-charter/article/11-freedom-expression-and-information>.

13 <https://www.ecpmf.eu/>.

14 <https://cmpf.eu.eu/>.

15 Për më shumë informata shih: https://ec.europa.eu/newsroom/just/item-detail.cfm?item_id=31198.

- Mbrojtja e gazetarëve dhe lirisë së tyre të shprehjes;
- Mbrojtja e gazetarëve dhe palëve të reja mediatike nga gjuha e urrejtjes;
- Mbrojtja e sinjalizuesve dhe gazetarisë hulumtuese;
- Promovimi i debatit të shëndetshëm politik dhe angazhimi i qëndrueshëm politik përmes edukimit medial, etikës mediatike dhe pluralizmit mediatik.

Në vitin 2018, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi Konkluzionet për forcimin e përmbajtjes evropiane në ekonominë digjitale¹⁶. Duke njohur që puna dhe përmbajtja e mediave, përveç fushave të tjera kreative, përfaqëson shtyllat thelbësore të zhvillimit evropian, këto Konkluzione nxjerrin në pah përparësitë politike të BE-së, në drejtim të:

- Kultivimit të diversitetit, vizibilitetit dhe inovacionit;
- Krijimit të kushteve të barabarta të punës;
- Forcimin e besimit në informacione dhe burime;
- Përmirësimin e shkathtësive dhe kompetencave.

Sipas këtyre Konkluzioneve: “Pluralizmi mediatik është i rëndësishëm për të siguruar që qytetarët të kenë qasje në një varg informacionesh dhe pikëpamjesh. Bashkëpunimi ndërkuftar midis akterëve të sektorit të medias mund të ndihmojë për të arritur një masë kritike dhe për të arritur audiencë më të gjerë. Përqendrimi i tepërt i sektorëve që prodhojnë dhe shpërndajnë përmbajtje mund të kërcënojë qasjen e qytetarëve në një varg përmbajtjesh” Përveç përfundimit se mbështetja e vazhdueshme për këtë mjet të Monitorimit të Pluralizmit të Mediave në vlerësimin e rreziqeve ndaj pluralizmit të medias në mjedisin digjital të BE-së, Konkluzionet vënë në pah nevojën për të reflektuar në lidhje me rolet në rritje të modeleve të biznesit në internet në prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes, dhe efektin e tyre në pluralizmin e medias në Evropë.

Konkluzionet e miratuara nënvizojnë më tej se pluralizmi mediatik varet nga ekzistenca e një larmie të pronësisë së medias dhe larmie të përmbajtjes dhe gazetarisë së pavarur. Pluralizmi mediatik po ashtu përfaqëson një element kryesor për të sfiduar përhapjen e dezinformimit dhe për të siguruar që qytetarët evropianë janë të mirëinformuar. Në fund, ai fton Komisionin Evropian që, mes tjerash, të vazhdojë të mbështesë projekte që mbikëqyrin lirinë e medias dhe pluralizmin e medias, dhe që ofrojnë ndihmë ligjore dhe praktike për gazetarët dhe profesionistët e mediave që përballen me kërcënime¹⁷.

Dokumenti kryesor që rregullon shërbimet e mediave audiovizive në Direktivën e rishikuar të BE-së për Shërbime e Mediave Audiovizive¹⁸ (AVMSD), e cila është duke kaluar në procesin e transpozimit në kornizat ligjore kombëtare. Në lidhje me pluralizmin e medias, AVMSD thekson disa nga nocionet e mëposhtme:

16 [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52018XG1219\(01\)&from=GA](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52018XG1219(01)&from=GA).

17 Shumë raporte dhe studime të tjera relevante publikohen dhe theksohen nga Komisioni Evropian në lidhje me këtë. Për detaje të mëtejshme ju lutem vizitoni: <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/policies/media-freedom-and-pluralism>.

18 <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2018/1808/oj>.

- Transparenca e pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediale audiovizive (Recitali 16);
- Rëndësia e duhur e përmbajtjes me interes të përgjithshëm, d.m.th., punimet evropiane (Recitali 25);
- Mekanizmat vetërregullues dhe bashkërregullues për platformat e ndarjes së videove (Recitali 49);
- Roli i autoriteteve të pavarura rregullatore në sigurimin e respektimit të objektivave, mes tjerash, të pluralizmit mediatik (Recitali 61 dhe Neni 30).

Përveç kësaj, Agjenda Digjitale e Komisionit Evropian 2010¹⁹ përmban veprime për të rritur më tej pluralizmin e medias, duke kujtuar Konventën e UNESCO-s të vitit 2005 për Diversitetin Kulturor²⁰ (ratifikuar në nivel të BE-së në vitin 2006). Ajo thekson rëndësinë e nxitjes së diversitetit kulturor dhe përmbajtjes kreative, me internetin që njihet si shtytës i pluralizmit më të madh në media: “duke u dhënë si qasje një game më të gjerë burimesh dhe këndvështrimesh, si dhe mjetesh për individë - të cilëve ndryshe mund t'u mohohet mundësia - të shprehen plotësisht dhe hapur” Konventa e UNESCO-s synon (ndër qëllimet e tjera) të mbështesë politikën dhe masat kombëtare për promovimin e krijimit, prodhimit, shpërndarjes dhe qasjes më të mirë dhe shërbimeve të ndryshme kulturore, dhe të kontribuojë në sisteme të informuara, transparente dhe pjesëmarrëse të qeverisjes për kulturën. Plani Evropian i Veprimit për Demokraci²¹, i KE-së i prezantuar në dhjetor 2020, i dizajnuar për të “krijuar demokraci më të qëndrueshme në të gjithë BE-në duke promovuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, duke forcuar lirinë e medias dhe duke luftuar dezinformimin” gjithashtu thekson rëndësinë e forcimit të lirisë dhe pluralizmit të mediave. Ai më tej u referohet veprimeve të ndryshme që duhen ndërmarrë nga Plani Evropian i Veprimit për Media dhe Media Audiovizuale²² (Mars 2021), miratuar në mënyrë që të: “nxisë mediat evropiane dhe të ndihmojë ruajtjen e autonomisë kulturore dhe teknologjike evropiane në Dekadën Digjitale”, dhe për të mbështetur pluralizmin e mediave përmes veprimeve që synojnë të rrisin qëndrueshmërinë financiare dhe rimëkëmbjen e sektorit të medias, si dhe duke ofruar mundësi për transformimin digjital të mediave.

KËSHILLI I EVROPËS

Aktivitete të shumta mbi pluralizmin e mediave kanë qenë dhe janë duke vazhduar në nivelin e Këshillit të Evropës, duke e vendosur temën si një nga përparësitë kryesore të tij. Ato janë të shumta në numër për t'i renditur të gjitha këtu, por disa vlen të përmenden.

Së pari, pluralizmi mediatik buron nga neni 10 - (E drejta për lirinë e shprehjes) së Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut²³

19 <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0245:FIN:EN:PDF>.

20 <https://en.unesco.org/creativity/convention/texts>.

21 Për më shumë detaje, shih: https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/new-push-european-democracy/european-democracy-action-plan_en#documents.

22 <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/media-and-audiovisual-action-plan>.

23 https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf.

(në tesktin e mëtejme: Konventa), një e drejtë themelore e njeriut e cila mund të ndikohet negativisht nga pluralizmi i dobësuar mediatik në një shoqëri, duke penguar gëzimin e një mjedisit të shëndetshëm dhe të fortë demokratik²⁴.

Komiteti i Ekspertëve për Pluralizmin e Mediave dhe Transparencën e Pronësisë së Mediave (MSI-MED) punoi për një periudhë dy vjeçare (2016 - 2017²⁵) për politikën dhe masat e tjera si: sigurimi i një peizazhi mediatik pluralist, transparenca e pronësisë së medias, larmia e përmbajtjes mediatike, gjithëpërfshirja në mediat e shërbimit publik, barazia gjinore në mbulimin mediatik të fushatave zgjedhore. MSI-MED doli me propozime për caktimin e standardeve në lidhje me pluralizmin e mediave dhe transparencën e pronësisë së mediave. MSI-MED po ashtu studioi dimensionet e barazisë gjinore të mbulimit mediatik të zgjedhjeve, parimet dhe rregullat në lidhje me mbulimin mediatik të zgjedhjeve dhe përdorimin e internetit në zgjedhje. Disa rezultate të rëndësishme të kësaj pune përfshijnë mekanizmat e përmendur më parë, si dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për pluralizmin e mediave dhe transparencën e pronësisë së mediave²⁶ dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rolin dhe përgjegjësitë e ndërmjetësve të internetit²⁷. Këto dokumente përmbajnë udhëzime për të forcuar transparencën e pronësisë së mediave dhe për të nxitur diversitetin në mjedisin e medias digjitale dhe për të identifikuar përgjegjësitë e ndërmjetësve të internetit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në internet.

Përderisa rekomandimi i parë përqendrohet në pluralizmin e medias dhe transparencën e pronësisë së mediave duke theksuar detyrimin pozitiv të shteteve për të siguruar media pluraliste dhe të lira, ai merr në konsideratë evolucionin e peizazheve mediatike dhe pranon që shumëllojshmëria e roleve të luajtur nga ndërmjetësit e internetit, në krijimin ose shpërndarjen e përmbajtjes, mund të ndikojë në pluralizëm dhe diversitet. Ai siguron një sërë udhëzimesh për kornizën institucionale dhe ligjore që shtetet duhet të krijojnë për të rregulluar transparencën, kontrollin dhe përqendrimin e pronësisë së mediave. Këto gjithashtu përfshijnë masa që mbështesin mediat e pavarura të shërbimit publik, mediat lokale dhe ato të komunitetit.

Rekomandimi i dytë përqendrohet në detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësve të internetit dhe, ndonëse ka pranuar rëndësinë e mënyrës se si liria e shprehjes ka përfituar nga interneti, ai gjithashtu thekson se ai ka krijuar sfida në disa fusha të tjera. Kështu, ai ofron udhëzime se çfarë duhet të bëjnë shtetet dhe ndërmjetësit e internetit për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e lirisë së shprehjes, privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave, dhe qasjes në mjet efektiv juridik.

Deklaratat e Komitetit të Ministrave nga 13 shkurti 2019 për 1) qëndrueshmërinë e gazetarisë cilësore në epokën digjitale²⁸ dhe 2) aftësitë manipuluese të proceseve algoritmike²⁹ më tej identifikojnë rreziqet aktuale të çrregullimit të informacionit dhe sigurojnë burime për të trajtuar këtë çështje. Theksi vihet në rëndësinë e lirisë

24 Për më shumë detaje mbi Nenin 10 dhe standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shih, mes tjerash: <https://rm.councilofeurope.int/16806da515>.

25 Komiteti punoi nën mbikëqyrjen e Komitetit Drejtues të Mediave dhe Shoqërisë së Informacionit (CDMSI), i cili ka misionin e rëndësishëm të drejtojnë punën e Këshillit të Evropës në fushat e lirisë së shprehjes, medias dhe drejtimit të internetit.

26 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=0900001680790e13.

27 https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectId=0900001680790e14.

28 https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectId=090000168092dd4d.

29 https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?ObjectId=090000168092dd4d.

së medias dhe pluralizmit dhe cilësinë e gazetarisë. Këto dokumente pranojnë që mediat elektronike dhe platformat e internetit mundësojnë qasjen në informacion nga burime të ndryshme, por gjithashtu ngrenë shqetësime për pluralizmin e mediave. Në fakt, ndërmjetësit e internetit kanë fituar kontroll gjithnjë e më të madh mbi rrjedhën, disponueshmërinë, zbulueshmërinë dhe qasjen e informacionit dhe përmbajtjes tjetër në internet.

PËRFITUESIT E JUFREX NË EVROPËN JUGLINDORE

Pasqyrimi i instrumenteve ligjore në lidhje me pluralizmin e mediave te përfituesit tregon se, me përjashtim të Kroacisë dhe Maqedonisë së Veriut të cilat kanë dispozita dhe kufizime më të përpunuara në lidhje me këtë çështje, mbrojtja e pluralizmit të medias njihet vetëm formalisht në pjesën tjetër të rajonit. Transparenca e pronësisë së medias është disi e theksuar në shumicën e rasteve, dhe shumica e çështjeve trajtohen nga këndvështrimi i rregulloreve për lëshimin, transferimin ose ndryshimet e pronësisë së licencës. Përveç dispozitave nga legjislacionet e lidhura me mediat, vendet kanë gjithashtu legjislacion të konkurrencës, që në pjesën më të madhe, merret me aspektet e përgjithshme të përqendrimeve.

Grafiku 2 më poshtë ilustron më hollësisht kornizat legjislative në rajon, të cilat janë siguruar nga Përfituesit, dhe të cilat janë të detajuara në Shtojcën 1 të këtij publikimi.

Grafiku 2: Korniza legislative përkatëse në Ballkanin Perëndimor. AL: Shqipëria, BA: Bosnja dhe Hercegovina, HR: Kroacia, XK: Kosova*, ME: Mali i Zi, MK: Maqedonia e Veriut, RS: Serbia (burimi i akronimeve: Eurostat³⁰)

	AL	BA	HR	ME	MK	RS	XK
Nominal protection of media pluralism in media-related legislation	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Transparency obligations	✓	✓		✓	✓	✓	✓
Restrictions in ownership in media legislation (from the perspective of media pluralism)	✓	✓			✓		✓
Definitions and restrictions in relation to linked persons/companies	✓	✓			✓		✓
Impermissible media concentrations	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Regulation of change of ownership	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
A priori regulation of ownership change	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
General restrictions of concentration in competition laws	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

30 Eurostat: AL - Shqipëri, BA - Bosnjë dhe Hercegovinë, HR - Kroaci, XK - Kosovë*, ME - Mali i Zi, MK - Maqedonia e Veriut, RS - Serbi.

Një përditësim i përfutësve përkritazi me çështjet legjislative në lidhje me statusin e transpozimit të AVMSD-së së rishikuar dhe b) çdo zhvillim i ri në fushën e pluralizmit të medias, duke përfshirë risitë e mundshme në lidhje me mjedisin e informacionit në internet përfshijnë:

Transpozimi i AVMSD së rishikuar		Zhvillime të reja në fushën e pluralizmit mediatic (përfshirë mjedisin e informacionit në internet)
AL	Nuk janë bërë rishikime.	Nuk ka zhvillime të reja.
BA	Pas një ngecjeje në procesin e hartimit të Ligjit të ardhshëm për komunikimet elektronike dhe mediat elektronike (shkaktuar nga pandemia Covid), Ministria e Komunikimeve dhe Transportit e BH ka rifilluar kohëve të fundit aktivitetet e grupit të punës. Ligji duhet të transpozohet vetëm pjesërisht AVMSD-në e rishikuar duke përfshirë disa nga dispozitat e përgjithshme (si dhënia e përgjegjësisë CRA-ve për rregullimin e platformave të ndarjes së videoeve), ndërsa dispozitat më të hollësishme do të transpozohen nga aktet nënligjore të CRA-së. Sidoqoftë, meqenëse afati kohor për miratimin e ligjit është i pasigurt, CRA ka përgatitur ndryshime në kornizën e saj rregullatore për të mbuluar të dy skenarët - transpozimin e plotë dhe të pjesshëm. Në çdo rast, aktet nënligjore janë planifikuar të miratohen deri në fund të vitit 2021.	Ndoshta nuk lidhet drejtpërsëdrejti me pluralizmin e medias, mund të jetë me rëndësi të theksohet se Këshilli i CRA-së ka miratuar kohëve të fundit ndryshimet e draftit të rregullave që drejtojnë ofrimin e shërbimeve mediatiche audiovizive dhe të radios me qëllim që të shtrihet përgjegjësia editoriale e të licencuarve edhe për përmbajtjen në internet. Më konkretisht, është propozuar që e gjithë përmbajtja e publikuar në faqet zyrtare të transmetuesve ose me logon e tyre t'i nënshtrohet të njëjtit nivel rregullash elementare si përmbajtja e transmetimit, kur është fjala për nxitje të dhunës, urrejtjes dhe diskriminimit, paragjykimin të shëndetit dhe sigurisë publike, mbrojtjes së të miturve dhe privatësisë së tyre, si dhe të drejtës së përgjigjes. Ky propozim aktualisht është i hapur për konsultime me publikun.
HR	Drafti i Ligjit të ri për Media elektronike aktualisht po kalon nëpër procedurën parlamentare, përkatësisht në leximin e dytë, kur pritet që ligji i propozuar të pësojë disa ndryshime. Ligji duhet të miratohet deri në fund të qershorit apo fillim të korrikut 2021.	Në Ligjin e ri për Media Elektronike, do të ketë ndryshime në lidhje me rregullat për përqendrimin e mediave. Mes tjerash, kriteret për vlerësimin e përqendrimin të mediave do të përfshijnë monitorimin e hiseve të audiencës. Rezultati përfundimtar në këtë drejtim është në pritje të procedurës së miratimit parlamentar.
ME	Nuk ka zhvillime të reja	Ligji i ri për Shërbimet AVM, siç u tha më parë, pritet të sigurojë transpozimin e AVMSD-së së rishikuar dhe në përputhje me rrethanat (ri)përcaktojë kompetencat kryesore të MRA-së në lidhje me pluralizmin e medias si dhe VSP-të.
MK	Ministria kompetente ka njoftuar se do të krijojë një grup pune për ndryshimin e rregullave dhe se ndihma e ekspertëve do të përdoret në mënyrë që të sigurohet që ligjet e lidhura me mediat të jenë plotësisht në përputhje me Direktivën e Shërbimeve të Mediave Audio dhe Audiovizive dhe parimet dhe standardet e saj themelore, si si dhe me aktet e tjera përkatëse të BE-së, me synimin për të siguruar një mjedis mediatic pluralist.	Nuk ka zhvillime shtesë

RS	<p>Gjatë vitit 2020, Qeveria e Republikës së Serbisë miratoi Strategjinë për Zhvillimin e Mediave të Informimit Publik në Republikën e Serbisë për periudhën 2020-2025 (Strategjia e Medias) dhe Planin e saj të Veprimit.</p> <p>Plani i veprimit parashikon transpozimin e Direktivës AVMS përmes ndryshimeve në Ligjin për Media Elektronike, i cili parashikohet për tremujorin e dytë të vitit 2022.</p> <p>Nuk ka informata shtesë në lidhje me këtë proces.</p>	Nuk ka zhvillime të reja
XK	Nuk ka zhvillime të reja	<p>KPM është në proces të hartimit të Rregullores për Pronësinë dhe Përqendrimin e Ofruesve të Shërbimeve të Mediave Audio dhe Audiovizive. Drafti i parë u është prezantuar palëve të interesit dhe është në proces të rishikimit nga një ekspert ndërkombëtar i përfshirë në këtë proces. Parashikohet që pas shqyrtimit të tij, drafti të jetë përsëri në dispozicion për komente publike dhe të ketë një takim diskutimi në lidhje me draftin pas të cilit të gjitha komentet dhe propozimet e paraqitura do të shqyrtohen dhe merren në konsideratë. Hapi i fundit do të jetë miratimi i Rregullores nga Komisioni i KPM-së, deri në fund të vitit 2021, varësisht nga gjendja me Covid-19.</p>

Ky përditësim është siguruar nga përfituesit në fillim të prillit 2021.

4. Pluralizmi mediatik dhe roli i autoriteteve rregullatore të medias

Regullimi i medias luan rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen e pluralizmit të medias, veçanërisht në ekosistemin bashkëkohor të medias, i cili është kompleks dhe që thekson nevojën për ruajtjen e pluralizmit të medias si një politikë e rëndësishme publike. Po ashtu ka nocione të pranishme qartazi kundërthënëse midis biznesit dhe lirive civile, tërheqjet dhe shtytjet midis modeleve të biznesit në media, të cilat prekin të drejtat më themelore të qytetarëve.

Rregullimi i medias, i kryer nga autoritetet rregullatore të pavarura të medias, përpiqet të bashkërendojë cilësitë e tregut dhe ekonomisë me vlerat demokratike, kulturore dhe përfshirjen sociale. Këto mundën dhe nganjëherë edhe përfaqësojnë nocione shumë kundërthënëse dhe të diskutueshme, duke e vendosur rregullatorin e medias në një pozicion që nuk është aspak i dëshirueshëm. Kjo është me të vërtetë një detyrë shumë sfiduese. Para se ta shpallni suksesin ose dështimin e mekanizmave të veçantë rregullues, duhet të merret parasysh fakti që rregullimi i kësaj industrie mund të jetë i vështirë dhe i mundimshëm. Sidoqoftë, rregullimi i këtij sektori është po ashtu shpërblyes dhe përmbushës, duke ndjekur recetën më të thjeshtë por më të vështirë: zbatimi identik i rregullave sjell rezultate ekuivalente, d.m.th., marrja e vendimeve përkitazi me parimin e pavarësisë ose të paktën autonomisë në lidhje me autoritetet e tjera publike, zbatimi i politikave publike qendrore dhe mbrojtja e interesave publike (respektimi i të drejtave themelore, kohezioni social, formimi i mendimeve, etj.), në mënyrë të paanshme përballë shumëllojshmërisë së interesave partiake, marrja e vendimeve për të mos mbrojtur interesat e veçanta të askujt, por interesat kolektive të të gjithëve.

Të kesh pluralizmin mediatik si parim që duhet të arrihet dhe ruhet kërkon një gamë të plotë të rregulloreve që prekin shumicën, në mos të gjitha, fushat e praktikës rregullatore: nga regjimet e licencimit të konsideratat e bazuara në analizat e tregut, çështjet e digjitalizimit, rregullimin e përmbytjes dhe (aty ku është e zbatueshme) miratimin e normave rregulluese. Për të vlerësuar praktikën rregullatore, një përmbledhje e shpejtë e çështjeve kryesore nga këndvështrimi i përfituesve është dhënë në Tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1: Pikëpamjet e shprehura të ARM në pyetësorë³¹

Përfituesi	Pluralizmi mediatik - çështjet kryesore nga këndvështrimi i autoriteteve rregullatore të mediave në Ballkanin Perëndimor
AL	<p>Që nga viti 2016, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka publikuar një bulletin periodik, i cili paraqet grupin e të dhënave dhe treguesit e performancës së entiteteve audio dhe audiovizive. Një nga elementët e përfshirë në këto botime janë të dhënat përkitazi me transparencën dhe pronësinë e mediave.</p> <p>Ekzistojnë disa dispozita ligjore në një ligj special, zbatimi i të cilave synon të garantojë pluralizmin mediatik. Kështu, në nenin 63 të ligjit që parashikon rregullat e përdorimit të rrjetit digjital, parashikohet që mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale dhe lokale, do të kenë detyrimin të sigurojnë qasje deri në 40% të kapacitetit të tyre për subjektet e tjera licencuar nga AMA. Një subjekt i licencuar nuk mund të ketë më shumë se një të tretën e programeve, sipas llojit të licencave që mban (nëse është entitet vendor, nuk mund të ketë më shumë se 1/3 të gjitha programeve lokale)</p> <p>Ndërkohë, ndryshimi i nenit 62 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", u iniciua nga shoqata e medias elektronike shqiptare, dhe në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë, Gjykata Kushtetuese vendosi ta pranojë atë duke shfuqizuar pikën 3 të nenit 62 të ligjit.</p> <p>Që nga viti 2019, AMA bashkëpunon ngushtë me Autoritetin e Konkurrencës rast pas rasti, për hartimin e akteve nënligjore (përfshirë rregulloret e licencimit) dhe në rastet kur subjektet shpallin ndryshime pronësore në mënyrë që të shmangin situatat monopole ose në rastet e dyshimit të pozitës dominuese në treg.</p>
BA	<p>Papërshtatshmëria ose mosekzistenca e rregulloreve ligjore që drejtojnë pluralizmin e mediave është pranuar nga një konsorcium i palëve të interesuara: Shoqata e Gazetarëve e BH, Fondacioni Mediacentar, Këshilli i Shtypit dhe Mediat Online në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe OJQ-ja "JaBiHEU". Ata u mblodhën rreth një projekti të quajtur "Media dhe Reputacioni Publik"³², me qëllim për të promovuar transparencën e pronësisë së mediave dhe format legjitime të financimit dhe reklamimit të mediave në Bosnjë dhe Hercegovinë. Konsorciumi hartoi Ligjin për Transparencën e Pronësisë së Mediave, i cili duhet të mbulojë të gjithë sektorët e medias, nga transmetuesit e radiotelevizioneve, mediat dhe agjencitë e shtypit deri te mediat elektronike, si dhe sektorët të lidhur me mediat, siç janë agjencitë e matjes së audiencës. Projektligji parashikon detyrimin për të siguruar informata për pronësinë e drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe interese të ndërlidhura, burimet e të ardhurave, etj. Është paraparë edhe krijimi i një regjistri të centralizuar të pronësisë për të gjithë sektorët e medias, por nuk është përcaktuar cili institucion do të ishte përgjegjës për mbajtjen e një regjistri të tillë. Institucionet e propozuara përfshijnë Agjencinë Rregullatore të Komunikimit (CRA), Këshillin e Mediave të Shtypit, Agjencinë e Statistikave dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Përndryshe, drafti sugjeron që kompetencat të ndahen midis CRA dhe Këshillit të Mediave të Shtypit. Projektligji është analizuar nga ekspertët e Këshillit të Evropës me kërkesë të Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve dhe është prezantuar në një tryezë të rumbullakët, të organizuar në kuadër të projektit "Raportimi i të drejtave të njeriut dhe roli i mediave në Bosnjë dhe Hercegovinë" në dhjetor 2019, ku përfaqësuesit e Konsorciumit dhe institucionet përkatëse shtetërore (Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët, Ministria e Komunikimit dhe Transportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Sigurisë, si dhe anëtarët e Parlamentit) ranë dakord që përpjekjet për përfundimin e draftit dhe fillimin e procedurës legjislative të bashkërendoheshin më tej nga Ministria e Komunikimit dhe Transportit dhe Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve.</p>

31 Siç u përmend në Hyrje, një pyetësor është përgatitur nga redaktori i publikimit, me qëllim të mbledhjes së informatave lidhur me kornizat nacionale dhe praktikatat relative ndaj pluralizmit mediatik në Ballkanin Perëndimor

32 <https://europa.ba/wp-content/uploads/2017/11/transparency-ownership-financing-media-eng.pdf> <https://europa.ba/wp-content/uploads/2017/11/transparentnost-vlasnistva-fiansiranja-medija-bhs.pdf>.

Përfituesi	Pluralizmi mediatik - çështjet kryesore nga këndvështrimi i autoriteteve rregullatore të mediave në Ballkanin Perëndimor
BA	Më vonë u mbajt edhe një takim në shkurt 2020 për të përsëritur angazhimin e institucioneve shtetërore dhe komunitetit të medias për të vazhduar me reformën ligjore dhe është duke u diskutuar një vazhdim i projektit. Deri në prill të vitit 2021, dhe sipas informacionit në dispozicion të CRA, Ministria e lartpërmendur ende nuk ka filluar procedurën legislative.
HR	<p>Gjatë pesë vjetëve të fundit, ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive (AVMS) kanë qenë aktivë vetëm gjatë hartimit të një Akti të ri të Mediave Elektronike, i cili ishte në konsultime publike në periudhën shkurt-mars 2020. Propozimi për një Akt të ri të Mediave Elektronike përmban edhe një qasje të re për rregullimin e pronësisë dhe përqendrimit të mediave, duke futur kritere ekonomike dhe të tregut dhe modernizon qasjen duke zgjeruar disa rregulla audiovizive në platformat e ndarjes së videove.</p> <p>Gjatë pesë vjetëve të fundit, organizatat joqeveritare nuk kanë qenë mjaft aktive në çështjen e pluralizmit të mediave. Para kësaj kohe, organizata e shoqërisë civile GONG (sidomos në periudhën 2013-2014) avokonte për një ndryshim në legjislacion që do të mundësonte transparencë më të madhe të pronësisë së mediave. Në vitin 2013, ata publikuan një studim “Uska grla lokalnih radija u Hrvatskoj³³”, duke propozuar standarde më të miratë transparencës, zbatim më efektiv dhe monitorim të detyrimeve ligjore për transparencën e pronësisë së radios. Megjithatë, pas vitit 2015, ata nuk u përqendruan më në këtë temë.</p>

33 https://www.gong.hr/media/uploads/20140212_analiza_uska_grla_lokalnih_radija_u_hrvatskoj_finalno.pdf.

Përfituesi	Pluralizmi mediatik - çështjet kryesore nga këndvështrimi i autoriteteve rregullatore të mediave në Ballkanin Perëndimor
MK	<p>Në disa raste, operatori i telekomit ka theksuar se ndalimi me Ligjin për Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive për të pasur në pronësi një stacion televiziv është vetëm në dëm të audiencës maqedonase, pasi sikur të mos kishte një ndalim të tillë, ato do të ishin në gjendje të ofronin një ofertë programore me cilësi të lartë dhe të larmishme dhe të kontribuonin ndjeshëm në zhvillimin e industrisë mediatike. Në vitin 2018, një stacion televiziv ngriti një padi para një gjykate kompetente, duke kërkuar që gjykata të anulonte Vendimin me të cilin Agjencia kishte ndaluar ndryshimin e strukturës së saj të pronësisë. U mor vendim që ndaloi ndryshimin e strukturës së pronësisë pasi që Agjencia kishte gjetur se, po të zbatohet, do të kishte krijuar përqëndrim të paligjshëm të medias. Gjegjësisht, personi fizik i cili, sipas ndryshimit të planifikuar, do të ishte pronari i ri i stacionit televiziv, ishte anëtar i familjes së pronarit të një rrjeti publik të komunikimit elektronik (një operator kabllor). Gjykata vendosi që Agjencia kishte zbatuar në mënyrë të përshtatshme dispozitat ligjore dhe se padia ishte e papabuar.</p> <p>Në vitin 2018, si pjesë e projektit "#ReForMediaMKD - Rritja e bashkëpunimit midis shoqërisë civile, institucioneve dhe qytetarëve për të zbatuar reformat në sferën e medias", Instituti Maqedonas i Mediave kreu një analizë të "Rolit të Autoriteteve Rregullatore në Formësimin e Pluralizmit Struktural në Sektorin Audiovizual në Maqedoni, Kroaci dhe Mal të Zi"³⁴ Disa nga përfundimet e kësaj analize ishin se "pluralizmi i mediave si një nga objektivat e rregullatorëve në fushën audiovizive nuk njihet qartë në legjislacionin vendor. Deri më sot, zhvillimi i sektorit audioviziv dhe pluralizmit të medias në Maqedoni nuk ka evoluar në mënyrë strategjike dhe rregullatori është lënë të kujdeset i vetëm për këtë çështje dhe të zbatojë një vizion strategjik të vetin. Për më tepër, copëzimi i trashëguar i tregut, presionet politike dhe industriale mbi rregullatorin kanë kontribuar në përkeqësimin e pasqyrës së përgjithshme të medias."</p> <p>Në studimin e lartpërmendur të Këshillit të Evropës "Pluralizmi i pronësisë së mediave në mjedisin e ri mediatik", është theksuar që ruajtja e pluralizmit të medias është objektiv themelor i politikës, duke kujtuar se në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut "përveç detyrimit për mosndërrhyrje, shteti ka një detyrim pozitiv për të krijuar një kornizë legjislative dhe administrative për të garantuar pluralizëm efektiv."</p>

34 https://mim.org.mk/attachments/article/1093/Analiza_Ulogata%20na%20regulatornite%20tela%20vo%20oblikuvanajeto%20na%20strukturiniot%20pluralizam%20vo%20TV%20sektorot.pdf.

Përfituesi	Pluralizmi mediatik - çështjet kryesore nga këndvështrimi i autoriteteve rregullatore të mediave në Ballkanin Perëndimor
ME	<p>Gjatë rishikimit të legjislacionit për media (Ligji për Mediat Elektronike), disa transmetues paraqitën një propozim për të kufizuar pronësinë e përbashkët midis pronarëve të AVMS-ve (transmetuesve) dhe agjencive të blerjes së medieve/reklamave/mediave.</p> <p>Propozimi nuk u pranua nga Grupi Punues. Megjithatë, Drafti i Ligjit të ri AVMS (që synon të zëvendësojë Ligjin për Mediat Elektronike), ka një dispozitë që ua imponon ofruesve të AVMS dhe VSP paraqitjen në Agjencinë për Media Elektronike të Malit të Zi (AEM ME), jo vetëm të të dhënave për pronësinë e përbashkët me ofruesit e tjerë të AVMS, por edhe të dhëna rreth këtyre në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Interesat e pronësisë së tyre ose të pronësisë së pronarëve të tij më të mëdhenj se 10% në subjektet juridike aktiviteti i biznesit të cilave përfshin mbledhjen, dizajnimin dhe ndërmjetësimin e shitjes së komunikimeve komerciale audiovizive; 2) Interesat e pronësisë së tyre ose të pronësisë së pronarëve të tij më të mëdhenj se 10% në subjektet juridike aktiviteti i të cilave përfshin mbledhjen, analizimin dhe botimin e informacionit për shikueshmërinë, dëgjueshmërinë ose matjen e trafikut (vizitave) të AVMS, d.m.th., matjen e audiencës.
RS	<p>Lidhur me përmbledhjen e çështjeve kryesore nga perspektiva e Autoritetit Rregullator për Media Elektronike (REM), mund të theksohet se ligjet e mediave të Serbisë kanë futur në përdorim monitorimin e pluralizmit të mediave përmes hises së dëgjimit dhe shikimit, gjë që nuk ishte ligjet e mëparshme.</p> <p>Ligjet nuk përcaktojnë qartë metodën e përcaktimit dhe matjes së këtyre hiseve, as metodat e verifikimit të të dhënave mbi preferencat e audiencës mediatike. Të dhënat në procesin e përcaktimit të përqendrimit të mediave merren gjithashtu përmes deklaratave të publikuesve të mediave, pa verifikuar më tej saktësinë e këtyre të dhënave.</p> <p>Koncepti i pluralizmit mediatik nuk mund të barazohet me konceptin e pronësisë së medias, sepse në rastin e medias, pluralizmi i referohet edhe larmisë së burimeve të informacionit dhe përmbajtjes mediatike.</p> <p>Rregullat për përqendrimin e mediave nuk i shtjellojnë mjaftueshëm kriteret për vlerësimin e pronësisë së njëkohshme të mediave në sektorë të ndryshëm. Po ashtu, nuk ka rregulla për neutralitetin e platformës që do të maste pluralizmin e përmbajtjes mediatike në internet, shërbime kabllore dhe forma të tjera të shpërndarjes, platformat OTT, etj.</p>
XK	<p>Projektregullorja për pronësinë dhe përqendrimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizive, "Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Kosovë"⁴⁷ e hartuar fillimisht nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), është një proces në vazhdim e sipër i bashkërenduar me aktivitetet të BE-së/Këshillit të Evropës. Plani për miratimin e rregullores është hartuar në bashkëpunim në mes të KPM-së, Këshillit të Evropës dhe Zyrës së BE-së. Për shkak të situatës me pandeminë, procesi ishte pezulluar për disa muaj, por rifilloi pas verës së vitit 2020. Derisa në finalizimin e rregullores janë paraparë një varg i nën-aktiviteteve, duke përfshirë një takim të kufizuar konsultimi dhe konsultim publik. Një ekspert ndërkombëtar po mbështet KPM-në në këtë proces.</p>

Roli i ARM-ve të përfituesit në lidhje me pluralizmin e medias dallon deri në një farë mase, por janë të pranishme disa tipare të dukshme të ngjashme. Është veçanërisht e dukshme në rolin që lidhet me procedurat e licencimit dhe/ose ndryshimin e pronësisë së licencave, ku çështjet e pronësisë së aplikantëve ose licencave shqyrtohen nga të gjitha AMR-të në rajon, me një rol disi të zgjeruar siç është në rastin e Maqedonisë së Veriut, e

cila përfshin përgatitjen e studimeve për pluralizmin e mediave, siç paraqitet në Aneksin 2 të këtij publikimi. Mandati ligjor për sa i përket miratimit të rregullimit me akte nënligjore është i rëndësishëm për t'u theksuar në formësimin e pluralizmit strukturor, pasi autoritetet rregullatore mund të miratojnë rregulla dhe vendime, përmes të cilave do të rregulloheshin në detaje çështjet përfshirë: procedurën për dhënien e licencave ose miratimet për të kryer veprimtari audiovizive; formatet e shërbimeve të programeve radiotelevizive; kriteret teknike, financiare, hapësinore dhe të personelit që duhet të përmeshin stacionet radio dhe televizive të cilave u është lëshuar licencë, etj. Së fundmi, mekanizmat e zbatimit dhe kompetencat sanksionuese të ARM-ve janë të rëndësishme të përmenden, të cilat mund të përdoren në rastet e shkeljeve të rregullave dhe rregulloreve.

Në vazhdim jepet një pamje e detajuar grafike e rolit të këtyre ARM-ve *vis-à-vis* pluralizmit mediatic:

AL	<ul style="list-style-type: none"> • Aprovimi i ndryshimeve në strukturën e pronësisë së licencave • Lëshimi i licencave për radiot (komunitetet) jo-profitabile • Kompetenca për të miratuar akte nënligjore, mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të ligjit dhe ndërmarrja e sanksioneve për shkelje • Licencimi i shërbimeve audio dhe audio-vizuele i ofruesve medial dhe distributorëve • Promovimi i produksionit vendor, si dhe programimit të produksionit evropian
BA	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi dhe aplikimi i akteve nënligjore, inter alia, përmban rregulla për kuotën programore siç është produksioni vendor; si dhe rregullat për drejtësi dhe paanshmëri dhe sanksionet e vendosura për shkelje • Aprovimi i ndryshimeve në strukturën e pronësisë së licencave • Disponueshmëria publike e regjistrimit të licencave të veta • Lëshimi i licencave për radiot (komunitetet) jo-profitabile
HR	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i koncentrimin të mediave • Paraqitja publike e strukturës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatiche • Alokimi i fondeve përmes Fondit për Pluralizëm Mediatic
ME	<ul style="list-style-type: none"> • Mbikëqyrja e koncentrimin të mediave dhe parandalimi i koncentrimin të paligjshëm të mediave lidhur me transmetimin mediatic • Publikimi i të dhënave vjetore in Gazeten Zyrtare dhe 'online' për personat fizik dhe ligjor (emri/selia/residenca) të cilët gjatë vitit të mëparshëm në mënyrë direkte apo indirekte janë bërë mbajtës të aksioneve në ndonjë ofrues të shërbimeve AVM, duke dhënë detaje për përqindjen aktuale të aksioneve të tilla • Publikimi i të dhënave të ofruara nga shërbimet AVM për 1) aksionet e veta të pronësisë në subjektete tjera ligjore të cilat ofrojnë shërbime të AVM; dhe 2) më shumë se 10% aksione të mbajtura nga pronarët e vet në subjektete tjera ligjore të cilat ofrojnë shërbime të AVM. Një herë në vit, AME publikon rishikimin e të dhënave të paraqitura lidhur me strukturën e pronësisë së të gjithë ofruesve të shërbimeve AVM në fund të vitit të mëparshëm • Alokimi i mjeteve financiare për Fondin për dtimulim të pluralizmit mediatic dhe diversitetit për transmetuesit komercial dhe jo-profitabil
MK	<ul style="list-style-type: none"> • E drejta për të lëshuar apo tërhequr licenca për transmetim në radio apo televizion, ose miratimi për kryerjen e shërbimeve mediatiche audio-vizuele • E drejta për të miratuar akte nënligjore, mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe ndërmarrja e masave dhe vënja e sanksioneve për shkelje përkatëse • E drejta për të monitoruar dhe parandaluar koncentrimin e paligjshëm të mediave

RS	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i pluralizmit mediatic/ përcaktimi i ekzistimit të shkeljeve të pluralizmit mediatic • Lëshimi i licencave për ofrimin e shërbimeve mediaticke dhe mbrojtjen e pluralizmit mediatic • Krijimi (çdo 3 vjet) i listes së programeve në radio apo televizive të cilat transmetohen nga operatorë rrjetet elektronike komunikuese për distribuim dhe transmetim mediatic të të cilëve përdoren nga një numër i përdoruesve përfundimtar si metodë e vetme primare për pranimin e përmbajtjes së medieve me qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe pluralizmit mediatic.
XK	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja për lirinë e pluralizmit të shërbimeve audiovizuale • Licencimi i ofruesve dhe distributorëve të shërbimeve audiovizuale mediaticke • Promovimi i produksionit vendor, si dhe programimit të produksionit evropian, mundësitë financiare dhe cilësia teknike e transmetimit etj

Në Kroaci, për shembull, përveç transparencës së pronësisë, legjislacioni përkatës rregullon edhe dispozitat në raport me personat e afërt dhe përqendrimin e pronësisë. AEM HR mund të vendosë gjoba ose padi ndaj një personi juridik, i cili krijon një përqendrim të palejueshëm. Siç parashikohet nga Ligji i ri i propozuar për Mediat Elektronike, i cili transpozon AVMSD-në e rishikuar, rregullat e lidhura me përqendrimin e mediave do të përfshinin kriteret e monitorimit të pjesëve të audiencës për vlerësimin e përqendrimit të medias, por pasi ky draft aktualisht është në procedurë parlamentare, mbetet të shihet nëse do të ndodhë kështu.

Në Malin e Zi, legjislacioni përkatës rregullon si transparencën e pronësisë ashtu edhe përkufizimin e personave të afërt dhe përqendrimin e pronësisë. Një nga çështjet më të rëndësishme është ajo e përkufizimit të termit media, si dhe rregullimi i detyrimeve për të përmirësuar transparencën e pronësisë së mediave dhe financimit të mediave nga të ardhurat publike. Për dallim nga ligji i mëparshëm, lista e mediave ose jo-mediave tani është zëvendësuar me një përkufizim përshkrues që duhet t'i përgjigjet zhvillimit dinamik të sektorit të medias dhe shfaqjes së vazhdueshme të shërbimeve dhe akterëve të rinj. Për më tepër, AEM ME nuk do të japë licencë transmetimi nëse vërtetohet se dhënia e saj do të çonte në përqendrim të paligjshëm të medias brenda kuptimit të Ligjit. Në raste të tilla, AEM ME mund të urdhërojë transmetuesin, jo më vonë se brenda tre muajve nga konstatimi i një fakti të tillë, për të korrigjuar parregullsitë në lidhje me përqendrimin e paligjshëm të medias. Në rast se një transmetues, pa ndonjë arsye të justifikueshme, nuk vepron në përputhje me urdhrin, AEM ME mund të revokojë licencën. Në baza vjetore, AEM ME publikon (në uebfaqen e tij dhe në Gazetën Zyrtare të Malit të Zi) të dhëna për personat fizikë dhe juridikë (emri, zyra qendrore, vendbanimi) që gjatë viteve të mëparshme janë bërë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi mbajtës të një hiseje ose një aksioni në çdo ofrues të shërbimit AVM, duke dhënë detaje të përqindjes aktuale të një hiseje ose aksioni të tillë. Ligji i ri për Media paraqet detyrimin për të mbajtur të dhëna të burimeve financiare të alokuara për mediat nga organet e sektorit publik, me qëllim për të përmirësuar transparencën e financimit të mediave nga të ardhurat publike. Të dhënat e tilla do të mbahen nga Ministria e Kulturës. Ministria do të publikojë, në uebsajtin e saj në formën e një raporti vjetor, burimet totale të përvetësuar financiare të sektorit publik të alokuara për media, duke përfunduar me 1 qershor të vitit aktual për vitin paraprak.

Në Maqedoninë e Veriut, nuk ka një sistem gjithëpërfshirës për mbikëqyrjen e pluralizmit të mediave. Sidoqoftë, AVMU ka analizuar disa aspekte të pluralizmit mediatic në disa raste deri më sot. Çështja e pluralizmit të përmbajtjes mediatike është integruar në Strategjinë AVMU, për periudhën 2019-2023. Dy pjesët e para të Strategjisë i referohen pluralizmit të përmbajtjes mediatike, ku pjesa e parë merret me larminë e mediave dhe zhanreve dhe pjesa e dytë - me pluralizmin politik. Duke iu përmbajtur këtyre, në nivelin e parë, AVMU zbuloi një mungesë pluralizmi, veçanërisht me stacionet televizive. Në nivelin e dytë, ajo përcaktoi mungesën e programeve të çështjeve aktuale me një qasje dokumentare (ato që shpesh merren si sinonime të gazetarisë hulumtuese) dhe programeve të çështjeve aktuale në fushën e artit dhe kulturës, duke gjetur si mbizotëruese programet e lajmeve të çështjeve aktuale që shpesh realizohen ose si debate ose si intervista. Pjesa e dytë merret me pluralizmin politik, duke pasur parasysh që mbulimi mediatic duhet të pasqyrojë në mënyrë të pashmangshme larminë e pikëpamjeve politike në shoqëri dhe në të njëjtën kohë t'u sigurojë atyre trajtim të barabartë dhe t'u lejojë qytetarëve që vetë të dalin me qëndrime të tyre. Pluralizmi politik, si një nga aspektet e pluralizmit mediatic, ishte gjithashtu temë e një analize të veçantë, me titull "Pluralizmi politik gjatë një fushate elektorale"³⁵, përgatitur nga AVMU në 2014. Gjithashtu, mbikëqyrja e pronësisë së mediave është një nga aktivitetet e rregullta të AVMU. Rregullatori i mediave në Maqedoninë e Veriut posedon të dhëna të sakta për pronarët e subjekteve transmetuese, të cilat sigurohen nga Regjistri Qendror - një institucion i themeluar nga shteti, në të cilin janë regjistruar të gjitha ndërmarrjet tregtare, përfshirë mediat. Kjo përfshin aftësinë për të monitoruar identitetin e pronarit/pronarëve të medias dhe, në rastet kur pronari është person juridik, identifikimin e personit/personave fizikë prapa personit juridik, si dhe marrjen e të dhënave për personat e tjerë juridikë dhe personat fizikë që po ashtu kanë mediumin në pronësi. Për më tepër, kjo i lejon autoritetit rregullator të monitorojë nëse një transmetues ka ndryshuar strukturën e tij të pronësisë pa njoftuar më parë Agjencinë për këtë. AVMU publikon të dhënat në lidhje me pronarët e mediave në uebsajtin e saj, duke i bërë këto të dhëna lehtësisht të qasshme për publikun e gjerë. AVMU po ashtu përgatit raporte vjetore për pronësinë e mediave, të cilat përmbajnë të dhëna për pronarët e transmetuesve, të dhëna për integrimin e kapitalit të transmetuesve, të dhëna për çdo ndryshim në strukturën e pronësisë së transmetuesve gjatë vitit të kaluar dhe të dhëna për procedurat e iniciuara nga AVMU gjatë vitit të kaluar për të vërtetuar ekzistencën e mundshme të përqendrimit të paligjshëm të mediave. AVMU publikon këto raporte edhe në uebsajtin e saj në mënyrë që të dhënat që përmbahen në këto raporte të jenë në dispozicion të publikut.

Në Serbi, ekziston një sistem mbikëqyrjeje i pluralizmit mediatic, zbatuar nga REM, që merr parasysh shkëlqjen e pluralizmit mediatic sipas detyrës zyrtare dhe gjatë aplikimit të ofruesve të shërbimeve mediatike. Ekziston edhe një sistem monitorimi i pronësisë së mediave, i kryer nga autoriteti i konkurrencës.

Në disa raste, si në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku nuk ka në fuqi rregulla legislative përkatëse të pluralizmit mediatic, ARM rrit ndërgjegjësimin dhe thekson nevojën

35 https://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Politickiot_pluralizam_za_vreme_na_izbor-na_kampanja.pdf.

për miratimin e një legjislacioni gjithëpërfshirës të pronësisë së mediave. Kjo është me rëndësi, pasi ARM është në gjendje të theksojë nevojën për miratimin e këtyre rregullave, të cilat jo vetëm që do të trajtojnë çështjet e pronësisë për të gjithë sektorin e medias (të gjitha llojet e mediave, por edhe kompani të lidhura si reklammat dhe agjencitë e matjes së audiencës), por gjithashtu do të vendoste kompetenca dhe mekanizma bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të ndryshme.

Roli i AMR-ve nga rajoni shihet gjithashtu në mundësimin e mbështetjes financiare për pluralizmin e medias, si fondi i pluralizmit të medias i cili ekziston në Kroaci dhe që funksiononte më parë në Malin e Zi (me propozime që ai të futet përsëri), dhe me propozime për prezantimin e tij edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Përveç skemave të përhershme si ajo kroate, kjo mbështetje mund të jetë edhe e atypërtashme si masat mbështetëse për shkak të pandemisë COVID-19. Kjo është gjetur pothuajse në të gjitha rastet, përkitazi me masa të ndryshme, si heqja e tarifave për pagesë të licencës, masat e përgjithshme të lehtësimit të biznesit dhe skemat e mbështetjes së drejtpërdrejtë monetare. Këto skema financiare, në shumicën e rasteve, janë në fillimet e tyre, përveç në rastin e Kroacisë dhe krahas kushteve të rënda financiare në të gjithë rajonin janë joshëse për shumë përfitues të mundshëm. Për këto arsye, skemat gjithmonë mund të përfitojnë nga paketa më gjithëpërfshirëse të ndihmës financiare, por marrin parasysh parimet nën të cilat ndahen burimet, siç janë alokimi për prodhimin e programeve lokale, gazetarisë hulumtuese, etj.

Skema ilustruese në lidhje me masat mbështetëse është e detajuar në Tabelën 2 më poshtë, informata të ofruara nga përfituesit.

Tabela 2: Skemat e mbështetjes së mediave përfituese, informacion i siguruar nga autoritetet rregullatore të mediave

Vendi	Fondet të përhershme për pluralizëm mediatik	Masat mbështetëse gjatë COVID-19
AL	Asnjë	<p>Për shkak të situatës së krijuar në mars-prill 2020 si rezultat i pandemisë COVID-19, AMA vendosi të lehtësojë dhe mbështesë financiarisht subjektet e autorizuar/licencuara prej saj përmes Vendimit Nr. 32, datë 4 maj 2020 "Për zgjatjen e afatit për aplikimin e kamatës për borxhet e prapambetura të pagesave vjetore për licencë/autorizim për vitin 2020, deri më 30 qershor 2020", duke zgjatur afatin e pagesave vjetore për autorizim dhe licencë nga 31 marsi deri më 30 qershor 2020, pa aplikuar kamatë për pagesa të vonuara.</p> <p>Pas shtyrjes nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) të afatit për dorëzimin e pasqyrave financiare për vitin 2019 deri më 3 gusht 2020, AMA zgjati afatin e fundit për dorëzimin e bilanceve vjetore për vitin 2019 nga subjektet e autorizuar/licencuara nga AMA deri në shtator 2020.</p>

Vendi	Fondet të përhershme për pluralizëm mediatic	Masat mbështetëse gjatë COVID-19
BA	Jo - propozohet të miratohet gjatë hartimit të legjislacionin përkatës	<ol style="list-style-type: none"> 1) Në mars, vendimi për të ulur vlerën e përdorur për llogaritjen e tarifës së licencës së transmetimit shkoi në 25% (në vend të 50%) të të ardhurave të përgjithshme të licencës në vitin fiskal 2019. Zbatimi i kësaj mase thuhet se zvogëlon kostot e mbajtësve të licencave të transmetimit në vlerë prej 92 000 euro. 2) Afati i fundit për pagesën e tarifës u zgjat deri më 30 gusht 2020 (në vend të 30 prillit). 3) CRA ka propozuar që Këshilli i Ministrave të mbulojë shumën e plotë vjetore të kontributit shtetëror për përdorimin e spektrit të frekuencës, por ky propozim nuk është pranuar.
HR	Po - Skema për mbështetjen financiare të pluralizmit të mediave në Republikën e Kroacisë po zbatohet dhe promovohet veçanërisht nga Fondi për Promovimin e Pluralizmit dhe Diversitetit të Mediave Elektronike. Fondi administrohet nga AEM HR dhe financohet me 3% e të ardhurave ardhurave nga tarifat e licencës të gjeneruara nga transmetuesi i shërbimit publik Radio Televizioni Kroat. Mjetet e Fondit stimulojnë prodhimin dhe transmetimin: e programeve audiovizive dhe të radios dhe përmbajtje të transmetuesve televizivë dhe/ose të radios në nivele lokale dhe rajonale, të televizioneve dhe/ose radiove jofitimprurëse si dhe të ofruesve jofitimprurës të shërbimeve mediale të shërbimeve audiovizuale me kërkesë dhe satelitore, transferimin përmes internetit të programeve audiovizuale dhe/ose të radios, të ofruesve jofitimprurës të publikimeve elektronike dhe të prodhuesve jofitimprurës të programeve audiovizuale dhe/ose të radios. Rregullimi i mënyrës dhe procedurës së tenderëve publikë për bashkëfinancim të programeve audiovizive dhe të radios nga burimet e Fondit, monitorimi i shpenzimit të parave dhe realizimi i programeve, përcaktohet me një Urdhëresë specifike ³⁶ .	<ol style="list-style-type: none"> 1) Media, si kompani, mund të përdorin masa të përgjithshme (që synojnë kursimin e vendeve të punës dhe ndërmarrëse të likuiditetit). 2) Mediat po ashtu mund të përdorin masa në lidhje me Aktin e Përgjithshëm të Taksave. Me përfundimin nga pagimi i detyrimeve tatimore në tërësi ose pjesërisht për tatimpaguesit të cilëve u ndalohet, janë të paafat ose të penguar për të bërë biznes dhe punë; mundësia e vonimit të pagimit të TVSH-së; zgjatja e afatit për paraqitjen dhe pagimin e detyrimit të tatimit mbi të ardhurat e korporatave për vitin 2019. 3) Agjencia për Media Elektronike (AEM HR) ka përgatitur një Fond për të promovuar gazetari cilësore dhe hulumtuese me interes publik në vlerën totale prej 130,000 euro. Fondet janë të destinuara për artikuj në portale të internetit dhe secili gazetar mund të marrë deri në 4,000 euro. 4) Ministria e Kulturës dhe Medias ka krijuar një fond shoqëror për gazetarë të pavarur. Punëtorët e pavarur të cilët dëshmojnë se të ardhurat e tyre kanë rënë për 50% ose më shumë nga marsi në maj, do të marrin 530 euro (bruto) në tre muaj, gjithsej €1,590. Ky fond do të menaxhohet nga AEM HR. 5) AEM HR ka publikuar një Informacion për transmetuesit në lidhje me detyrimet programore duke deklaruar se janë plotësisht të vetëdijshëm për rrethanat e jashtëzakonshme dhe pozicionin e transmetuesve të shkaktuar nga pandemia. Kjo bazohet në mirëkuptimin se në rrethana të jashtëzakonshme prodhimi i përmbajtjes audiovizive dhe në radio do të pengohet dhe madje do të pengohet ndjeshëm, dhe se kuotat e caktuara të programeve ligjore do të jenë të vështira për t'u përmbushur. Andaj, AEM HR nuk do të marrë parasysh përmbushjen e kuotave të përshkruara të produksioneve dhe as ritransmetimeve të tyre deri më 30 gusht 2020. Ky përjashtim nuk vlen për produksionet e lajmeve.

36 https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2013_12_150_3178.html.

Vendi	Fondet të përhershme për pluralizëm mediatik	Masat mbështetëse gjatë COVID-19
MK	Jo - AVMU ka theksuar nevojën për krijimin e një sistemi të mbështetjes së pluralizmit mediatik në Strategjinë për Zhvillimin e Industrisë së Mediave Audio dhe Audiovizive 2019-2023. ³⁷	<p>1) Në mars, AVMU miratoi një vendim³⁸ për të dhënë ndihmë financiare - një donacion - për ta lehtësuar ballafaqimin me pandemisë, që arrin në 1.7 milion euro. Shumica e fondeve, d.m.th., 1.67 milion euro, u janë dhënë transmetuesve (1.19 milion euro për transmetuesit - si komercialë ashtu edhe ata jofitim-prurës) të cilët aktualisht kryejnë transmetim radio apo televiziv dhe 480,000.00 euro për shërbimin e transmetimit publik, d.m.th, Radio dhe Televizionin Maqedonas). Këto fonde janë ndarë për mbrojtjen e punonjësve të transmetuesve përmes prokurimit të pajisjeve të mbrojtjes personale, për kostot që lidhen me prodhimin, prokurimin dhe transmetimin e programeve, për lehtësimin e ndikimit të krizës Koronavirus në operacionet e tyre ekonomike dhe për të mundësuar funksionim të qetë. Fondet e dhuruara për transmetuesit janë shpërndarë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të gjithë transmetuesve që kishin paguar tarifat vjetore të transmetimit televiziv ose radios për 2019 dhe 2020 u janë rimbursuar këto shuma, duke ua ndaluar vetëm pagesën e TVSH-së. - Për sa u përket transmetuesve që kanë afate për pagimin e tarifës së tyre vjetore të licencës pas Vendimit për Donacion, deri në fund të vitit 2020, AVMU nuk do të kërkojë pagesa të tarifës së tyre vjetore, por do të lëshojë fatura vetëm deri në shumën e tatimit në vlerën e shtuar. <p>2) Në mars, AVMU po ashtu ka dhuruar nga 16,000.00 euro për Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo ka për qëllim masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e punonjësve të tyre përmes prokurimit të pajisjeve të mbrojtjes personale, sigurimit të pajisjeve të tjera dhe mjeteve të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të Ministrive që synojnë parandalimin e përhapjes së Koronavirusit dhe trajtimin të pasojave. Me të gjitha këto entitete, Agjencia ka arritur marrëveshje për donacion.</p>

37 <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2019/03/Регулаторната-стратегија-за-периодот-од-2019-до-2023-година.pdf>.

38 <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2020/03/Odluka-za-dodeluvanje-finansiska-pomos-donacija-koronavirus.pdf>.

Vendi	Fondet të përhershme për pluralizëm mediatic	Masat mbështetëse gjatë COVID-19
ME	<p>Jo. Sidoqoftë, dy skema ekzistonin nga 2010 - 2018 dhe një skemë e re u prezantua nga Ligji i ri për Media (2020):</p> <p>1) Një fond që synonte nxitjen e pluralizmit dhe diversitetit të medias, fillimisht duke pasur media komerciale si përfytyrë të mundshëm. Pas ndryshimit nga 2016, fondi u bë i qasshëm edhe për transmetuesit televizivë komerciale dhe transmetuesit jofitimprurës. Financimi supozohej të vinte nga një pjesë e të ardhurave nga lojërat e fatit. Fondi kishte për qëllim nxitjen e prodhimit të programeve me interes publik (p.sh. anëtarët e komuniteteve dhe kombësive pakicë; ngritja e vetëdijes, parandalimi dhe luftimi i të gjitha formave të diskriminimit; nxitja dhe promovimi i integritetit shoqëror të personave me aftësi të kufizuara) Kjo skemë mbështetëse ishte menaxhuar nga Komisioni për Alokimin e Pjesës së të Ardhurave nga Lojërat e Fatit i ngritur brenda Ministrisë së Financave. Megjithatë, sipas Dekretit për Kriteret për Përcaktimin e Përdoruesit dhe Mënyrës së Shpërndarjes së Pjesës së të Ardhurave të Lojërave të Fatit, vetëm 10% e fondeve duhej të "shpërndaheshin për planet dhe programet e pluralizmit mediatic". Duke pasur këtë parasysh, shumica e këtij 10% u nda OJQ-ve dhe vetëm 10% e këtij 10% (rreth 1% e të ardhurave në dispozicion) u nda mediave transmetuese. Në vitin 2017, Ligji për Lojërat e Fatit u ndryshua, kështu që kjo skemë u shfuqizua më 31 dhjetor 2017.</p> <p>2) Një fond për mbështetjen e transmetuesve komerciale të radios u krijua me ndryshimin e Ligjit për Sigurinë e Trafikut Rrugor në 2014, i financuar nga mbledhja e një tarife prej 2 euro për dëgjuesit e radios në automjete motorike. AEM ME miratoi në maj 2015 një Rregullore me qëllim kryesor për të siguruar mbështetjen për transmetuesit e radios komerciale për të përmirësuar mbulimin, strukturën ose diversitetin e prodhimit të programeve të brendshme. Ndarja e fondeve u vendos të bëhej çdo gjashtë muaj nga Këshilli i AEM ME pas një thirrjeje publike. Pas një ankese, kjo skemë mbështetëse u shfuqizua me një vendim të Gjykatës Kushtetuese në dhjetor 2016, që u zbatua nga marsi 2017.</p> <p>Nenet 17-23 të Ligjit të ri për Mediat rregullojnë krijimin, burimet, mënyrën e ndarjes dhe përdorimit të burimeve financiare nga Fondi i Pluralizmit të Mediave dhe Promovimit të Diversitetit.</p> <p>Shteti do të financojë projekte duke përdorur Fondin në fushën e informacionit duke siguruar burime financiare nga buxheti i Malit të Zi (neni 17). Ligji përcakton që burimet financiare duhet të sigurohen në mënyrë të pavarur dhe transparente, me garanci</p>	<p>1) AEM ME ka publikuar udhëzimet dhe rekomandimet për raportimin e mediave në lidhje me COVID-19 në uebsajtin e saj. Në Mars 2020, AEM ME miratoi një vendim për të liruar transmetuesit komerciale dhe publik nga detyrimi për të paguar koston e dytë tremujor të tarifës së transmetimit për vitin 2020. Masa shtesë të mbështetjes mund të miratohet në gjysmën e dytë të vitit 2020 ndërsa transmetuesit po luftojnë me situatën ekonomike si pasojë e mbylljes. Për më tepër, AEM ME ka informuar transmetuesit se do të kishte mirëkuptim, për sa kohë që janë në fuqi masat e përkohshme për parandalimin e importimit, kontrollit dhe parandalimit të infeksionit nga koronavirusi dhe për ndryshimet në strukturën e raportuar të programit. Lidhur me ndryshimet e mundshme në strukturën programuese të lajmeve, ajo nuk duhet të privojë qytetarët nga informacioni me kohë dhe i plotë lidhur kryesisht me mbrojtjen e shëndetit publik dhe parandalimin e përhapjes së infeksionit. Duke qenë se mbledhja e qytetarëve në vende publike, në objekte të mbyllura dhe jashtë, ishte e ndaluar për kohësisht nga urdhri, përfshirë aktivitetet publike, sportive, kulturore, artistike dhe ngjarje të tjera, AEM ME mori parasysh pritjen reale që këto masa të ndikojnë në sasinë e informatave që përqendrohen në kulturë, sport dhe argëtim.</p> <p>2) Ministria e Kulturës po shqyrton skemën e mbështetjes për mediat transmetuese.</p> <p>3) Transmetuesit kanë të drejtë për kredi të veçanta të vëna në dispozicion nga Fondi i Investimeve dhe Zhvillimit. Sipas masave të miratuara nga Qeveria e Malit të Zi, ky Fond krijoi ka krijuar një linjë të re kreditore "Programi i Mbështetjes së Likuiditetit të Mediave për Zbutjen e Pasojave të Pandemisë së Koronavirusit". Fondet do të përdoren ekskluzivisht për të zgjidhur problemin e jolikuiditetit të mediave elektronike dhe të shkruara, të cilat janë regjistruar në Malin e Zi dhe veprojnë në përputhje me ligjet e mediave të Malit të Zi, si pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së përgjithshme në Mal të Zi dhe në botë.</p> <p>4) Fondet e kredive mund të përdoren për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kapital pune (kostot e materialeve, lëndëve të para dhe shërbimeve të prodhimit); - pagesa të pagave neto për punonjësit për kohëzgjatjen e masave mbrojtëse (për një periudhë deri në 3 muaj); - kostot e qirasë për periudhën e masave mbrojtëse (për një periudhë deri në 3 muaj). <p>Kushtet e kredisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shuma maksimale e kredisë - deri në 600,000.00 euro; - Norma e interesit - 2.0%; - Grejs periudha - deri në 2 vjet;

Vendi	Fondet të përhershme për pluralizëm mediatik	Masat mbështetëse gjatë COVID-19
ME	<p>për pavarësinë editoriale, programuese dhe institucionale. Fondi financohet në shumën prej të paktën 0,09% të buxhetit aktual të Malit të Zi të përcaktuar nga ligji vjetor i buxhetit. (Neni 18). Burimet financiare nga Fondi do të alokohen si më poshtë: (1) 60% nga Këshilli i Agjencisë së AEM ME për media elektronike (pjesa e fondit (sub-fund) për media komerciale dhe jofitimprurëse); dhe 40% nga komisioni i pavarur i themeluar nga Ministria e Kulturës (pjesa e fondit për mediat e shkruara ditore dhe javore dhe publikimet në internet).</p> <p>Burimet financiare të destinuar për pjesët e fondit do të paguhën në llogari të ndara rrjedhëse të organeve përgjegjëse për alokimin (Agjencia dhe Ministria). Ato ndahen: 95% për nën-fondet, dhe 5% për kostot operative të organeve përgjegjëse për alokimin e fondeve (Ministria dhe Agjencia). Neni 19 i Ligjit përcakton që një total prej 5% të fondeve duhet të alokohen çdo vit nga secili prej nën-fondeve për kostot operative të mekanizmave të ndryshëm vetërregullues. Një herë në vit, organizatat vetërregulluese duhet të paraqesin një kërkesë për mbulimin e kostove operative të aktiviteteve të tyre. Kërkesa i paraqitet organit përgjegjës për alokimin e fondeve nga nën-fondi kur ai organ shpall një konkurs publik. Është përcaktuar që organizata vetërregulluese e transmetuesit publik kombëtar Radio dhe Televizionit të Malit të Zi (Avokati i Popullit) nuk do të financohet nga burimet e Fondit. Një kërkesë mund të paraqitet nga një organizatë vetërregulluese që plotëson kushtet e mëposhtme: të jetë e themeluar të paktën tre vjet para dorëzimit të kërkesës; dhe themeluesit e mediave për të cilët është krijuar organizata vetërregulluese të plotësojnë kushtet e referuara në nenin 21 të këtij ligji. Neni 20 i Ligjit përcakton llojet e përmbajtjeve për krijimin dhe publikimin e të cilave do të përdoren burimet financiare nga Fondi. Po ashtu është përcaktuar që burimet financiare nga Fondi nuk mund të alokohen për projekte të financuara nga donacione, sponsorizime ose grante nga institucione vendore dhe të huaja. Sipas nenit 21 të ligjit, Këshilli i Agjencisë do të alokojë burimet financiare të Fondit një herë në vit në bazë të një konkursi publik. Në përputhje me nenin 21 të ligjit, themeluesit e shërbimeve të mediave audiovizive që plotësojnë kushtet e mëposhtme mund të aplikojnë në konkursin për alokimin e burimeve financiare nga nën-fondi për media komerciale dhe jofitimprurëse (të cilat do të menaxhohen nga Agjencia): themeluesit e medias që kanë publikuar të dhëna për strukturën e pronësisë, në përputhje me nenin 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit; themeluesit e mediave që kanë dorëzuar të dhëna për pjesën e financimit nga buxheti i Malit të Zi ose buxheti i njësisë të vetëqeverisjes lokale, d.m.th., nga personat juridikë në pronësi të shtetit ose që financohen tërësisht ose kryesisht nga të ardhurat publike (reklamimi, grante, kredi, subvencione dhe të tjera), në strukturën e të ardhurave në vitin paraardhës të vitit në të</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Koha e kthimit - deri në 8 vjet (përfshirë grejs priudhën); - Afati i kredisë - deri në 6 muaj. <p>Informacione të dobishme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kjo linjë krediti nuk mund të zgjidhë problemet e mediave që janë shfaqur para se të deklarohet pandemia; - Shuma e kredisë nuk mund të kalojë 20% të të ardhurave operative të deklaruara në pasqyrat financiare për vitin 2019; - Varësisht se i besueshëm është aplikanti për kthim të kredisë, do të vendoset nëse do të jetë e mundur të pranohen ndonjë kolateral i butë dhe pengje si kolateral, ose nëse klienti do të jetë i detyruar të ofrojë hipotekë në pasuri të paluajtshme me kolateral të butë.

Vendi	Fondet të përhershme për pluralizëm mediatik	Masat mbështetëse gjatë COVID-19
ME	<p>cilin është shpallur konkursi, në përputhje me nenet 13 dhe 16 të Ligjit; mediat që kanë kryer detyrimet financiare për taksat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe tarifatat për transmetimin e programit radio ose televiziv brenda afatit për të aplikuar në konkursin publik; themeluesit e mediave që nuk janë në proces të falimentimit ose likuidimit; themeluesit e mediave të cilëve nuk u janë ngrirë llogaritë bankare në ndonjë procedurë të mbledhjes së detyruar përmes gjykatave; mediat, të cilave nuk u është hequr përkohësisht licenca e transmetimit dhe mediat që nuk kanë keqpërdorur burimet financiare të alokuara më parë nga Fondi. Sipas nenit 22 të ligjit, Agjencia duhet të miratojë një akt që përcakton të drejtat dhe detyrimet për të ofruar shërbime publike për të cilat pranohen burime financiare nga Fondi. Akti në fjalë duhet të përmbajë: kriteret dhe procedurën për alokimin e burimeve financiare nga nën-fondi, mënyrën e përdorimit të burimeve të tilla financiare, si dhe shumën maksimale të burimeve financiare që mund të alokohen një mediumi nga Fondi brenda një viti Burimet financiare duhet të alokohen për një qëllim të përcaktuar qartë, pa diskriminim dhe bazuar në kriteret të paracaktuara, të qarta, objektive dhe transparente dhe në metodologji të vlerësimit të pikëve. Agjencia do të jetë e detyruar të mbajë evidencë të burimeve financiare të alokuara për sigurimin e shërbimeve publike dhe të publikojë një raport për shpërndarjen e burimeve financiare në uebsajtin e saj brenda 30 ditësh nga alokimi i burimeve financiare. Përfituesi i burimeve të Fondit është i detyruar të paraqesë një raport të hollësishëm me shkrim në Agjenci për zbatimin e projektit, brenda 30 ditëve nga dita e përfundimit të projektit (neni 23 i Ligjit), dhe të mbajë kontabilitete të veçantë për ofrimin e shërbimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve komerciale audiovizive. Nëse përfituesi i burimeve të Fondit përdor burimet e alokuara financiare në kundërshtim me qëllimin për të cilin janë alokuar ose nëse shuma e burimeve financiare të alokuara tejkalon numrin e burimeve financiare të nevojshme për sigurimin e shërbimeve publike, Agjencia do të urdhërojë që burimet financiare të shpenzuara në mënyrë të paligjshme të kthehen në llogarinë e Fondit dhe që ato të përdoren ekskluzivisht për aktivitetet e shërbimit publik, në përputhje me Ligjin.</p>	
RS	<p>REM në mënyrë periodike (të paktën një herë në tre vjet), në tregun gjeografik kombëtar, krahinor ose specifik gjeografik (për sa i përket rregullave për mbrojtjen e konkurrencës), përcakton një listë të programeve radio ose televizive. Lista transmetohet nga operatorët, rrjeti i komunikimit elektronik i të cilëve për shpërndarjen dhe transmetimin e përmbajtjes mediatike përdoret nga një numër i</p>	<p>Në mars, Këshilli i Rregullatorit (REM) miratoi një vendim për të shtyrë pagimin e tarifave (të cilat duhej të paguheshin në periudhën mars-maj 2020) për të gjitha MSP-të që paraqesin një kërkesë për të.</p> <p>Në mars, REM publikoi (në uebsjtin e tij) informatat drejtuar shërbimeve publike të medias (RTS dhe RTV) dhe ofruesve komercialë të shërbimeve</p>

Beneficiary	Fondet të përhershme për pluralizëm mediatik	Masat mbështetëse gjatë COVID-19
RS	konsiderueshëm i përdoruesve të fundit si metoda e vetme ose kryesore për marrjen e përmbajtjes mediatike, në mënyrë që të mbrojë interesin publik dhe pluralizmin e medias. Parimet e vëzhguara janë ato të proporcionalitetit dhe transparencës. Kërkesa për përcaktimin e detyrimit të transmetimit i paraqitet organit rregullator përgjegjës për komunikimet elektronike.	mediale me mbulim kombëtar, se ata janë të detyruar të bëjnë të gjitha komunikimet në dispozicion nga autoritetet publike të natyrës urgjente në lidhje me COVID-19 përmes titrave ose gjuhës serbe të shenjave.
XK	Më 29 shtator 2019, KPM miratoi Rregulloren për Mbështetjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizive me mbulim tokësor lokal dhe rajonal. Kjo rregullore synon të krijojë një Fond për të mbështetur AMSP në mënyrë që të promovohen programe me cilësi të ndryshme në interesin publik.	Si pjesë e pakos emergjente të miratuar nga Qeveria, në fund të marsit, kishte mbështetje për mediat në përgjithësi.

Është e rëndësishme të përmendet këtu roli i ARM-ve në shpalljen dhe/ose zbatimin e rregullave në lidhje me p.sh. kuotat e programeve (lajmet dhe çështjet aktuale, produksionet e brendshme, punimet evropiane), saktësia, drejtësia dhe paanësia, paraqitja e pikëpamjeve të ndryshme dhe të kundërta, të cilat mund të shihen të gjitha nga perspektiva e sigurimit të pluralizmit mediatik. Të gjitha këto janë të pranishme në kornizën rregullatore të këtij rajoni. Karakteristikë tjetër dalluese në rajon është numri relativisht i lartë, dhe në disa raste shumë i lartë, i mediave, që luftojnë financiarisht, por ende arrijnë të qëndrojnë në treg³⁹. Megjithatë, rishikimi i përgjithshëm i peizazhit mediatik në të gjithë rajonin ka prirje ta trajtojë atë si të polarizuar, veçanërisht në linjat politike, por herë pas here edhe në linjat kombëtare. Origjina e problemeve të tilla mbase nuk duhet të gjendet në skemat rregullatore të aplikuar, por më tepër në klimën e përgjithshme politike, dhe veçanërisht realitetet e ashpra ekonomike të rajonit, veçanërisht të përkeqësuar më tej nga pandemia e COVID-19. Gjithashtu, fakti që të ardhurat nga reklamat migrojnë gjithnjë e më shumë kah interneti veçse e ngarkon pamjen mjaft të zymtë të sferës mediale në përgjithësi dhe pluralizmit mediatik në veçanti, si dhe korrigjimet dhe rrugët e mundshme që mund të gjenden më tej në tekst.

Më në fund theksohet rëndësia e edukimit medial dhe informativ si mjet për të arritur aftësitë e domosdoshme kritike të qytetarëve për të vlerësuar burimet e përmbajtjes që po marrin, ose zgjedhin, gjë që është bërë praktikë mbizotëruese kohët e fundit. Siç theksohet në Rekomandimin e lartpërmendur të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare për pluralizëm medial dhe transparencë të pronësisë së mediave: "Në frymën e gamës së shtuar të mediave dhe përmbajtjes, është shumë e rëndësishme që individët të zhvillojnë aftësitë dhe kapacitetet njohëse, teknike dhe sociale që u mundësojnë atyre qasje efektive dhe të analizojnë në mënyrë kritike përmbajtjen mediatike; të marrin vendime të informuara se cilat media i përdorin dhe si t'i përdorin ato; për të kuptuar implikimet etike të mediave dhe teknologjive të reja dhe për të komunikuar në mënyrë efektive, mbase

39 Llogari të shumta nga rajoni theksojnë fluksin e reklamave shtetërore, por edhe faktin që ka një numër mediash në pronësi publike, përveç transmetuesve të shërbimit publik, radio dhe stacione televizive në pronësi të komunave, të cilat marrin fonde të pjesshme nga themeluesit e tyre, veçanërisht rreth zgjedhjeve. Informacione më të hollësishme mund të gjenden në studimin e lartpërmendur të Këshillit të Evropës "Pluralizmi i pronësisë së mediave në mjedisin e ri të medias".

edhe duke krijuar përmbajtje. Për më tepër, edukimi medial kontribuon në pluralizmin dhe diversitetin e medias duke zvogëluar ndarjen digjitale; duke lehtësuar vendimmarrjen e informuar, veçanërisht në lidhje me çështjet politike dhe publike dhe përmbajtjen komerciale; dhe duke mundësuar identifikimin dhe kundërshtimin e informacionit të rremë ose mashtrues dhe përmbajtjes së dëmshme dhe të paligjshme në internet." Informacione më të hollësishme për aktivitetet e AMR-ve të përfituesve në lidhje me edukimin për media dhe informacionin janë dhënë në publikimin e lartpërmendur të Këshillit të Evropës: Autoritetet rregullatore të medias dhe mbrojtja e të miturve, e paraparë me Kapitullin 1, i cili gjithashtu identifikon rëndësinë e aktiviteteve për edukim medial dhe informues në mënyrë që të fuqizojë përdoruesit të angazhohen në mënyrë aktive dhe të marrin vendime të informuara në lidhje me ekspozimin e fëmijëve të tyre ndaj përmbajtjes mediatike, si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i ARM-ve ndërmjet tyre dhe përfshirja e të gjitha palëve të interesit në gjithë rajonin mbetet thelbësore dhe kyçe për zhvillimet dhe përmirësimet e mëtejshme

5. Shikimi përpara - nga transmetimi te algoritmet

Nga gazetata në radio dhe pastaj te transmetimet televizive, ofertat e mediave për audiencën janë zhvilluar shumë ngadalë. Pas një fillimi të ngadalshëm të internetit në vitin 1985, koha duket se është shkurtuar me shfaqjen e shpikjeve dhe zhvillimeve teknologjike me një shpejtësi të paparë. Koha që do t'u duhej disa zhvillimeve teknologjike të lidhura me mediat për të rezultuar në shërbime ndaj audiencës, për dallim nga e kaluara, zvogëlohet në minimum. Në botën e sotme, zhvillimi teknologjik çon menjëherë në shërbime të plota, nga portalet te shërbimet e kërkuara me video, podcast, platformat e ndarjes së videove, e kështu me radhë. Ka kaluar koha e ekskluzivitetit të mediave. Ajo që ne tani i quajmë media tradicionale, duke iu referuar televizioneve, radios dhe shtypit, konkurrenca me grupin e gjerë të shërbimeve të mediave në internet që janë miratuar me shpejtësi. Efektet e shërbimeve të mediave në internet, sa pozitive, po aq edhe negative, janë të mëdha dhe tepër të prekshme nga abuzimi. Ajo që në dukje është ofertë e pasur me përmbajtje, krijon efekte kumbuese, mentalitet të bunkerit, sisteme të mbyllura të besimit, ndërprerje të qarkullimit të lirë të pikëpamjeve të ndryshme dhe të ndryshme, keq informim, lajme të rreme dhe shfaqje të lajmeve të falsifikuara (manipulimi dhe/ ose gjenerimi i përmbajtjes vizive dhe audio me një potencial të lartë mashtrimi, bazuar në të mësuarit e thellë makinerik, inteligjencë artificiale, etj.). Në fakt, një foto ose video e rreme e kombinuar me përmbajtje të pasaktë dhe dezinformuese nxjerr në pah fushat e manipulimit të dyshuar të kompjuterit⁴⁰ dhe efektin e saj të dëmshëm. Në shumicën e rasteve, ekziston një polarizim i pikëpamjeve dhe mungesë e dialogut. Duket se është dëshirë e shprehur fuqimisht për të heshtur kundërshtarin dhe një nocion në rritje i refuzimit për të ardhur në ndonjë lloj marrëveshjeje, edhe nëse nënkupton marrëveshje për të mos rënë dakord me pikëpamje të kundërta. Kur kësaj i shtohet rritja e agjendave politike populiste që po artikulojnë qartë dhe jo rrallë në tekstet e gjuhës së urrejtjes, të nxitura nga propaganda dhe idetë e gabuara. Pluralizmi mediatic po sfidohet gjithnjë e më shumë, duke rezultuar në zbehjen e kapaciteteve demokratike për reagim. Andaj, thelbi i demokracisë po sfidohet në të gjithë botën, qoftë për shkak të teknologjisë apo për arsye të tjera.

Kur pranojmë që qytetarët e informuar janë themeli i demokracisë, por perceptimet e tyre për realitetet këto ditë shpesh shtrembërohen në botën elektronike nga interesa dhe akterë të ndryshëm, të ndihmuar nga algoritmet, inteligjenca artificiale

40 <https://www.reuters.com/article/us-cyber-deepfake-activist/deepfake-used-to-attack-activist-couple-shows-new-disinformation-frontier-idUSKCN24G15E>.

(IA) dhe mësimi makinerik (machine learning), ne e kuptojmë se thelbi i strukturës demokratike është në rrezik serioz. Bota jeton në një epokë të personalizimit dhe është gjithçka përveç asaj që i duhet botës, pasi demokracia kërkon kushte pluraliste mediatike që ua mundësojnë qytetarëve të shohin të gjitha anët dhe veçanërisht të dëgjojnë dhe shqyrtojnë (dhe të angazhohen dhe të respektojnë) pikëpamjet e kundërta.

Krahas këtij trendi bie në sy zhvillimi i një aspekti të veçantë të modelit të biznesit në internet: të ardhurat e drejtuara nga klikimet që padyshim inkurajojnë ofrimin e storieve gjithnjë e më të diskutueshme, përçarëse dhe të bujshme, dhe kur nuk ka storie reale, faqet e uritura për reklama mund të joshen të shpikin përmbajtje tërheqëse. Duket se ekziston një anë e errët e jetës sonë në internet e cila drejtohet nga bote, algoritme, mekanizma të thellë të të mësuarit mekanik, "shitje" të të dhënave personale, mashtrime, propagandë dhe vjedhje të votuesve. Për më tepër, nga perspektiva konkurruese, bizneset elektronike kanë sjellë probleme të konkurrencës, drejtësisë dhe mundësisë së hyrjes në treg, pasi platformat kryesore online pak a shumë kontrollojnë ekosistemet e ekonomisë digjitale.

Këto çështje janë veçanërisht problematike në kohë krizash dhe rrethanash të jashtëzakonshme. Kjo nuk është vetëm një mundësi hipotetike e largët: pandemia COVID-19 na ka treguar përsëri fuqinë e keqkuptimeve dhe injorancës së dukshme. Duke marrë si ilustrim krizën e informacionit në të cilën shoqëria e sotme ka gjetur veten, idetë dhe mendimet nuk bazohen në fakte, prova dhe njohuri, dhe shumë qytetarë po ndikohen dhe manipulohen nga interesa të ndryshme dhe ndjekja e fitimeve. Kjo nuk do të thotë që realiteti ynë formohet nga agjenda më të larta që janë përtej kuptimit tonë; rreziku më i madh vjen nga mbështetja në informacione sipërfaqësore, të shpejta dhe të dorës së dytë. Ndonëse pasoja më e dukshme është rreziku për jetën dhe mirëqenien e njerëzve, ka një dëm tjetër, më pak të drejtpërdrejtë: vërshimi nga informata të tepërta, që krijojnë huti dhe mosbesim në gjithçka që dëgjojmë dhe shohim rreth nesh.

Tregu Evropian audioviziv po përjeton ndryshime të thella. Sipas "Vjetarit të Vëzhguesit Audioviziv Evropian 2019/2020 Trendet Kryesore"⁴¹, konsumimi i mediave audiovizive në vitin 2019 reflekton zhvendosjen e vazhdueshme të të ardhurave kah reklamat në internet, një zhvendosje të konsiderueshme drejt parapagimit të videove sipas kërkesës (VOD), një rritje të lartë të konsumit të podcastit, vështirësi në financimin e transmetuesit publik dhe "konsolidime" përkritazi me blerjen e mediave, duke vazhduar kështu trendin e krijimit dhe zgjerimit të konglomerateve të mëdha mediatike. Më e rëndësishmja, tregu po përjeton një "platformizim" të thellë⁴² të këtyre shërbimeve, një trend i cili "i referohet ngritjes së platformës si model dominues infrastrukturor dhe/ose ekonomik në sektorët e medias, komunikimit elektronik dhe informacionit, komunikimit dhe teknologjisë (TIK)".⁴³

41 <https://rm.coe.int/yearbook-keytrends-2019-2020-en/16809ce58d>.

42 I përkufizuar si "depërtimi i infrastrukturave, proceseve ekonomike dhe kornizave qeveritare të platformave digjitale në sektorët e ndryshëm ekonomikë dhe sfera të jetës, si dhe riorganizimi i praktikave dhe imagjinatave kulturore rreth këtyre platformave".
https://www.researchgate.net/publication/337717560_Platformisation

43 Evens, Tom dhe Donders, Karen (2018) Fuqia dhe politika e platformës në transformimin e tregjeve televizive. Palgrave Global Media Policy and Business.

Megjithatë, përderisa ka një rënie në përdorimin e shërbimeve tradicionale të transmetimit, qëndrueshmëria e tyre mbetet e pranishme, pasi ato gjithashtu po adoptojnë forma të reja biznesi dhe ofrojnë shërbime të ndryshme VOD. Për më tepër, argumentohet se “strukturat dhe praktikat industriale janë ngulitur thellë në strukturat ekzistuese të pushtetit, të cilat janë gati të pandryshueshme ose, të paktën, u duhet kohë për të ndryshuar. Nuk ka të bëjë shumë me adoptimin e teknologjisë së re, por me ndryshimin e strukturave ekonomike që qëndrojnë në themel të industrisë. Platformimi i industrisë do të ndryshojë strukturat e tregut, do të ndikojë në strategjitë konkurruese dhe do të ndryshojë rregullat e lojës, por ndikimi i tij gjithashtu duhet të ndërmjetësohet nga strukturat e pushtetit dhe marrëdhëniet institucionale që kanë qenë të qëndrueshme për dekada. Me fjalë të tjera, sa më shumë që ndryshojnë gjërat, aq më shumë ato mund të mbesin të njëjtat”.⁴⁴

Kriza aktuale COVID-19 po ndikon në disa prej këtyre trendëve. Përderisa konsumimi i lajmeve në rrjetet sociale është rritur, kjo krizë ka treguar se njerëzit janë të prirë t’u kthehen mediave të shërbimit publik dhe mediave “me reputacion”, kur kërkojnë burime të besueshme informimi⁴⁵. Kjo po ashtu konfirmohet edhe nga anketa e vazhdueshme javore elektronike e UK Ofcom⁴⁶ se si njerëzit marrin lajme dhe informacione në lidhje me krizën, e cila tregon se burimet zyrtare dhe transmetuesit tradicionalë mbeten burimet më të besuara për informim rreth COVID-19 ndërsa ato më pak të besuara janë mediat sociale dhe grupet e mbyllura.⁴⁷

Përderisa mekanizmat rregullues për transmetuesit, të cilët kërkojnë qasje të drejtë dhe përfaqësim të akterëve politikë në media, saktësi, ekuilibër dhe paanshmëri, janë politika publike që kuptohen si të mirëqena, kjo nuk ndodhë (ende) me shërbimet në internet. Janë përgatitur shumë vëllime të literaturës në këtë drejtim dhe po bëhen përpjekje të shumta për të shkurtuar këto prirje negative në të gjithë Evropën, në nivele kombëtare, supranacionale dhe ndërkombëtare. Të gjitha këto identifikojnë rreziqe aktuale të çrregullimit të informacionit dhe ofrojnë disa mundësi për të trajtuar këtë çështje. Ato ngrenë shqetësime për pluralizmin e mediave dhe theksojnë rëndësinë e tij. Krahas gazetarisë cilësore, kjo literaturë pranon nevojën për neutralitet të rrjetit dhe që mediat elektronike dhe platformat në internet të mundësojnë qasje informimi nga burime të ndryshme. Komiteti aktual i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Mjedisin dhe Reformën në Media⁴⁸ (MSI-REF) po punon për përgatitjen e një propozimi për përcaktimin e standardeve për komunikimin zgjedhor

44 Evens, Tom dhe Donders, Karen (2018) Fuqia dhe politika e platformës në transformimin e tregjeve televizive. Palgrave Global Media Policy and Business. Referenca gjithashtu gjendet në hyrje të dokumentit EPRA: Përafrimi i qasjeve rregullatore me ato të tregut: Kuptimi i tendencave kryesore të tregut, 2020.

https://cdn.epra.org/attachments/files/3672/original/Understanding_market_trends_introductory_paper.pdf?1589806403

45 Midis burimeve të ndryshme, sugjerohet që të konsultohet Eurobarometri për përdorimin e mediave dhe besimin e mediave në BE - Përdorimi i mediave në Bashkimin Evropian, <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/a575c1c9-58b6-11e8-ab41-01aa75ed71a1>.

46 Një numër i ARM-ve në rajon kanë pasur aktivitetet bashkëpunuese me rregullatorin e komunikimit të Mbretërisë së Bashkuar Ofcom, veçanërisht në lidhje me aktivitetet e tyre kërkimore dhe i ndjekin ato rregullisht.

47 https://www.ofcom.org.uk/__data/assets/pdf_file/0031/194377/covid-19-news-consumption-weeks-one-to-three-findings.pdf

48 <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/msi-ref>.

dhe mbulimin mediatik të fushatave elektorale dhe përkitazi me parimet udhëzuese për qeverisjen e mediave dhe komunikimit për të adresuar kalimin nga kanalet e themeluara te rrjetet sociale dhe rreziqet që lidhen me to (manipulimi i opinionit publik, mungesa e besimit të publikut, çrregullimi i informacionit). Ai ka për detyrë të përgatisë një projekt rekomandim për parimet udhëzuese për drejtimin e mediave dhe komunikimit, një projekt rekomandim për komunikimin rreth zgjedhjeve dhe mbulimin mediatik të fushatave zgjedhore dhe një shënim udhëzues për përparësinë e përmbajtjes së interesit publik, të gjitha këto të pritura me padurim.

Disa iniciativa dhe përgjigje ndaj sfidave të sipërpërmendura janë në vazhdim e sipër nga ligjvënësit kombëtarë në të gjithë Evropën, disa në lidhje me transpozimin e AVMSD-së së rishikuar, por edhe me miratimin e ligjeve të tjera kombëtare që kanë të bëjnë me dëmet në internet.

Kjo çon drejtpërsëdrejti te ndryshimet e fundit në AVMSD-në e rishikuar, dhe futjen e platformave për ndarjen e videove që pjesërisht bien brenda fushës së rregullimit, ku theksohet vetërregullimi dhe bashkërregullimi dhe edukimi medial. Arsyetimi për përfshirjen e ofruesve të shërbimeve të platformës për ndarje të videove brenda apo deri në masën e fushëveprimit të AVMSD qëndron në faktin se këto shërbime ofrojnë përmbajtje audiovizive që është gjithnjë e më e qasshme nga publiku i gjerë, në veçanti nga të rinjtë, që po ashtu vlen edhe për shërbimet e mediave sociale. Këto shërbime janë një medium i rëndësishëm për të shkëmbyer informacion dhe për të argëtuar dhe edukuar, përfshirë duke siguruar qasje në programe dhe video të krijuara nga përdoruesit. Andaj dispozitat e AVMSD kanë shqyrtuar nevojën për të mbrojtur të miturit nga përmbajtja e dëmshme dhe të gjithë qytetarët nga nxitja për urrejtje, dhunë dhe terrorizëm. Në këtë aspekt është propozuar një varg masash nga AVMSD: sigurimi që përdoruesit mund të sinjalizojnë dhe raportojnë përmbajtje që mund të jetë e dëmshme, duke zbatuar kufijtë e moshës dhe sistemet e kontrollit, duke siguruar që operacionet dhe funksionet e platformës të jenë transparente dhe të mundësojnë një sistem të qartë të kontaktit për përdoruesit për të adresuar ndonjë pyetje ose ankesë.

Në nivel të Këshillit të Evropës, ekziston një traditë e gjatë e promovimit të vetërregullimit⁴⁹. Mbështetja për metodat alternative të rregullimit është shtrirë edhe në mjedisin e ri të medias⁵⁰. Koncepti kyç për vetërregullim sillet rreth nocionit të një

49 Në Konferencën e tretë Ministrore Evropiane për Mediat Masive në 1991, Ministrat miratuan një Rezolutë për ekonominë e medias dhe pluralizmin politik dhe kulturor në të cilën, me fokus në vetërregullimin në mbrojtjen e konsumatorëve, ata "inkurajojnë qarqet profesionale të interesuara të miratojnë masa vetërregulluese në mënyrë që të kontribuojnë në formulimin e politikës kombëtare dhe evropiane në lidhje me reklamimin, sponsorizimin dhe format e reja të promovimit komercial dhe financimit për ndërmarrjet transmetuese."

Në Konferencën e katërt Ministrore Evropiane për Mediat Masive në 1994, Ministrat u përqendruan në etikën e gazetarisë dhe miratuan një rezolutë për liritë e Gazetarëve dhe të drejtat e njeriut në të cilën ranë dakord për një listë me tetë parime, përfshirë një parim sipas të cilit "autoritetet publike duhet [...] të pranojnë që të gjithë ata që merren me praktikën e gazetarisë kanë të drejtë të shtjellojnë standarde vetërregulluese - për shembull, në formën e kodeve të sjelljes - të cilat përshkruajnë se si të drejtat dhe liritë e tyre duhet të pajtohen me të drejtat, liritë dhe interesat me të cilat ata mund të vijnë në konflikt, si dhe përgjegjësitë e tyre"

50 Në Konferencën e Ministrave përgjegjës për Mediat dhe Shërbimet e reja të Komunikimit në vitin 2009, u miratua rezoluta për një nocion të ri të medias në të cilën Ministrat konsideruan se "sa i përket medias tradicionale, vetërregullimi duhet të jetë element kryesor për të siguruar

"kodi të sjelljes", i cili nganjëherë përkthehet në nocione të ngjashme si "standarde" ose "udhëzime". Ai sillet rreth marrëveshjeve brenda industrisë që nuk janë të imponuara me ligj, rregullore ose dispozita administrative të një Shteti, dhe kështu, përcakton sjelljen e regtarëve që marrin përsipër të respektojnë kodin.

Me gjithë shembujt e vetërregullimit në të gjithë rajonin⁵¹, ka ende pak lëvizje drejt skemave bashkërregulluese në vendet e përfituesve. Përderisa është duke vazhduar procesi i transpozimit, priten disa mekanizma të parashikuar për përmirësimin e pluralizmit mediatic⁵². Gjendja aktuale, tani për tani, përshkruan disa prej këtyre mekanizmave, veçanërisht ata vetërregullues. Megjithatë, zbatimi aktual ende nuk është parë, siç mund të shihet në Shtojcën 3 të këtij publikimi.

pajtueshmëri me standardet duke respektuar pavarësinë editoriale; kur është e nevojshme, vetërregullimi mund të mbështetet ose bazohet në bashkërregullim. Si formë e ndërhyrjes, rregullorja duhet t'i nënshtrohet kufijve dhe kushteve të caktuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ-së dhe të përmbushë testet e përgatitura nga kjo e fundit. Mekanizmat rregullues të mediave apo platformave të ngjashme me media, ose mekanizmat për t'i mbajtur ato llogaridhënës, qofshin vetërregullues apo bashkërregullues, ose nëse është e nevojshme të drejtuara nga shteti, duhet të jenë efektive, transparente, të pavarur dhe të llogaridhënës. Këshilli i Evropës duhet të hulumtojë se si të përmirësojë funksionimin e këtyre mekanizmave, në veçanti se si të përmirësojë qasjen në ato mekanizma për persona ose grupe që konsiderojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga media ose ofruesit e shërbimeve të ngjashme me mediat." Gjithashtu, në Konferencën e Ministrave përgjegjës për Mediat dhe Shoqërinë e Informacionit në 2013, në një rezolutë për "Ruajtjen e rolit thelbësor të mediave në epokën digjitale" (Këshilli i Evropës - Konferenca e Ministrave përgjegjës për Median dhe Shoqërinë e Informacionit, 2013), një nga konkluzionet e Ministrave ishin se ata e konsiderojnë të rëndësishme konsolidimin e mëtejshëm të vetërregullimit efektiv të mediave si parakusht për lirinë dhe pavarësinë e medias; rregullimin, duke përfshirë formën e tij më të butë të bashkërregullimit, ose vetërregullimin e 'rregulluar', që duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 10 të KEDNJ-së dhe standardet që burojnë nga praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ-së. Andaj, Ministri e ftuan Këshillin e Evropës që të "promovojë media vërtet të pavarura në Evropë bazuar në vetërregullim efektiv"

51 Informacione të hollësishme për këtë janë dhënë në publikimin e lartpërmendur të Këshillit të Evropës: "Autoritetet rregullatore të mediave dhe mbrojtja e të miturve."

52 Në Serbi, një grup pune ka ndërmarrë përsipër transpozimin, ndërsa asnjë lajm në lidhje me këtë nuk është raportuar në Shqipëri dhe Kosovë*.

6. Rekomandime dhe konkluzione

Mekanizmat legjislativë dhe rregullatorë për pluralizmin mediatic në këtë rajon janë konceptuar në një mjedis mediatic analog. Ka raste kur ato janë të mbirregulluara për nga natyra, ndërsa në praktikë nuk duket se ndryshojnë mjedisin mediatic. Ndonëse rajoni karakterizohet nga një numër i lartë i mediave, disi i mungon larmia e përmbajtjes mediatike. Megjithatë, pasi që Monitori i Pluralizmit të Mediave (përmendur në Kapitullin 2) nuk mbulon shumicën e përfituesve të këtij projekti, disi mungojnë të dhëna, të mbledhura me një metodë të unifikuar të matjes. Autoritetet rregullatore, në një masë të madhe, merren me çështjet e pronësisë së mediave që ata licencojnë. Janë krijuar dhe janë duke u zbatuar mekanizma rregullues të përmbajtjes, të orientuar drejt shërbimeve lineare dhe jolineare të mediave. Transmetuesit publikë ekzistojnë, por herë pas here duken se janë shumë të politizuar. Përmbajtja e mediave kombëtare tejkalon kufijtë dhe shpërndahet në të gjithë rajonin. Disa media të lajmeve me pronësi të huaj⁵³ janë të pranishme në të gjithë rajonin dhe ofrojnë mbulim kombëtar si dhe rajonal të lajmeve. Ekzistojnë shembuj të dukshëm të iniciativave drejt veprimtarive për për media dhe informim dhe fondeve të pluralizmit mediatic. Raportohen reagime të autoriteteve rregullatore në drejtim të masave mbështetëse gjatë pandemisë COVID-19. Megjithatë, ekziston një mungesë e theksuar e transparencës së plotë të pronësisë së medias në disa raste. Institucionet përkatëse shtetërore përgjegjëse për çështjet e konkurrencës kanë ngecur në zbatimin e çështjeve të lidhura me përquendimin e medias, siç është e dukshme në disa vende.

Përderisa audienca ende u kushton vëmendje të lartë mediave tradicionale, rajoni po përjeton gjithashtu oferta të reja mediatike dhe shprehi të konsumit, të cilat po zëvendësojnë strukturat e vjetra. Ndonëse vërehet dikotomi në fushëveprimin dhe zbatueshmërinë e rregullave për këto dy lloje mediash, përgjigjet ligjore dhe rregullatore ndaj sfidave për pluralizmin aktual të mediave janë në fillimet e tyre. Me transpozimin e AVMSD-së së rishikuar, e cila është e detyrueshme për të gjitha shtetet përfituese pavarësisht statusit të tyre në proceset e anëtarësimit në BE, ato do të drejtohen në fushën e rregullimit të mediave elektronike (megjithëse të kufizuar në shtrirje dhe fushëveprim) si dhe zhvillimin ose përmirësimin e mekanizmave për vetërregullim dhe bashkërregullim. Gjendja aktuale tregon tendencë për të transpozuar formalisht gjithë dispozitat e AVMSD të rishikuar, veçanërisht në lidhje me detyrimet për VSP-të, ndërsa është ende shumë herët për të vlerësuar

53 Kanalet e lajmeve të afërta me konglomeratet e mediave globale të CNN.

shtrirjen aktuale të fushës rregullatore drejt shërbimeve të mediave në internet. Një shembull i dukshëm i ndryshimeve të propozuara në rregullat dhe rregulloret për sigurimin e shërbimeve mediatike radio dhe audiovizive në Bosnjë dhe Hercegovinë është shtrirja e përgjegjësishë editoriale të të licencuarve edhe në përmbajtjen e tyre në internet, duke aplikuar të njëjtën pako rregullash si për përmbajtjen e transmetuar, në lidhje me nxitjen e dhunës, urrejtjes dhe diskriminimit, paragjykimin e shëndetit dhe sigurisë publike, mbrojtjen e të miturve dhe privatësinë e tyre, si dhe të drejtën e përgjigjes.

Në rajon, por edhe kudo në Evropë, paradigmat aktuale të tregut mediatik tregojnë disa prirje shqetësuese. Përkundër bollëkut të ofertave nga mediat dhe platformat e ngjashme me media, ajo që mungon dukshëm nuk është vetëm oferta e larmishme nga kuptimi i gjerë i pluralizmit mediatik, por edhe larmia e vlerave; do të thotë besueshmëria, transparencja, gazetaria me cilësi të lartë dhe lehtësia e gjetjes së tyre. Platformat në internet nuk janë të vetmet për t'u fajësuar, por shpejtësia dhe arritja e paparë e përmbajtjeve të ndryshme të padëshiruara në këto platforma mbase vetëm të theksuara nga gjendja njerëzore, ku të gjithë kanë një pjesë të përgjegjësishë për situatën aktuale.

Si shoqëri, jemi gjetur në një krizë të pluralizmit dhe premisën demokratike, e cila demonstroi nevojën për të adresuar kërcënimet ndaj proceseve demokratike duke ofruar një shtysë për ndërmarrjen e aktiviteteve për të trajtuar doemos dhe plotësisht këto probleme. Politikat mediale duhet të synojnë të mbrojnë dhe promovojnë shumëllojshmërinë e shprehjeve kulturore duke futur botën elektronike nën petkun e saj me synim krijimin e kushteve të favorshme për mbrojtjen dhe promovimin e larmisë së shprehjeve kulturore, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtën e lirisë së shprehjes.

Rekomandimet e mëposhtme, të cilat burojnë nga kontributi i dhënë nga ARM-të synojnë politika në këtë fushë, të cilat duhet të jenë efektive duke siguruar, mes tjerash:

- rregullore të paanshme dhe të mbështetura në prova;
- instrumente efektive të vetërregullimit dhe bashkërregullimit;
- matje të pluralizmit medial në intervale të rregullta, bazuar në metoda dhe kritere të unifikuara;
- zbatim të e pajtueshmërisë me ligjin dhe standardet profesionale;
- qëndrueshmëri të mediave të pavarura dhe profesionale të shërbimit publik;
- bazë transparente dhe të barabartë të tregut për të gjithë akterët privatë dhe publikë;
- transparencë më të madhe të pronësisë së mediave dhe parandalim të implikimeve negative të përqendrimit të mediave;
- një sistem të drejtë dhe transparent i subvencioneve publike për mediat;
- nxitje të integritetit profesional të gazetarëve dhe edukimit mediatik.

Disa trende kyçe, për sa i përket gjendjes aktuale të pluralizmit mediatic, janë tregues të mirë se në çfarë duhet të përqendrohet politika publike në këtë drejtim. Ato mund të gjenden në rezultatet e Monitorimit të Pluralizmit të Medias 2020 të përmendura më herët. Për fat të keq, siguria e gazetarëve, si fizike ashtu edhe digjitale, vazhdon të përkeqësohet, gjë që paraqet rrezik serioz për lirinë e shprehjes së gazetarëve. Për më tepër, për sa i përket mjedisit digjital, një burim kryesor i rrezikut është mungesa e transparencës midis platformave online në justifikimin dhe raportimin e politikave dhe teknikave të tyre të moderimit. Nga perspektiva e pluralizmit mediatic, është e qartë se platformat e reja kanë ndikim të madh në qëndrueshmërinë e sistemit mediatic. Në fakt, qëndrueshmëria e medias ndikohet nga roli përçarës i ndërmjetësve digjitalë (motorët e kërkimit dhe rrjetet sociale) kapaciteti i të cilave për reklama të shënjestruara i ka larguar të ardhurat nga publikuesit e lajmeve tradicionale.

Me gjithë ndërrimet tektonike në mjedisin mediatic, është, ndoshta më shumë se kurrë, e nevojshme të vazhdohet me mbrojtjen e parimeve dhe vlerave themelore të profesionit, duke bërë të mundur që gazetarët dhe media të kryejnë rolin e tyre në shoqëri dhe të mbrojnë demokracinë. Këto probleme janë veçanërisht të dukshme në rajonin e EJT, ku të drejtat e gazetarëve po shkelen rëndë dhe vazhdimisht dhe ku organet e medias luftojnë për mbijetesë dhe ku ende ka forma të ndryshme të financimit të qeverisë në sektorin e medias⁵⁴. Mungesa e transparencës rreth financimit të mediave dhe pronësisë së medias (përfshirë pronësinë indirekte ose të fshehtë) vazhdon të ndikojë në sektorët e medias në të gjithë rajonin, së bashku me klientelizmin dhe politizimin e lartë të mediave.

Në një shkallë më globale, roli vendimtar i ndërmjetësve dhe platformave digjitale në sigurimin e pluralizmit të mediave duhet të pranohet dhe duhet të miratohen politika dhe masa të përshtatshme. Rregullat për parandalimin e përqendrimit të medias gjithashtu duhet të marrin parasysh faktin që, përveç lojtarëve tradicionale në tregun mediatic, edhe lojtarët digjitalë po bëhen element thelbësor në ekuacionin e përgjithshëm.

Një përpilim i duhur (i ekuilibruar) i fondeve të ndryshme, transparenca e pronësisë dhe detyrimi ndaj përqendrimit duhet të rregullohen dhe të zbatohen në mënyrë efikase. (Ri)përkufizimi i rolit të ARM-ve në fushën e monitorimit dhe zbatimit të parandalimit dhe financimit të përqendrimit dhe/ose transparencës së pronësisë duhet të formulohet me kujdes. Ai duhet të plotësojë rolet dhe detyrimet e autoriteteve të tjera kompetente (p.sh. mbrojtja e konkurrencës) dhe të sigurohet nga burimet e nevojshme njerëzore dhe fuqitë efektive të zbatimit.

Nismat e platformave online për të luftuar, për shembull, gjuhën e urrejtjes, çrregullimin e informacionit, etj., ende janë të mbuluara me një perde jotransparente, duke e lënë publikun me pyetje se cilat rregulla zbatohen dhe nga kush. Nisma të tilla si Bordi i Mbikëqyrjes i shumëpritur i Facebook, ku anëtarët u njoftuan në maj 2020 dhe të cilët do të kenë fjalën e fundit për vendime të caktuara për moderimin e përmbajtjes, të pavarur nga drejtuesit dhe stafi, ende mbetet të vlerësohet dhe përcaktohet nëse ky është ndryshim paradigmë apo vetëm mburojë për reputacionin e tyre.

54 Siç tregojnë raporte të shumta në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pas miratimit të Planit të Veprimit të KE kundër dezinformimit⁵⁵ nga maji 2018 dhe miratimi pasues i Kodit të Praktikës për dezinformimin⁵⁶, u pajtuan me platformat (d.m.th., rrjetet kryesore sociale, reklamuesit dhe industrinë e reklamave në tetor 2018 për të adresuar përhapjen e dezinformimit në internet), Grupi Evropian i Rregullatorëve për Shërbime Audiovizive (ERGA) ishte përfshirë në monitorimin e aktiviteteve të kryera në disa anëtarë -Shtete⁵⁷ në lidhje me transparencën e reklamës politike për zgjedhjet evropiane 2019 dhe në publikimin e raportit të përkohshëm dhe përfundimtar për këtë çështje. Raporti i parë theksonte se monitorimi ishte vërtet i kufizuar, për shkak të mungesës së qasjes në bazën e të dhënave të përgjithshme dhe arkivat e reklamave politike.⁵⁸ Për më tepër, raporti përfundimtar i vitit 2020⁵⁹ theksonte rëndësinë e Kodit por gjithashtu theksonte dobësitë e tij, domethënë mungesën e transparencës në zbatimin e tij, mungesën e mekanizmave për verifikimin e të dhënave të siguruara nga palët nënshkruese, mungesën e uniformitetit në procedura dhe përkufizimet e miratuara nga platforma të ndryshme . Veç kësaj, ekziston shqetësimi për numrin e kufizuar të palëve nënshkruese të Kodit (për shembull, WhatsApp dhe Messenger që nuk përfshihen). ERGA sugjeron përmirësimin e Kodit “duke kërkuar që të gjitha platformat t’u nënshtrohen detyrimeve të njëjta pa dallim (kurdo që është e mundur duke marrë parasysh specifikën e platformave individuale) dhe të miratojnë përkufizime, procedura dhe angazhime më të sakta, si dhe tregues kryesorë të matshëm të performancës” Për më tepër, ERGA sugjeron një lëvizje nga modeli vetërregullues në bashkërregullim më të strukturuar “për të siguruar më shumë qëndrueshmëri në formulimin dhe zbatimin e tij dhe futjen e një mbrojtjeje zyrtare për të ofruar elementet e kërkuara të monitorimit dhe zbatimit. Kjo duhet të përfshijë një mekanizëm për të stimuluar lojtarët e industrisë për të marrë pjesë në një strukturë vetërregullimi ose bashkërregullimi". Deklarata e fundit nga drejtuesit gjermanë dhe francezë të autoriteteve rregullatore shprehte qëllimin për të forcuar rolin e rregullimit të qëndrueshëm duke kërkuar baraspeshën e duhur mes lirisë së shprehjes, në njërin anë, dhe kufizimeve të saj legjitime, në anën tjetër. Ajo po ashtu theksonte se korniza aktuale ligjore që përcakton autorët e përmbytjes së paligjshme dhe të dëmshme si përgjegjësit e parë nuk korrespondon më me realitetin. Ata po bëjnë thirrje për mjete që u përshtaten më shumë realiteteve bashkëkohore, për rishpërndarjen e përgjegjësive në internet, për organizimin e veprimeve ndërqeveritare dhe për një diskutim të menjëhershëm të kornizës rregullatore të zbatueshme për lojtarët e mëdhenj digjitalë në Evropë. Është theksuar se misioni i rregullatorëve: “nuk është dhe nuk mund të jetë për të kontrolluar internetin ose për të vepruar si gjyqtarë, por për të siguruar që platformat përmbushin detyrimet e tyre të bashkëpunimit dhe transparencës, të cilat do të përcaktohen nga rregulloret e ardhshme.”⁶⁰

55 https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/54866/action-plan-against-disinformation_en.

56 <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/news/annual-self-assessment-reports-signatories-code-practice-disinformation-2019>.

57 Monitorimi bazohej në materialin e ruajtur në arkivat e reklamave politike të krijuara nga secila prej platformave duke përdorur kriteret e tyre.

58 https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2019/06/ERGA-2019-06_Report-intermediate-monitoring-Code-of-Practice-on-disinformation.pdf

59 <https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2020/05/ERGA-2019-report-published-2020-LQ.pdf>

60 <https://www.csa.fr/Informer/Espace-presse/Interventions-publiques/Tribune-commune-de-Roch-Olivier-Maistre-et-Tobias-Schmid-en-faveur-d-une-nouvelle-regulation-europeenne>.

Masa të propozuara kombëtare dhe të tjera (supra)nacionale paralele me ato të AVMSD-së së rishikuar, si procesi i vazhdueshëm në lidhje me pakon e Aktit të Shërbimeve Digjitale të BE-së, përfshirë Aktin e Shërbimit Digjital⁶¹ dhe propozimet legislative kombëtare për të luftuar përhapjen e përmbajtjes së paligjshme në internet, janë shënuar dhe duhet të ndiqen dhe shqyrtohen me kujdes nga perspektiva e ndikimit të tyre të përgjithshëm, kur të miratohen. E rëndësishme është të theksohet zhvendosja e propozuar nga mekanizmat vetërregullues dhe vullnetar në një drejtim të drejtpërdrejtë ex ante qasjen rregullatore që ka marrë Komisioni Evropian në këto propozime.

Duke marrë parasysh faktin që shërbimet mediatike po bashkohen dhe se mënyra në të cilën këto shërbime konsumohen dhe ofrohen po ndryshon vazhdimisht në hap me zhvillimet teknologjike, politikat e mediave duhet të jenë transparente, gjithëpërfshirëse, fleksibile, efektive, funksionale dhe praktike. Kështu, duke pasur parasysh mirëqenien e popullatës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetin njerëzor dhe duke theksuar promovimin e pluralizmit politik dhe kulturor, zhvillimi i politikës mediatike duhet të jetë në përputhje me të drejtën e lirisë së shprehjes, e cila garanton lirinë e medias dhe informimit.

Parimet udhëzuese në Rekomandimin e lartpërmendur të Këshillit të Evropës për pluralizmin e mediave dhe transparencën e pronësisë së mediave, theksojnë që autoritetet shtetërore duhet të ndjekin proceset ligjore për të kërkuar kufizime në qasjen në përmbajtje dhe për të miratuar një qasje fleksibile ndaj çdo rregulloreje. Duke pranuar që algoritmet mund të jenë mjete të dobishme, proceset e automatizuara të vendimmarrjes që rregullojnë shpërndarjen e përmbajtjes në internet duhet të integrojnë qëllimin e përmirësimit të ekspozimit efektiv të përdoruesve ndaj larmisë më të gjerë të mundshme të përmbajtjes mediatike në internet. Më tej rekomandohet që "çdo mekanizëm vetërregullues i zhvilluar në këtë fushë duhet të funksionojë në mënyrë të pavarur dhe transparente, të jetë i hapur për pjesëmarrje kuptimplote nga të gjitha palët relevante, të jetë llogaridhënës ndaj publikut dhe të punojë në përputhje me standardet etike që marrin parasysh plotësisht ekosistemin multimedial".

Pluralizmi mediatik është koncept shumëdimensional dhe ka shumë mënyra të ndryshme si mund të dizajnohen dhe synohen ndërhyrjet rregullatore. Përkitazi me përmbajtjen mediatike, rregullimi nuk duhet të ndërlihet vetëm me përqindje dhe kuota, por është i nevojshëm përqendrimin në dimensionin cilësor duke zbatuar masa për të siguruar përmbajtje cilësore. Roli i rregullatorëve mund të ndryshojë nga nxitja e skemave të financimit, siç është bërë në disa vende të rajonit deri te sigurimi i dominimit të përmbajtjes me vlerë të shërbimit publik. Përkitazi me platformat digjitale, është bërë e qartë se një lloj moderimi i përmbajtjes po bëhet i nevojshëm, por duhet të jetë proporcional dhe në përputhje me parimet e lirisë së shprehjes.

Në këtë kuptim është e dëshirueshme njohja e rëndësisë së nismave për edukim medial dhe skema vetë dhe bashkërregulluese. Vetërregullimi është mjet i rëndësishëm për të mbrojtur lirinë editoriale, për të promovuar cilësinë, për të siguruar

besueshmërinë e mediave dhe reputacionin e gazetarëve. Ai po ashtu është mekanizëm jetik për uljen e ndikimit të Shtetit në media në minimum.

Bashkërregullimi, ashtu si vetërregullimi është dizajnuar për të arritur objektivat e politikës publike. Ai përmban elemente të vetërregullimit dhe rregullimit publik tradicional të kryer nga ARM-të. Që vetërregullimi dhe bashkërregullimi të jenë efektivë, duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme: vetëdijesimi i publikut, transparencja, pjesëmarrja e konsiderueshme e industrisë, burimet adekuate, qartësia e proceseve, aftësia për të zbatuar kodet, auditimet e performancës, sistemi i korrigjimeve në vend, përfshirja e anëtarëve të pavarur, rishikimi i rregullt i objektivave dhe sjellje pa marrëveshje të fshehta. Pika kryesore që duhet të theksohet në këtë kontekst është vullnetarizmi, i cili lidhet drejtpërdrejt me çështjen e vetërregullimit dhe bashkërregullimit, kur të gjitha palët e interesuara punojnë drejt zhvillimit dhe mirëmbajtjes së një sistemi të njëtrajshëm dhe efikas, përfshirë zbatimin, për të cilin të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizuale pajtohen vullnetarisht t'i përmbahen. Nevoja dhe rëndësia e bashkëpunimit të ARM-ve në të gjitha nivelet (rajonale dhe veçanërisht në nivelin ndërkombëtar) dhe me përfshirjen e të gjithë palëve të interesit në mbarë vendin, është thelbësore dhe jetike për zhvillimet dhe përmirësimet e mëtejshme në këtë drejtim.

Aktet legjislativë në të gjithë rajonin duhet të përcaktojnë objektivat e bashkërregullimit dhe rolin e qartë të autoritetit kombëtar rregullator (NRA) dhe organit bashkërregullues në proces. Mekanizmat proceduralë në lidhje me funksionimin e organit bashkërregullues dhe proceset aktuale të transpozimit janë mundësi në atë drejtim.

Ndonëse të vogla për sa i përket matjes së treguesve të tregut, ARM-të nga ky rajon duhet të kenë ndikim në atë që është një trend i dukshëm drejt ndryshimeve strukturore që ndodhin në horizontin e politikave publike në lidhje me liritë e mediave. Roli i tyre në kryerjen e hulumtimit të tregut është i rëndësishëm në këtë drejtim. Rregullatorët mund të përdorin njohuritë, ekspertizën, ndikimin dhe marrëdhëniet e tyre me industrinë dhe akterët shtetërorë për të shtyrë politikat publike në drejtimin e duhur.

Mund të ketë një ngurrim për t'u "zhytur" në sfera dhe forma të reja të politikave publike. Ky ngurrim mund të justifikohet nëse shprehet me terma të një ekuacioni matematik, i cili nga njëra anë ofron shumë të panjohura që duhet të barazohen me ndryshimin, të gjitha së bashku kanë interes publik dhe ruajnë të drejtën e lirisë së shprehjes si emërues të përbashkët. Kështu që ka shumë të panjohura, por ndoshta kjo tregon se ka nevojë urgjente për ndryshim të paradigëm. Duhet të fillohet diku dhe, në këtë drejtim, siç sugjeron Platoni: fillimi është pjesa më e rëndësishme e punën.

TNë vend që të kërkojmë masa për detyrimet e gjurmueshmërisë, mandat për ruajtjen e të dhënave, kërkesa për forma të caktuara të përmbajtjes që duhet të hiqen menjëherë dhe kërkesa për verifikim të përdoruesit për mediat sociale dhe shërbime të komunikimit (siç shihet në disa akte të fundit legjislativë në nivel global), të cilat mund të jenë joproduktive dhe paraqesin rreziqe për lirinë e shprehjes dhe privatësinë, çfarë ky publikim që do të dëshironte të ofronte është një ndryshim

në përqaftimin e politikave publike. Duke respektuar aspektin afarist të ekonomive të medias, ai njihet nevojën e braktisjes së qasjeslaisser-faire, pasi që këtë e kërkon demokracia, dhe sepse pluralizmi mediatik qëndron në thelbin e demokracisë. Ai ofron një qasje bashkëpunuese kombëtare dhe ndërkombëtare për këto çështje, ku nevojitet një mori e madhe akterësh dhe palësh të interesuara. ARM-të, qeveritë dhe parlamentet, komisionet zgjedhore dhe agjencitë për mbrojtjen e të dhënave, së bashku me media, akademinë dhe verifikuesit e fakteve dhe platformat elektronike dhe sociale duhet të bëjnë përpjekje të përbashkëta për të përmirësuar demokracinë duke rindërtuar besimin në proceset demokratike dhe duke qëndruar larg censurës.

Ende ka shumë punë për të bërë, por kërkohet para së gjithash vullnet politik dhe një qasje gjithëpërfshirëse. Duhet të theksohet se nuk mund të pritët që ARM-të të mund të mbrojnë vetëm pluralizmin e medias. Pluralizmi mediatik përfshin interesat e biznesit dhe publikut dhe sfidat aktuale ndaj pluralizmit mediatik nuk janë lokale, por më tepër një fenomen global, duke përfshirë një gamë të gjerë të palëve të interesuara. Të gjitha këto palë të interesit, nga ligjvënësit kombëtarë dhe qeveritë deri te organizatat supranacionale dhe ndërkombëtare duhet të përfshihen në përpjekjet për të ruajtur pluralizmin e mediave. Për më tepër, interesat e tregut duhet patjetër të plotësohen me interesa të të drejtave të njeriut, dhe t'i kushtohet më shumë vëmendje interesit publik, në vend të interesave kryesisht të industrisë. Në këtë aspekt, parimet e të drejtave të njeriut duhet të ofrojnë udhëzime të qarta për drejtimin në të cilin ligjet, rregulloret, dhe veprimet e politikave do të adresonin në mënyrë efektive sfida të ndryshme aktuale dhe të ringjallnin pluralizmin e medias.⁶²

62 eagime dhe qasje për t'u marrë me sfidat në internet po ndodhin në nivele kombëtare, supranacionale dhe ndërkombëtare, por disa po vihen në pikëpyetje nga perspektiva e lirisë së shprehjes, si mbyllja e internetit, ligjet kufizuese (p.sh. Hungaria), etj. Ka më shumë referenca në dispozicion, p.sh., në Indeks Botëror të Lirisë së Shtypit 2020: "Hyrja në një dekadë vendimtare për gazetarinë, të rënduar nga koronavirusi", në dispozicion në: <https://rsf.org/en/2020-world-press-freedom-index-entering-decisive-decade-journalism-acacerbated-coronavirus>.

Shtojcat

Shtojca 1:

Vështrim i përgjithshëm i kornizës ligjore të vendeve pjesëmarrëse

1. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË SHQIPËRI

1. Themelimi i autoritetit kombëtar rregullator, mandati dhe kompetencat

AMA është autoriteti rregullator në fushën e programeve të transmetimit audio dhe/ose vizual dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. AMA është një person juridik, i pavarur, me seli në Tiranë. AMA përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe pesë anëtarë. Anëtarët e AMA-së emërohen nga Kuvendi për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

Sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, funksionet kryesore të AMA duhet të:

- a) shqyrtimi i propozimeve dhe aplikimeve për ushtrimin e shërbimeve të transmetimit, përfshirë aplikimet për transmetime numerike dhe dhënia e autorizimeve ose licencave përkatëse, në përputhje me këtë ligj, përfshirë shërbimet e ofruara nga RTSH-ja;
- b) lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar;
- c) garantimi i konkurrencës së drejtë, duke siguruar njëkohësisht zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së;
- d) bashkëpunimi me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit për garantimin e mbrojtjes së konsumatorëve në fushën e mediave elektronike, në rastin e praktikave të pandershme të OSHMA-ve dhe të ofrimit të shërbimeve me çmime abuzive;
- e) hartimi i strategjive për ofrimin e shërbimeve të transmetimit në Republikën e Shqipërisë;
- f) mbikëqyrja e zbatimit të kontratës së shërbimit të lidhur me RTSH-në;
- g) hartimi dhe miratimi i kodit dhe rregulloreve të transmetimit audioviziv dhe akteve të tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji;

- h) hartimi dhe miratimi i rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- i) përcaktimi i pagesave për licencat;
- j) përgatitja dhe nxjerrja e udhëzimeve për RTSH-në, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tij;
- k) përcaktimi i kriterëve dhe masave rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së;
- l) zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik;
- m) bashkëpunimi me ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
- n) bashkëpunimi dhe këshillimi me AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, Zyrën e të Drejtave të Autorit dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

AMA kontrollon zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë dhe në rast shkeljesh vendos sanksione.

AMA, përveç funksioneve të mësipërme:

- a) mbledh, administron dhe publikon informacion për sektorin e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, përfshirë teknologjinë e aplikuar;
- b) ndjek zhvillimin e veprimtarisë së mediave audiovizive në nivel ndërkombëtar;
- c) realizon, organizon, mbështet dhe promovon kërkimin, në lidhje me çështjet e mediave audiovizive;
- ç) bashkëpunon me organet e tjera, përfshirë organet përfaqësuese brenda sektorit të mediave audiovizive, për të ndihmuar veprimtaritë trajnuese në sektorin e mediave audiovizive;
- d) bashkëpunon me organet homologe të shteteve të tjera;
- dh) ndërmerr, nxit dhe kujdeset për kërkimin dhe veprimtaritë përkatëse, që kanë të bëjnë me rolin e medias, duke përfshirë bashkëpunimin me transmetuesit dhe subjektet e tjera të fushës;

vebfaqja: www.ama.gov.al

Në fillim të çdo viti raportet, AMA raporton për aktivitetet e saj vjetore dhe ia dorëzon raportin Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe Kuvendit.

2. Legjislacioni në lidhje me pluralizmin e mediave

(1) Ligji Nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”

Neni 19

Funksionet e AMA-s

1. Funksionet kryesore të AMA-s janë

...

ë) hartimi dhe miratimi i rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji;...

Neni 62

Rregullimi i pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio dhe licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepen vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.

2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence kombëtare për transmetim audio apo licencë kombëtare e transmetimit audioviziv, janë nominative.

3. i shfuqizuar

4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë

kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale.

5. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe licencat kombëtare për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv.

6. Licenca lokale apo rajonale e transmetimit audio dhe licenca lokale apo rajonale e shërbimit të transmetimit audioviziv u jepen personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.

7. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim audio lokale apo rajonale.

8. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale

9. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale

10. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë.

11. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe subjektet juridike të autorizuar për ofrimin e shërbimeve të programit audio dhe autorizimet e shërbimit të programit audioviziv të mbështetura në rrjete satelitore.

12. Asnjë zotëruar i licencave kombëtare të transmetimeve audio dhe licencave kombëtare të transmetimit audioviziv, përfshirë OSHMA-të, të licencuar për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose të autorizuar për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, në bazë të

këtij ligji, nuk mund të transmetojë më shumë se 30 për qind të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. AMA monitoron dhe publikon informacion periodik për volumin e reklamave të transmetuara nga OSHMA-të kombëtare

Neni 63

Shfrytëzimi i multipleksit

1. Mbjtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv janë të detyruar t'u japin akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të multipleksit të tyre, OSHMA-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe/ose licencë shërbimi programi audioviziv.

2. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, një subjekt i licencuar për transmetime numerike ose për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se një të tretën e sasisë së përgjithshme të programeve përkatëse lokale, rajonale dhe kombëtare.

3. Mbjtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të. Tarifat për dhënie të aksesit për transmetim në rrjetin numerik duhet të orientohen në kosto.

4. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

5. Në rast të mosmarrëveshjeve midis OSHMA-ve dhe mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, palët i drejtohen AMA-s.

6. AMA, duke mbajtur parasysh garantimin e aksesit të barabartë dhe jodiskriminues për OSHMA-të, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve, pasi dëgjon pretendimet e palëve, vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

7. Kundër vendimit të AMA-s, palët mund të paraqesin ankesë në gjykatë.

2) Ligji Nr. 9121/2003 për mbrojtjen e konkurrencës, një ligj i zbatuar nga Autoriteti i Konkurrencës

Neni 70

1. Autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në

territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive.

2. Autoriteti, për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ. Në këto raste Autoriteti bën rekomandimet përkatëse.

3. Autoriteti, për zbatimin e këtij ligji në sektorët e rregulluar, bashkëpunon me entet dhe institucionet e tjera rregullatore.

(3) Rregulloret e AMA-s:

“Për procedurat dhe kriteret për dhënien e një licence transmetimi audio” (v. 153/2016, i ndryshuar);

“Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv përmes procedurës ‘Beauty Contest’” (v. 28/2015);

“Për procedurat dhe kriteret për lëshimin e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv” (v. 219/2016);

“Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës lokale për transmetimin digjital lokal audioviziv në periudhën kalimtare (v. 100/2017);

“Për procedurat dhe kriteret për dhënien e një licence për shërbime të programeve audiovizive” (v.2/2020);

“Për procedurat dhe kriteret për dhënien e autorizimeve” (v.100/2017 (vetëm për shërbimin satelitor).

2. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË

1. Themelimi i autoritetit kombëtar rregullator, mandati dhe kompetencat

Autoriteti kombëtar rregullator i Bosnjës dhe Hercegovinës është Agjencia Rregullatore e Komunikimeve e Bosnjës dhe Hercegovinës (CRA), e themeluar nga Ligji për Komunikimet. CRA është një rregullator i konvergjuar për sektorët e transmetimit, telekomunikacionit dhe spektrit të frekuencave. Kompetencat e CRA-së janë:

- zhvillimi dhe promovimi i rregullave në sektorët e telekomunikacionit dhe transmetimit;
- bashkëpunimi për zhvillimin e të gjitha rregullave dhe vendimeve strategjike në lidhje me këtë sektor,
- licencimi i operatorëve në sektorët e transmetimit dhe telekomunikimit;
- planifikimi, menaxhimi dhe alokimi i spektrit të frekuencës;
- zbatimi i standardeve teknike dhe standardeve të tjera në lidhje me cilësinë; caktimi dhe mirëmbajtja e tarifave dhe tarifave të licencës;
- shqiptimi i sanksioneve për shkelje të rregullave përkatëse. Sanksionet në dispozicion të CRA përfshijnë: paralajmërimet me gojë dhe me shkrim, gjobat financiare, pezullimin dhe revokimin e licencës.

CRA përbëhet nga sektorë dhe departamente të udhëhequra nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili lëshon vendime të shkallës së parë. Këshilli i CRA-së vepron si organ i shkallës së dytë në lidhje me të gjitha vendimet e CRA-së. Procedura e kontesteve administrative mund të iniciohet para Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Procedura mund të iniciohet në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës në rastet e lidhura me KEDNJ.

web-faqja: www.rak.ba

CRA publikon të gjitha vendimet e saj në lidhje me përmbajtjen e programit në uebsajtin e saj. Që nga viti 2020, CRA ka filluar publikimin e një raporti periodik që përmban një përmbledhje të të gjitha rasteve të lidhura me programet me të cilat merrej gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë një analizë të shkurtër të rasteve të përzgjedhura. Ky raport përmban edhe përshkrime të rasteve në të cilat nuk janë gjetur shkelje e rregullave. Për më tepër, CRA përgatit raporte vjetore, si dhe raporte të rregullta për vendimet e CRA-së, së bashku me trendët e shkeljeve, të cilat publikohen uebsajtet e saj

2. Legjisllacioni në lidhje me pluralizmin e mediave

Nuk ka asnjë kornizë legjislative në Bosnjë dhe Hercegovinë që rregullon transparencën e pronësisë së mediave. Dispozitat e tjera përkatëse përfshijnë:

(1) Ligji për komunikimet i Bosnjës dhe Hercegovinës⁶³

Neni 3

(Përgjegjësitë e institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës për respektimin e komunikimeve)

4. Këshilli i Ministrave dhe Agjencia sipas kompetencave përkatëse të përcaktuara me këtë ligj marrin të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të arritjes së objektivave të mëposhtme:

- a) Promovimi i konkurrencës së ndershme në mënyrë që përdoruesit të përfitojnë maksimalisht për sa i përket zgjedhjes, çmimit dhe cilësisë;
- b) Që nuk ka shtrembërim ose kufizim të konkurrencës në sektorin e komunikimit sipas politikave të sektorit të Këshillit të Ministrave;

...

Neni 4

(Parimet Rregullatore të Transmetimit dhe Telekomunikimit)

1. Parimet rregullatore të transmetimit përfshijnë:

- a) Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe larmisë së mendimit duke respektuar standartet e pranuar përgjithësisht të mirësjelljes, mosdiskriminimit, drejtësisë, saktësisë dhe paanësisë;
- ...
- c) Që transmetuesit të jenë të ndarë nga kontrolli dhe manipulimi politik, në mënyrë që të forcojnë parimet demokratike dhe bazat e një ekonomie tregu.

63 <http://www.ohr.int/laws-of-bih/public-information/>

(2) Politika e sektorit të transmetimit (2007)⁶⁴

Kufizimi i përqendrimit të mediave dhe pluralizmi mediatic:

... Detyra e institucioneve shtetërore është të mbrojnë pluralizmin dhe diversitetin e medias (kufizimi i përqendrimit), e mbi të gjitha, të mundësojnë një zhvillim uniform dhe të barabartë të të gjitha llojeve të mediave në vend pa favorizuar asnjë lloj. ... Përcaktimi i larmisë reale të përmbajtjes së programit dhe nevojës për të, me theks të veçantë në përmbajtjen lokale, është një nga detyrat kryesore në periudhën e ardhshme. Kjo detyrë duhet të përmbushet duke zhvilluar gara të reja publike, të cilat do të mundësojnë zhvillimin e mëtejshëm të pluralizmit mediatic në mënyrë transparente dhe efektive. Përveç kësaj, është e nevojshme të sigurohet që zonat e pazhvuara ekonomikisht, si dhe zonat që aktualisht nuk kanë qasje ose nuk kanë qasje adekuate në programe të ndryshme në të ardhmen që të marrin atë që po përfiton shumë pjesa tjetër e vendit. Duke pasur parasysh rëndësinë e transmetimit për nevojat demokratike dhe kulturore të secilës shoqëri, shteti duhet të ketë interes të veçantë për të adresuar këtë çështje dhe potencialin për të ndikuar në zhvillimin e rrjetit të transmetimit në mënyrë që sa më shumë qytetarë të mbulohej me sinjale të transmetuesit publik.

- Detyrimet e Këshillit të Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës, Qeverisë së Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Qeverisë së Republikës Srpska

Detyrimet e shtetit dhe subjekteve duhet të garantojnë sa vijon:

- 1.2. mbrojtjen dhe promovimin e pluralizmit mediatic,

...

2. Detyrat e Agjencisë Rregullatore të Komunikimit

Detyrat kryesore të Agjencisë Rregullatore janë:

- 2.1 për të mbrojtur pluralitetin dhe diversitetin e mediave (kufizimi i përqendrimit), dhe mbi të gjitha për të mundësuar zhvillim të vazhdueshëm dhe uniform të sektorit të radios në vend,

3. Aktet nënligjore të CRA-së

Rregulla 77/ 2015 për ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizuale⁶⁵

Neni 22

(Transferimi i licencës)

(1) I licencuari nuk mund, pjesërisht ose tërësisht, të transferojë një licencë ose të caktojë një përdorues tjetër të licencës përmes shitjes ose me një kontratë të veçantë.

(2) Agjencia, me kërkesë të të licencuarit, mund ta transferojë licencën te një person tjetër fizik ose juridik nën të njëjtën pronësi ose në procesin e shkrirjes, bashkimit, ndarjes ose ndryshimit të formës së personit juridik ose zanatit, ose te disa persona që janë të licencuar, vetëm nëse ekziston pëlqimi paraprak me shkrim i të gjithë pronarëve/bashkëpronarëve të të licencuarit për një transferim të tillë.

(3) Çdo ndryshim në pronësinë origjinale të përdoruesit të licencuar që tejkalon 5% të aksioneve përfaqëson një transferim të pjesshëm të pronësisë dhe kërkon aprovim paraprak me shkrim nga Agjencia. Nëse Agjencia lejon transferimin e pronësisë, i

64 <https://docs.rak.ba/articles/84c93765-2de2-4529-ac36-67ae95a1bc21.pdf>

65 <https://rak.ba/en/articles/111>

licencuari informon Agjencinë për ndryshimet e bëra pas regjistrimit në regjistrin gjyqësor (d.m.th. Regjistrin e letrave me vlerë).

(4) Çdo kërkesë nga paragrafët (2) dhe (3) shqyrtohet nga Agjencia në përputhje me procedurat e brendshme dhe të gjitha rregulloret në fuqi, duke përfshirë rregulloret përkatëse në lidhje me përdorimin efikas të spektrit të frekuencës së radios. Agjencia, gjatë përpunimit të kërkesës, shqyrton të njëjtat kërkesa si për lëshimin e licencës dhe jep pëlqimin e saj. Megjithatë, Agjencia jep pëlqimin vetëm nëse përcakton që përdoruesi i ardhshëm i licencës do të vazhdojë të sigurojë që standardet kualifikuese janë përmbushur në bazë të të cilave është lëshuar licenca në periudhën e mbetur të vlefshmërisë dhe se nuk ka detyrime të mbetura për përdoruesit nga Agjencia.

(5) Ndryshimi në emrin zyrtar të licencës pa ndryshim në strukturën e pronësisë nuk konsiderohet si transferim i licencës ose lëshim i licencës së re, dhe regjistrohet vetëm nga Agjencia.

(6) Në rast të vdekjes së personit fizik i cili është pronar i licencës, Agjencia informohet për çdo ndryshim të bërë pas procedurës së trashëgimisë. Agjencia do t'i kërkojë pronarit të ri të nënshkruajë një deklaratë se i licencuari do të vazhdojë të përdorë të drejtat dhe të kryejë detyrimet sipas licencës dhe do të sigurojë përmbushjen e vazhdueshme të standardeve të kualifikimit në bazë të të cilave është lëshuar licenca. Pas marrjes së një deklaratë të tillë, jepet një miratim retroaktiv për ndryshimin e pronësisë.

(7) Agjencia njoftohet me kohë në rast të hapjes së procedurave të falimentimit të të licencuarit, jo më vonë se 14 ditë nga data e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit. Në përputhje me Nenin 4, paragrafi (6), procedurat e falimentimit mund të rezultojnë në rishikimin e licencës së lëshuar dhe revokimin pasues të licencës, nëse konstatohet se standardet e kualifikimit në të cilat bazohet kjo licencë nuk po përmbushen.

(8) I licencuari njofton administratorin e falimentimit për të gjitha detyrimet e tyre ndaj Agjencisë. Nëse ka një blerës të mundshëm gjatë procedurave të falimentimit, Agjencia njoftohet me kohë për të kryer procedurën siç përcaktohet në paragrafin (4) më lart.

(9) Çdo ndryshim në pronësinë origjinale të të licencuarit më i madh se 5% të aksioneve dhe për të cilin nuk ishte marrë pëlqimi paraprak me shkrim i Agjencisë, do të rezultojë në shqiptimin e sanksioneve të duhura. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, nëse është e sigurt që kërkesat e paragrafit (4) të këtij neni janë përmbushur, Agjencia mund të lëshojë pëlqimin pasues.

3. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË KROACI

1. Themelimi i autoritetit kombëtar rregullator, mandati dhe kompetencat

Këshilli i Mediave Elektronike, autoriteti kombëtar rregullator i Republikës së Kroacisë, menaxhon Agjencinë e Medias Elektronike (AEM) dhe kryen detyrat e një organi rregullator në fushën e mediave elektronike në Kroaci. Këshilli ka shtatë anëtarë, njëri prej të cilëve, kryetari i Këshillit, është drejtor i Agjencisë. Presidenti dhe anëtarët e tjerë të Këshillit emërohen për një mandat pesëvjeçar nga parlamenti kroate me propozim të Qeverisë së Republikës së Kroacisë. Agjencia e Mediave Elektronike nuk është në vete rregullator "i konvergjuar", pasi që ndan kompetencat e tij me HAKOM (Agjencinë Kroatë të Postës dhe Komunikimeve Elektronike) e cila merret me ndarjen e frekuencave. Ligji që ka të bëjë me mediat elektronike, Akti i mediave elektroni-

ke, rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave juridikë dhe fizikë që ofrojnë shërbime dhe shërbime mediale audio dhe audiovizuale të publikimeve elektronike nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe interesin e Republikës së Kroacisë në fushën e mediave elektronike. AEM HR ka për kompetencë rregullimin e shërbimeve audio dhe audiovizuale, duke përfshirë mbikëqyrjen e programeve, mbrojtjen e të miturve, dhe zhvillimin e pluralizmit. Veç kësaj, mes tjerash AEM HR siguron konkurrencë të ndershme, duke zhvilluar procedurën e dhënies së koncesioneve, duke monitoruar shpenzimet në përputhje me qëllimet e Fondit për Promovimin e Pluralizmit dhe Diversitetit të Medias Elektronike, inkurajon dhe kryen hulumtime dhe aktivitete të ndërlidhura me të, duke punuar sistematikisht për forcimin e edukimit medial dhe kompetencave të tjera që burojnë nga neni 69 i Aktit të Medias Elektronike.

web-site: www.aem.hr

2. Legjislacioni në lidhje me pluralizmin e mediave

a) Akti i Mediave Elektronike⁶⁶

Neni 52

Paragrafi 1

Deri më 31 janar të çdo viti kalendarik, ofruesit e shërbimeve mediatike janë të detyruar t'i përcjellin Këshillit të Mediave Elektronike të dhënat për një person juridik dhe selinë e tij (d.m.th., emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e përhershëm të të gjithë personave juridikë dhe fizikë që bëhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi zotëruar të stoqeve ose aksioneve në atë person juridik), së bashku me të dhënat mbi përqindjen e aksioneve ose pjesën që ata posedojnë.

Neni 53

Personat e lidhur, në përputhje me këtë akt, do të jenë personat që janë të ndërlidhur reciprokisht nga mënyra e menaxhimit, kapitali ose në një mënyrë tjetër që u mundëson atyre që të formojnë bashkërisht politikën e biznesit, të kryejnë biznes në një mënyrë të bashkërenduar me qëllimin e arritjes së objektivave të ndërsjellë, ose në një mënyrë të tillë që një person të ketë mundësinë të drejtojë një person tjetër ose të ndikojë mbi të në një mënyrë të konsiderueshme ndërsa vendos për financimin dhe menaxhimin e biznesit (p.sh., vendosjen për bazën e programit të mediave).

Personat e lidhur ndërlidhur si në vazhdim konsiderohen persona të lidhur:

- të afërmit e gjakut, si anëtarët e familjes së ngushtë (prindërit, fëmijët, vëllezërit dhe motrat, adoptuesit dhe të adoptuarit);
- nga martesat ose bashkësi jashtëmartesore;
- anëtarët e familjes së ngushtë të bashkëshortit/bashkëshortes;
- kur një person, ose persona, kanë të gjitha stoqet ose aksionet e biznesit, aksione ose të drejta të tjera mbi bazën e të cilave ata marrin pjesë në menaxhimin e një personi tjetër me të paktën 25% të të drejtave të votuesit; - kur i njëjti person i ka të gjitha aksionet ose stoqet ose të drejtat e të dy personave, mbi bazën e të cilave ata marrin pjesë në menaxhimin e secilit prej tyre me të paktën 25% të të drejtave të zgjedhëse;

66 <https://staro.e-mediji.hr/preview/en/news/the-electronic-media-act/>

- kur ata fitojnë më shumë se 30% të të ardhurave nga reklamat përmes kontratave të marketingut ose kontratave të tjera, përmes një periudhe prej tre muajsh ose një periudhe më të gjatë brenda një viti, - kur formojnë kompani të lidhura në përputhje me Ligjin për Kompanitë Tregtare;
- kur janë anëtarë të bordit drejtues ose mbikëqyrës në një kompani në të cilën ata kryejnë këtë detyrë, si dhe persona që konsiderohen të jenë të lidhur me drejtuesit e bordit drejtues ose mbikëqyrës të asaj kompanie, në mënyrën e përcaktuar në këtë paragraf .

Neni 54

Përqendrimet e mëposhtme konsiderohen të palejueshme brenda kuptimit të këtij Akti:

- transmetuesi televiziv dhe/ose radio që koncesion në nivel shtetëror dhe një hise që tejkalon 25% të kapitalit të një transmetuesi tjetër me të njëjtin lloj koncesioni ose koncesioni në nivel rajonal, qarku, qyteti ose komune dhe anasjelltas;
- transmetuesi televiziv dhe/ose radio që ka koncesion në nivel shtetëror dhe një pjesë që tejkalon 10% të kapitalit të publikuesit që publikon gazeta ditore të shtypura në më shumë se 3,000 kopje dhe anasjelltas;
- transmetuesi televiziv dhe/ose radio që ka koncesion në nivel shtetëror dhe një pjesë që tejkalon 10% të kapitalit të një personi juridik i cili kryen veprimtarinë e një agjencie gazete, dhe anasjelltas;
- transmetuesi televiziv dhe/ose radio që ka koncesion në nivel shtetëror dhe boton njëkohësisht gazeta ditore të shtypura në më shumë se 3,000 kopje;
- transmetuesi televiziv dhe/ose radio me koncesion në nivel lokal ose rajonal të mbulimit dhe aksioneve që tejkalojnë 30% të kapitalit të një transmetuesi tjetër të ngjashëm me koncesionin në nivelin lokal ose rajonal të mbulimit në të njëjtën zonë;
- transmetuesi televiziv dhe/ose radio që ka koncesion në nivel rajonal ose lokal të mbulimit dhe boton njëkohësisht gazeta ditore me rëndësi lokale në të njëjtën zonë ose në zonën fqinje;
- ofruesi i shërbimit mediatik, i përcaktuar me nenin 79 të këtij ligji, i cili boton njëkohësisht gazeta ditore të shtypura në më shumë se 3,000 kopje;
- ofruesi i shërbimit mediatik, i përcaktuar me nenin 79 të këtij Akti, që ka hise që tejkalon 10% të kapitalit të publikuesit që publikon gazeta ditore të shtypura në më shumë se 3,000 kopje dhe anasjelltas.

Neni 55

Gjithashtu konsiderohet se ekziston përqendrim i palejueshëm në fushën e medias kur, në rastet e përmendura në nenin 54 të këtij ligji, një person fizik ose juridik i cili është themelues i transmetuesit televiziv dhe/ose radios ose Aktit të Mediave Elektronike GZ153/09, 84/11, 94/13 dhe 136/13 23 ofruesi i shërbimit mediatik të përcaktuar në nenin 79 të këtij ligji, ose një themelues, ose persona të lidhur me të në kuptimin e nenit 53 të këtij ligji, ka hise në kapitalin e një transmetuesi tjetër televiziv dhe/ose radio, një botues reviste ose i një gazete ditore ose agjencie lajmesh, mbi shumën e përcaktuar të kapitalit.

Neni 61

Një operator që kryen veprimtarinë e transmetimit të programit audioviziv dhe/ose radio nuk mund të jetë transmetues televiziv dhe/ose radio si dhe ofrues i shërbimit mediatic, të referuar në nenet 79 të këtij ligji.

Neni 63

Fondi për Promovimin e Pluralizmit dhe Diversitetit të Mediave Elektronike (në tekstin e mëtejme: Fondi) është Fondi i Agjencisë së Mediave Elektronike. Burimet e mjeteve financiare për Fondin janë fondet e siguruar nga dispozitat e këtij Akti dhe Aktit të Radiotelevizionit Kroat.

2) Akti i Konkurrencës⁶⁷

Article 17 Paragraph 1

Në mënyrë që të vlerësohet pajtueshmëria e një përqendrimi, brenda kuptimit të këtij Akti, palët në përqendrim janë të detyruara të njoftojnë Agjencinë për çdo përqendrim të propozuar, nëse kriteret e mëposhtme plotësohen në mënyrë kumulative:

1. qarkullimi i përgjithshëm (qarkullimi i konsoliduar i përgjithshëm vjetor) i të gjitha ndërmarrjeve të palëve në përqendrim, realizuar nga shitja e mallrave dhe/ose shërbimeve në tregun global, arrin të paktën 1 miliard HRK në vitin financiar që i paraprinë përqendrimi në përputhje me pasqyrat financiare, kur të paktën njëra nga palët në përqendrim ka selinë dhe/ose filialin e saj në Republikën e Kroacisë, dhe 2. qarkullimi total i të paktën dy palëve në përqendrim, realizuar në tregun kombëtar të Republikës së Kroacisë, arrin të paktën 100,000,000 HRK në vitin financiar që i paraprinë përqendrimin në përputhje me pasqyrat financiare.

3) Urdhëresa për Fondin për promovimin e pluralizmit dhe diversitetit në mediat elektronike⁶⁸

Neni 4

Ndihma nga Fondi u shpërndahet përfituesve të veçantë të Fondit në proporcionin vijues:

1. Transmetuesit televizivë në nivel lokal dhe rajonal, transmetuesit televizivë jofitimprurës dhe ofruesit e shërbimeve mediatike jofitimprurës sipas Nenit 19 dhe 79 të Ligjit për Media Elektronike - 46.5%;
2. Transmetuesit e radios në nivelin lokal dhe rajonal, transmetuesit jofitimprurës të radios dhe ofruesit e shërbimeve mediatike jofitimprurës sipas Nenit 19 dhe 79 të Ligjit për Media Elektronike - 46.5%;
3. Ofruesit jofitimprurës të publikimeve elektronike - 3%;
4. Prodhuesit jofitimprurës të programeve audiovizive - 3% 5. prodhuesit jofitimprurës të programeve të radios - 1%.

67 <http://www.aztn.hr/ea/wp-content/uploads/2015/05/COMPETITION-ACT-consolidated-text-ENG.pdf>

68 <https://www.aem.hr/podzakonski-akti/>

4. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL I KOSOVËS

1. Themelimi i autoritetit kombëtar rregullator, mandati dhe kompetencat

Autoriteti kombëtar rregullator është Komisioni i Pavarur për Media (KPM), i themeluar me Kushtetutë dhe Ligjin nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media. KPM është organ i pavarur, përgjegjës për rregullimin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, duke përfshirë miratimin e legjislacionit dytësor, procedurave të licencimit, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit frekuencor të transmetimit, përcaktimin dhe mbledhjen e tarifave të licencës, si dhe shqiptimin e sanksioneve për shkelje të rregullave dhe rregulloreve.

KPM është përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve strategjike, siç është tranzicioni në transmetime digjitale, si dhe dokumente të tjera strategjike për shërbimet e mediave audiovizive, për miratim nga Qeveria. KPM-ja përbëhet nga një Komision, një Kryeshef Ekzekutiv dhe një Bord i Ankesave. Anëtarët e Komisionit dhe Bordit të Ankesave zgjidhen nga Kuvendi, ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv emërohet nga Komisioni. Vendimet e KPM-së mund të apelojnë në Bordin e Ankesave. Si rrjedhojë, procedura e apelit në shkallë të dytë mund të iniciohet para Gjykatës.

web-site: www.kpm-ks.org.

KPM përgatit raporte vjetore, të cilat publikohen, pas miratimit nga Kuvendi.

2. Legjislacioni në lidhje me pluralizmin e mediave

a) Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave⁶⁹

Neni 5

1. "KPM-ja mbështet lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audiovizuale."

Neni 9

6. "Politika e transmetimit promovon zbatimin e dispozitave të cilat parandalojnë monopolizimin e transmetimit në Kosovë duke promovuar konkurrencë të drejtë për ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale."

Neni 22

Vendimarrja e KPM-së gjatë licencimit të Ofruesve të Shërbimeve të Mediave Audiovizive bazohet në kriteret e Rregullores së KPM-së për Lëshimin e Licencës.

b) Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës⁷⁰

Ky ligj përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive. Ky ligj ka të bëjë me tregun, kompetencat dhe organizimin e Autoritetit të Konkurrencës në Kosovë për mbrojtjen e konkurrencës si dhe për procedurat në lidhje me zbatimin e këtij ligji.

Ky ligj vlen për të gjitha ndërmarrjet publike dhe subjektet afariste që janë të regjistruara në Kosovë dhe kryejnë veprimtari ekonomike.

69 <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1335165851.7107.pdf>

70 <https://ak.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/2.LIGJI%20P%C3%8BR%20MBROJTJEN%20E%20KONKURRENC%C3%8BS.pdf>

c) Rregullorja e KPM-së për lëshimin e licencës ⁷¹

Rregullorja që ka të bëjë me procedurat e licencimit.

5. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË MAL TË ZI

1. Themelimi i autoritetit kombëtar rregullator, mandati dhe kompetencat

Autoriteti kombëtar rregullator i Malit të Zi është Agjencia për Media Elektronike e Malit të Zi, e themeluar me Ligjin për Media Elektronike. Kompetencat e AEM ME-së janë:

- hartimi i Programit të Zhvillimit të shërbimeve mediale audiovizive;
- miratimi i projekt-planit të ndarjes së frekuencave të radios;
- lëshimi i licencave të transmetimit dhe licencave për shërbime mediatike audiovizive;
- përcaktimi i tarifave të licencës;
- mbajtja e një regjistri të ofruesve të shërbimeve AVM dhe publikimeve elektronike;
- vendosja për ankesat në lidhje me funksionimin e ofruesve të shërbimeve AVM;
- mbikëqyrja e zbatimit të ligjit;
- miratimi dhe zbatimi i legjislacionit sekondar që shoqëron ligjin;
- kryerja e detyrave të tjera.

Drejtori i AEM ME është organi i shkallës së parë, ndërsa Këshilli i AEM ME vepron si organ i apelit. Procedura e kontesteve administrative mund të iniciohet para Gjykatës Administrative të Malit të Zi. Procedura mund të iniciohet para Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi kundër ndonjë rregulloreje ose urdhëresave të tjera të përgjithshme që rregullojnë punën e ofruesve të shërbimeve të medias audiovizive.

Uebfaqja: www.aemcg.org

Të gjitha vendimet lidhur me procedurat e ankesave ose procedurat ex officio në lidhje me shkeljet e kushteve të licencave publikohen në uebsajt. Gjithashtu, të gjitha planet dhe raportet vjetore financiare dhe operative si dhe raportet vjetore të auditimit publikohen në uebsajt.

2. Legjislacioni në lidhje me pluralizmin e mediave

a) Ligji për mediat elektronike ⁷²

Llojet e transmetuesve
Neni 70

- (1) Me marrjen e licencës së transmetimit, një person juridik ose fizik fiton statusin e transmetuesit.

⁷¹ https://ak.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/2.LIGJI_P%C3%8BR_MBROJTJEN_E_KONKURRENC%C3%8BS.pdf

⁷² <https://aemcg.org/obavjestenje/zakoni/>

- (2) Një transmetues mund të prodhojë dhe transmetojë programe radio dhe/ose televizive si:
- 1) transmetues komercial;
 - 2) transmetues jofitimprurës;
 - 3) transmetues publik.

Transmetues komercial

Neni 71

Një transmetues mund të prodhojë dhe transmetojë programe radio dhe/ose televizive si:

- 1) transmetues komercial kombëtar që mbulon të paktën 75% të popullsisë në më shumë se 10 njësi të vetëqeverisjes lokale (mbulim kombëtar ose rrjet transmetues tregtar);
- 2) transmetues rajonal komercial nëse mbulon të paktën 80% të popullsisë brenda territorit që mbulon midis katër dhe 10 njësive të vetëqeverisjes lokale (mbulimi rajonal ose rrjet komercial i transmetuesit);
- 3) transmetues lokal komercial nëse mbulon të paktën 85% të popullsisë brenda territorit që mbulon më pak se katër njësi të vetëqeverisjes lokale (mbulimi lokal ose rrjeti komercial i transmetuesit).

Transmetues jofitimprurës

Neni 72

- (1) Statusi i transmetuesit jofitimprurës, siç përcaktohet me këtë ligj, përcaktohet nga Këshilli me rastin e dhënies së licencës së transmetimit.
- (2) Dispozitat e nenve 98 deri 115 zbatohen mutatis mutandis në procedurën e dhënies ose revokimit të licencave të transmetimit për transmetuesit jofitimprurës.
- (3) Transmetuesit jofitimprurës mund të jenë vetëm institucione arsimore, organizata fetare, studentore dhe joqeveritare të regjistruara të paktën tre vjet para se të aplikojnë për marrjen e statusit të transmetuesit jofitimprurës.
- (4) Një transmetues jofitimprurës është transmetues i cili transmeton çdo ditë 50% të produksioneve të veta në programe lajmesh, kulturore, arsimore dhe argëtuese, me të paktën 25% të produksionit ditor që u shërben nevojave informuese, arsimore, shkencore, profesionale, kulturore dhe të tjera të publikut.
- (5) Dispozitat e këtij ligji që u referohen detyrimeve programore të transmetuesve publikë vlejnjë edhe për transmetuesit jofitimprurës.
- (6) Fondet për funksionimin e transmetuesve jofitimprurës mund të mblidhen nga donacione, kontribute të qytetarëve, sponsorizime dhe burime të tjera të të ardhurave, në përputhje me një ligj të veçantë që rregullon krijimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare.
- (7) Transmetuesit jofitimprurës përjashtohen nga pagesa e tarifës së licencës së transmetimit.
- (8) Një transmetues jofitimprurës mund të përdorë fitime nga prodhimi dhe transmetimi i programeve në radio dhe/ose televizion vetëm për të përmirësuar dhe zhvilluar aktivitetin e tij.

Transmetuesi publik

Neni 73

- (1) Transmetuesi publik mund të jetë:

- 1) transmetues publik kombëtar, i themeluar nga shteti;
 - 2) transmetues publik rajonal, i themeluar nga disa njësi të vetëqeverisjes lokale;
 - 3) transmetues publik lokal, i themeluar nga një njësi e vetëqeverisjes lokale.
- (2) Transmetuesit publik kombëtarë janë të detyruar të sigurojnë sinjal cilësor të programeve radiotelevizive për të paktën 85% të popullsisë së Malit të Zi (mbulim kombëtar nga një transmetues publik).
- (3) Transmetuesit rajonalë publikë janë të detyruar të sigurojnë sinjal cilësor të programeve radiotelevizive për të paktën 80% të popullsisë së secilës njësi të vetëqeverisjes lokale brenda territorit të së cilës transmetohet programi (mbulimi rajonal nga një transmetues publik).
- (4) Transmetuesit lokalë publikë janë të detyruar të sigurojnë sinjal cilësor të programeve radiotelevizive për të paktën 85% të popullsisë së njësisë së vetëqeverisjes lokale brenda territorit të së cilës transmetohet programi (mbulimi lokal nga një transmetues publik).

VIII. MBROJTJA E PLURALIZMIT DHE DIVERSITETIT TË MEDIAVE ELEKTRONIKE

Transparenca e pronësisë mes ofruesve të shërbimeve AVM Neni 129

- (1) Një shërbim AVM është i obliguar, deri më 31 dhjetor të vitit aktual, t'i sigurojë AEM të dhëna për personat fizikë dhe juridikë (emri, zyra qendrore/vendbanimi) që gjatë vitit janë bërë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi mbajtës të një hiseje ose aksioni në të ofruesit të caktuar të shërbimit AVM, duke dhënë detaje të përqindjes aktuale të një hiseje ose aksioni të tillë.
- (2) Një ofrues i shërbimit të AVM është i detyruar, deri më 31 dhjetor të vitit aktual, t'i sigurojë AEM-së të dhënat për:
- 1) aksionet e tyre të pronësisë në entitete të tjera juridike që ofrojnë shërbime AVM;
 - 2) më shumë se 10% të aksioneve të mbajtura nga pronarët e saj në persona të tjerë juridikë që ofrojnë shërbime AVM.
- (3) AEM është i detyruar të publikojë të dhënat nga paragrafët 1 dhe 2 më lart në Gazetën Zyrtare të Malit të Zi.
- (4) Të dhënat për aksionet dhe palët e interesit deri në 1% të vlerës së kapitalit publikohen së bashku.

Personat e ndërlidhur Neni 130

- (1) Persona të ndërlidhur, në kuptim të këtij ligji, janë personat e lidhur reciprokisht nga administrimi, kapitali ose në ndonjë mënyrë tjetër që u mundëson atyre të vendosin bashkërisht një politikë biznesi për të vepruar sipas marrëveshjes për arritjen e qëllimeve të përbashkëta, ose në mënyrë që një person të ketë aftësinë për të drejtuar një tjetër ose për të ndikuar shumë në vendimet e tyre financiare dhe të biznesit, ose vendimet mbi bazën programore të mediave elektronike.
- (2) Persona të ndërlidhur, në kuptim të këtij ligji, janë:
- 1) anëtarët e ngushtë të familjes (prindërit, fëmijët, vëllezërit e motrat, prindërit adoptues dhe fëmijët);

- 2) persona të lidhur me martesë ose martesë të paregjistruara;
- 3) anëtarë të familjes së ngushtë të bashkëshortëve;
- 4) mbajtësit e një stoku ose aksioni në biznes ose tituj të tjerë që u japin atyre të drejtën për të marrë pjesë në administrimin e një subjekti tjetër me të paktën 20% të të drejtave të votës;
- 5) i njëjti person që mban një stok ose aksion në biznes ose tituj të tjerë që u japin atyre të drejtën për të marrë pjesë në administrimin e një subjekti tjetër me të paktën 20% të të drejtave të votës në të dy entitetet juridike;
- 6) përmes një marrëveshjeje marketingu ose tjetër, kur mbi tre muaj ose më gjatë brenda një viti, ata marrin mbi 30% të të ardhurave nga reklamat;
- 7) duke qenë anëtarë të organeve drejtuese të një personi juridik në të cilin ata kryejnë këtë funksion dhe personat që konsiderohen si persona të lidhur me anëtarët e organeve drejtuese të atij personi juridik në mënyrën e parashikuar nga ky paragraf.

Ekzistenca e përqendrimit të mediave

Neni 131

(1) Përqendrimi i medias ekziston kur një transmetues:

- 1) ka një pjesë në kapitalin themelues të një transmetuesi tjetër, një personi juridik që boton një gazetë ditore ose një personi juridik që kryen veprimtarinë e një agjencie informacioni ose anasjelltas;
- 2) njëkohësisht mban disa licenca transmetimi;
- 3) transmeton njëkohësisht një program në radio dhe një program televiziv;
- 4) transmeton njëkohësisht një program në radio dhe/ose program televiziv dhe boton gazeta ditore të cilat shpërndahen brenda zonës së mbulimit të programit të përmendur në radio dhe/ose televizion;
- 5) transmeton njëkohësisht një program në radio dhe/ose program televiziv dhe ndjek veprimtarinë e agjencive të lajmeve.

(2) Përqendrimi i medias ekziston gjithashtu kur themeluesit e një transmetuesi janë persona fizikë ose juridikë që janë në të njëjtën kohë:

- 1) themelues të një transmetuesi tjetër;
- 2) themelues të një personi juridik që del me shtyp ditor brenda fushës së mbulimit të programeve në radio ose televizion;
- 3) themelues të një agjencie informacioni;
- 4) bashkëshortët dhe bashkëshortët e paregjistruar deri në shkallën e dytë në vijën e drejtpërdrejtë ose anësore të personave fizikë të përmendur në paragrafin 2 pikat 1, 2 dhe 3 më lart.

(3) Një transmetues që mban disa licenca për ofrimin e shërbimeve AVM është i detyruar të mbajë kontabilitet të veçantë në përputhje me ligjin që rregullon praktikën e kontabilitetit

Përqendrimi i paligjshëm i medias **Neni 132**

Përqendrimi i paligjshëm i medias ekziston kur një transmetues:

- 1) që ka licencë për mbulim kombëtar të transmetimit:
 - mban një aksion në kapitalin themelues të një transmetuesi tjetër me licencë identike me më shumë se 25% të aksioneve të kapitalit ose të drejtave të votës,
 - mban më shumë se 10% të aksioneve në kapitalin themelues të një personi juridik që boton media të shtypura ditore me tirazh që tejkalon 3,000 kopje ose anasjelltas,
 - mban më shumë se 10% të aksioneve në kapitalin themelues të një personi juridik që kryen veprimtarinë e një agjencie lajmesh dhe anasjelltas,
 - boton njëkohësisht median e shkruar ditore me tirazh që tejkalon 3000 kopje;
- 2) përveç transmetuesit publik kombëtar, transmeton në të njëjtën zonë të mbulimit më shumë se një televizion dhe një radio program me të njëjtën strukturë ose program të ngjashëm;
- 3) program në radio ose televizion i licencuar për transmetim me mbulim lokal ose rajonal:
 - mban më shumë se 30% të aksioneve në kapitalin themelues të një transmetuesi tjetër me mbulim rajonal ose lokal në të njëjtën zonë;
 - njëkohësisht, në zonë të njëjtë ose në zona fqinje, boton media lokale të shkruara çdo ditë.

Raste të veçanta të përqendrimit të paligjshëm të mediave **Neni 133**

Konsiderohet se përqendrimi i paligjshëm i medias ekziston edhe kur, në rastet nga neni 132 i këtij ligji, një person fizik i cili është themelues i një transmetuesi ose një person i cili është një i afërm në vijë të drejtpërdrejtë (deri në shkallën e dytë) ose bashkëshort ka një pjesë të aksioneve në kapitalin themelues të një transmetuesi tjetër ose themeluesit të një media të shtypur të përditshme ose agjencisë së lajmeve.

Dhënia e licencave dhe përqendrimi i paligjshëm i medias **Neni 134**

AEM nuk jep licencë transmetimi nëse vërtetohet se dhënia e saj do të çonte në përqendrim të paligjshëm të medias brenda kuptimit të këtij Ligji.

(2) Një aplikant për licencë transmetimi është i detyruar, së bashku me aplikimin në konkursin publik për dhënien e të drejtave të transmetimit ose kërkesën për dhënien e licencës së transmetimit, të paraqesë një deklaratë të vërtetuar se nuk do të ndodhë asnjë përqendrim i paligjshëm i medias me dhënien e mundshme të licencës.

(3) Nëse AEM vendos se, pas dhënies së licencës së transmetimit, ka ndodhur përqendrim i paligjshëm i medias, ajo urdhëron transmetuesin, jo më vonë se brenda tre muajsh nga vërtetimi i një fakti të tillë, të korrigjojë parregullsitë në lidhje me përqendrimin e paligjshëm të medias.

(4) Në rast se një transmetues, pa ndonjë arsye të justifikueshme, nuk vepron në përputhje me paragrafin 3 më lart, AEM e revokon atë licencë.

Ndryshimet në strukturën e pronësisë së transmetuesve

Neni 135

(1) Një transmetues është i detyruar të njoftojë AEM me shkrim për çdo ndryshim në strukturën e tij të pronësisë.

(2) Një transmetues siguron miratimin paraprak me shkrim të Këshillit për çdo ndryshim në strukturën e pronësisë që tejkalon 10% të aksioneve.

Nëse Rregullatori përcakton se ndryshimet e planifikuara në strukturën e pronësisë së pasurive kapitale mund të çojnë në shkeljen e pluralizmit mediatik, i rekomandon mbajtësit të licencës për ofrimin e shërbimeve mediatike të bashkërendojë ndryshimet në një mënyrë që do të parandalonte këtë situatë.

Nëse mbajtësi i licencës për ofrimin e shërbimeve mediatike nuk vepron në përputhje me rekomandimin e Rregullatorit, gjë që çon në raste të shkeljes së pluralizmit mediatik të paraparë me ligj, Rregullatori revokon licencën në përputhje me dispozitat e këtij Ligji.

Nëse struktura e aksioneve në pasuritë kapitale të mbajtësit të licencës ndryshon, koncepti i programit në bazë të të cilit është lëshuar licenca nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e Rregullatorit.

Rregullatori specifikon veprimet në përputhje me ndryshimet e raportuara në strukturën e pronësisë.

Detyrimi i transferimit si masë për të mbrojtur pluralizmin e medias **Neni 106**

Rregullatori në mënyrë periodike, të paktën një herë në tre vjet, në tregun kombëtar, krahinor ose ndonjë treg të caktuar gjeografik (përkitazi me rregulloret që drejtojnë mbrojtjen e konkurrencës) krijon një listë të programeve radio ose televizive që transmetohen nga operatorët, rrjeti i komunikimit elektronik të të cilëve për shpërndarjen dhe transmetimin e përmbajtjes mediatike shfrytëzohet nga një numër i konsiderueshëm i përdoruesve të fundit si metoda e vetme ose kryesore për marrjen e përmbajtjes mediatike, në mënyrë që të mbrohet interesi publik dhe pluralizmi mediatik.

Gjatë përpilimit të listës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, Rregullatori respekton parimin e proporcionalitetit dhe transparencës, duke pasur parasysh që detyrimet e përshkuara për Operatorin të mos jenë të paarsyeshme.

Kërkesa për përcaktimin e detyrimit të transmetimit, krahas listës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, i paraqitet organit rregullator përgjegjës për komunikimet elektronike.

b) Ligji për informim publik dhe media⁷⁹

VII MBROJTJA E PLURALIZMIT MEDIATIK

Ndalimi i shkeljes së pluralizmit mediatik

Neni 45

Për të parandaluar shfaqjen ose forcimin e ndikimit mbizotërues në sektorin e informimit publik - i cili kufizon ndjeshëm pluralizmin mediatik - është e ndaluar të bashkohen:

- Të drejtat e themelimit dhe menaxhimit të dy ose më shumë botuesve të gazetave ditore, publikimi i informacionit për të gjitha fushat e jetës sho-

79 https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_javnom_informisanju_i_medijima.html

qërore, tirazhi total vjetor i të cilëve tejkalon 50% të qarkullimit nga shitja, ose realizimi në forma të tjera, të gazetës në territorin e Republikës së Serbisë në një viti kalendarik që paraprin vitin e bashkimit;

- Të drejtat e themelimit ose menaxhimit të dy ose më shumë botuesve që ofrojnë shërbime audio dhe/ose audiovizive - nëse pjesa e vlerësimeve të këtyre botuesve në vitin kalendarik që i paraprin bashkimit, kur kombinohen, do të kalonte 35% të vlerësimeve totale të kombinuara të të gjithë botuesve që ofrojnë shërbime brenda zonës së tyre të mbulimit në të njëjtin vit.

Bashkimi i të drejtave të themelimit dhe/ose menaxhimit nënkupton krijimin e ndikimit vendimtar në mënyrën se si drejtohet biznesi te dy ose më shumë botues. Kjo ka të bëjë veçanërisht me kapacitetin e kompanisë kontrolluese (amë) ose anëtarit ose aksionarit kontrollues, bazuar në pronën ose të drejtat e tjera të pronësisë që kanë të bëjnë me një pronë ose një pjesë të saj, në të drejtat që burojnë nga një kontratë, një marrëveshje ose letra me vlerë, dhe bazuar në pretendime ose instrumente të negociueshme ose në përputhje me praktikën e biznesit.

Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk cenojnë dispozitat e ligjit që rregullojnë mbrojtjen e konkurrencës.

Neni 46

Ndalohet marrja e mbi 50% të aksioneve në kapitalin e autorizuar midis një botuesi të një gazete ditore që boton informacion për të gjitha fushat e jetës shoqërore, qarkullimi mesatar i të cilëve tejkalon 50,000 kopje në vit, dhe një botuesi që ofron shërbime të mediave audio ose audiovizive.

Personi i cili, përveç veprimtarisë së tij në botimin e mediave, merret edhe me shpërndarjen e përmbajtjes mediatike, është i detyruar të kryejë aktivitetet publikuese përmes një personi të ndërlidhur juridik.

Personat juridikë të ndërlidhur, brenda kuptimit të këtij ligji, janë ata persona që janë të lidhur në atë mënyrë që një ose më shumë prej tyre të kenë mundësinë për të përcaktuar ndikimin në menaxhimin e operacioneve mbi personin tjetër juridik ose personat e tjerë juridikë. Ky ndikim lind veçanërisht nga:

- 1) roli i kompanisë (amë) kontrolluese, d.m.th., anëtarit ose aksionari kontrollues, në mënyrë të pavarur ose përmes veprimtarisë së përbashkët, sipas rregullave për kompanitë e ndërlidhura brenda kuptimit të ligjit që rregullon qëndrimet e kompanive;
- 2) pronësia ose llojet e tjera të të drejtave për pasurinë ose një pjesë të pasurisë së një personi tjetër juridik;
- 3) një kontratë, një marrëveshje ose të drejtat e pronësisë mbi letrat me vlerë;
- 4) llogaritë e arkëtimit, mjetet e sigurisë ose kushtet e praktikës së biznesit mbajtësi i të cilave është ose përcaktohet nga një person i kontrolluar.

Identifikimi i një kërcënimi ndaj Pluralizmit Mediatik

Neni 47

Një kërcënim ndaj pluralizmit mediatik në rastin e mediave të shtypura identifikohet nga ministria përgjegjëse për informim dhe nëse ka bashkim ose blerje të brendshme të aksioneve, kur përfshihet të paktën një medium elektronik, kërcënimi identifikohet nga një organ i pavarur rregullator, në përputhje me ligjin që rregullon mediat elektronike.

Ministria përgjegjëse për informim fillon procedurën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni pas një raporti të një pale të interesuar.

Pasi ministria e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni të ketë vërtetuar se pluralizmi mediatik është kërcënuar, ajo njofton botuesin për këtë dhe urdhëron që brenda gjashtë muajve nga data e marrjes së njoftimit të dorëzohen prova për ndërmarrjen e veprimeve për t'i eliminuar shkaqet e kërcënimit të pluralizmit mediatik.

Ministria e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, duke vepruar në cilësi zyrtare, informon Regjistrin për njoftimin e lëshuar botuesit.

Nëse botuesi i një media të shtypur nuk vepron në përputhje me njoftimin e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, Regjistri, pas vendimit të ministrisë, fshin mediumin në fjalë nga Regjistri.

c) Ligji për mbrojtjen e konkurrencës⁸⁰

Ky ligj zbatohet për mediat në Republikën e Serbisë, pasi zbatohet për të gjitha kompanitë e regjistruara në përputhje me Aktin e Kompanive.

Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës mbi përqendrimin e të gjitha kompanive, përfshirë mediat, janë si më poshtë:

Obligimi për të raportuar përqendrimin **Neni 61**

Përqendrimi duhet t'i raportohet Komisionit në rastin e:

- 1) Të ardhurat totale vjetore të të gjithë pjesëmarrësve të përqendrimin të gjeneruar në tregun ndërkombëtar në vitin paraprak financiar i kalojnë 100 milion EUR, me kusht që të paktën një e ardhur e pjesëmarrësit në përqendrimin të gjeneruar në tregun e Republikës së Serbisë të kalojë dhjetë milion euro;
- 2) Të ardhurat totale vjetore të të paktën dy pjesëmarrësve të përqendrimin të gjeneruara në tregun e Republikës së Serbisë tejkalojnë 20 milion euro në vitin paraprak financiar, me kusht që të paktën dy pjesëmarrës të përqendrimin të gjenerojnë të ardhura në tregun e Republikës së Serbisë tejkalojnë një milion euro për pjesëmarrës, në të njëjtën periudhë;

Të ardhurat e krijuara nga këto ndërmarrje në një shkëmbim reciprok nuk shtohen gjatë llogaritjes së të ardhurave totale vjetore sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Përqendrimi i zbatuar me anë të një oferte për blerje, brenda kuptimit të rregullores që rregullon blerjen e kompanive aksionare, duhet të raportohet edhe nëse kushtet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk janë përmbushur.

Hetimi i përqendrimin sipas detyrës zyrtare **Neni 62**

Me të kuptuar për përqendrimin e zbatuar, Komisioni mund të kryejë një hetim të përqendrimin nëse konstaton se pjesa e përbashkët e tregut të pjesëmarrësve të përqendrimin në tregun e Republikës së Serbisë është të paktën 40%, d.m.th, në mënyrë të arsyeshme supozohet se përqendrimi nuk përmbush kushtet e lejueshmërisë nga neni 19 i këtij ligji si dhe në rastin e përqendrimin tjetër të pa aprovuar në përputhje me këtë ligj.

Nëse gjatë procedurës së përqendrimin të raportuara përcaktohet se kushtet për fillimin e procedurës hetimore sipas detyrës zyrtare janë përmbushur sipas paragrafit 1

80 <http://www.kzk.gov.rs/kzk/wp-content/uploads/2011/07/Law-on-Protection-of-Competition2.pdf>

të këtij neni, procedura vazhdon sipas detyrës zyrtare bazuar në konkluzionin e nxjerrë nga Presidenti i Komisionit.

Komisioni bart barrën e provës së ekzistencës së pjesës së tregut dhe kushteve të përfshira në paragrafin 1 të këtij neni.

Komisioni është i detyruar të miratojë një vendim në procedurën e përqendrimit brenda katër muajsh nga data e fillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare.

d) Rregullore për procedurën e miratimit të aktit për transferimin e licencës për ofrimin e shërbimeve mediatike dhe procedurën në përputhje me një njoftim për ndryshime në strukturën e pronësisë, miratuar nga Këshilli REM në 7 nëntor 2015 .⁸¹

I. DISPOZITA HYRËSE

Neni 1

Kjo rregullore rregullon në detaje përmbajtjen e kërkesës për miratimin e aktit për transferimin e licencës për ofrimin e shërbimeve mediatike (në tekstin e mëtejshëm: licenca), dokumentet që duhet të paraqiten bashkë me kërkesën dhe procedurën nga Autoriteti Rregullator për Media Elektronike (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) në përputhje me kërkesën e paraqitur. Ai po ashtu rregullon përmbajtjen e njoftimit për ndryshime në strukturën e pronësisë të kapitalit të aksioneve, dhe dokumentet që duhet të paraqiten me njoftimin dhe procedurën nga Rregullatori bazuar në kërkesat e paraqitura.

II. PROCEDURA PËR MIRATIMIN E AKTIT PËR TRANSFERIM TË LICENCËS

1. Transferimi i licencës në rast të ndryshimeve të statusit

Kërkesë për miratim

Neni 2

Një licencë e lëshuar në një konkurrencë publike nuk është e transferueshme, përveç në rastet e ndryshimit të statusit të mbajtësit të licencës, siç përcaktohet nga ligji që rregullon statusin e kompanive dhe me kusht që ajo të mos çojë në shkelje të pluralizmit mediatik siç përshkruhet me rregulloren për informim publik dhe media.

Bartësi i licencës për ofrimin e shërbimeve mediatike (në tekstin e mëtejshëm: mbajtësi i licencës) i paraqet Rregullatorit, drejtpërdrejt ose me postë, kërkesën për miratim të aktit për transferimin e licencës.

Nëse më shumë se një mbajtës i licencës është i përfshirë në ndryshimin e statusit, ata së bashku paraqesin kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni.

Përmbajtja e kërkesës

Neni 3

Kërkesa për miratim duhet të përmbajë llojin e ndryshimit të statusit që mbajtësi i licencës synon të bëjë, në të cilin personat juridikë janë të përfshirë në ndryshimin e statusit dhe ku personi juridik do të ishte mbajtës i licencës pasi të jetë bërë ndryshimi i statusit.

⁸¹ http://www.rem.rs/uploads/files/Podzakonska_regulativa/Pravilnik_o_postupku_izdavanja_saglasnosti_na_akt_o_prenosu_dozvoleza_pruzanje_medijske_usluge_i_postupanje_po_prijavi_promene_vlasnicke_strukture.pdf

Dokumentet që paraqiten me kërkesën

Neni 4

Kërkesës për miratim i bashkëngjitet drafti i marrëveshjes për ndryshimin e statusit, ose një projekt plan të ndarjes nëse vetëm një person juridik është i përfshirë në ndryshimin e statusit.

Nëse procedura e ndryshimit të statusit përfshin gjithashtu një person juridik i cili nuk është mbajtës i licencës dhe i cili nuk është i lidhur me ndonjë mbajtës tjetër të licencës, dokumentit nga paragrafi 1 i këtij neni i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

- 1) një ekstrakt nga regjistri i mbajtur nga autoriteti kompetent për personin juridik përkatës;
- 2) një deklaratë me të dhëna mbi personin juridik (emri, vendi, struktura e pronësisë dhe numri i regjistrimit) ose personin fizik (emri, vendbanimi dhe numri unik i identifikimit personal (JMBG) ose numri i pasaportës dhe emri i shtetit që lëshon pasaporta në rast të shtetasve të huaj) të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përmes subjekteve të tjerë, kanë një stok (aksione, etj.) në strukturën e pronësisë së entitetit të tillë ekonomik dhe të dhëna për shumën e këtyre aksioneve, saktësia e të cilave garantohehet nga Nënshkrimi i aplikantit;
- 3) dëshmi se personi juridik, i cili do të jetë mbajtës i licencës pasi të jetë bërë ndryshimi i statusit, do të përmbushë kërkesat teknike dhe organizative për prodhimin e programit, në bazë të të cilit është lëshuar licenca, si dhe planin e konceptit organizativ-teknik dhe strukturën e burimeve njerëzore.

Nëse procesi i ndryshimit të statusit përfshin më shumë se një mbajtës licence ose person juridik të lidhur me një mbajtës tjetër të licencës, së bashku me dokumentin nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të paraqiten edhe dokumentet e mëposhtme:

- 1) deklaratën që tregon mbajtësin e licencës me të cilën personi i tillë juridik është i lidhur dhe në cilën mënyrë;
- 2) deklaratën nga përfaqësuesit ligjorë të aplikuesit ose aplikantëve se ndryshimi i statusit nuk do të rezultojë në shkelje të pluralizmit të medias, në përputhje me nenin 45, paragrafi 1, pika 2, dhe nenin 46 të Ligjit për Informimin Publik dhe Mediat ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 83/14 dhe 58/15), ose që të dhënat e anketimit për matje të audiencës së regjistruar në zonën e mbulimit gjatë vitit kalendarik që i paraprin bashkimit të mos kalojë 35% të audiencës totale në zonën e mbulimit.

Aplikanti po ashtu dorëzon dokumente të tjera të kërkuara nga Rregullatori në përputhje me ligjin.

Aplikanti mund të paraqesë edhe dokumente të tjera nëse beson se ato mund të jenë të rëndësishme për vendimmarrje.

Dokumentet e paraqitura janë kopje origjinale dhe të vërtetuara.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj përkthehen në gjuhën serbe dhe vërtetohen nga një përkthyes gjyqësor.

Plotësimi i kërkesës

Neni 5

Nëse kërkesa nuk është e plotë ose përmban të dhëna të pasakta, ose nëse dokumentet që i janë bashkëngjitur kërkesës nuk janë të plota, Rregullatori i lejon aplikantit një afat të përshtatshëm, jo më të gjatë se 30 ditë, për të korrigjuar defektet e identifikuara.

Nëse aplikanti nuk korrighon defektet brenda afatit të caktuar, kërkesa refuzohet në përputhje me nenin 58, paragrafi 2, të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 33/97 dhe 31/01 dhe "Gazeta Zyrtare RS", Nr. 30/10).

Mbrojtja e pluralizmit mediatik

Neni 6

Nëse procesi i ndryshimit të statusit përfshin disa mbajtës të licencave ose një entitet të lidhur me një mbajtës tjetër të licencës, Rregullatori, duke ndjekur metodologjinë e përshkruar nga ligji që ai miraton, në përputhje me nenin 22, paragrafi 1, pika 16) të Ligjit për Media Elektronike, përcakton nëse ndryshimi i planifikuar i statusit mund të rezultojë në një situatë që shkel pluralizmin mediatik.

Marrja e vendimit për kërkesën

Neni 7

Rregullatori, me vendim të tij, refuzon kërkesën nëse ka përcaktuar që personi juridik, i cili do të ishte mbajtësi i licencës pas ndryshimit të statusit, nuk do të përmbushte kërkesat nga neni 4, paragrafi 2, pika 3) të kësaj Rregulloreje ose nëse përcakton se ndryshimi i statusit do të rezultojë në një situatë që shkel pluralizmin e medias.

Rregullatori vendos të miratojë për aktin për transferimin e licencës nëse përcakton se personi juridik, i cili do të ishte mbajtësi i licencës pas ndryshimit të statusit, do të përmbushte kërkesat nga neni 4, paragrafi 2, pika 3) të kësaj Rregulloreje ose nëse përcakton se ndryshimi i statusit nuk do të rezultonte në një situatë që shkel pluralizmin e medias.

Vendimet nga paragrafi 2 i këtij neni përfshijnë një urdhër personit juridik, të cilit i transferohet licenca përmes ndryshimit të statusit, të paraqesë marrëveshjen e nënshkruar për ndryshimin e statusit, planin e ndarjes dhe dëshmi se është kryer ndryshimi i statusit.

2. Transferimi i licencës së lëshuar sipas kërkesës.

Kërkesa për aprovim

Neni 8

Licenca e lëshuar me kërkesë mund t'i transferohet një personi tjetër vetëm nëse ata persona pranojnë të gjitha detyrimet që rezultojnë nga licenca.

Mbajtësi i licencës duhet të paraqesë, drejtpërsëdrejti ose me postë, te Rregullatori, kërkesën për miratim të bartjes së licencës.

Nëse licenca transferohet te një mbajtës i licencës, mbajtësit e licencës që marrin pjesë në transferim së bashku paraqesin kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni.

Përmbajtja e kërkesës

Neni 9

Kërkesa për miratim deklaron se cili person juridik do të ishte mbajtësi i licencës pasi të jetë bërë transferimi.

Dokumentet që paraqiten me kërkesën

Neni 10

Kërkesa për miratim përfshin draftin e marrëveshjes për transferimin e licencës dhe një deklaratë nga përfaqësuesi ligjor i personit juridik të cilit i transferohet licenca që ky entitet pranon të gjitha detyrimet që rezultojnë nga licenca.

Nëse licenca i transferohet një personi juridik i cili nuk është mbajtës i licencës dhe as nuk është i lidhur me ndonjë mbajtës të licencës, bashkë me dokumentet nga paragrafi 1 i këtij neni, bashkëngjiten edhe dokumentet e mëposhtme:

- 1) një ekstrakt nga regjistri i mbajtur nga autoriteti kompetent për personin juridik përkatës;
- 2) një deklaratë me të dhëna mbi personin juridik (emri, vendi, struktura e pronësisë dhe numri i regjistrimit) ose personin fizik (emri, vendbanimi dhe numri unik i identifikimit personal (JMBG) ose numri i pasaportës dhe emri i shtetit që lëshon pasaporta në rast të shtetasve të huaj) të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përmes subjekteve të tjerë, kanë një stok (aksione, etj.) në strukturën e pronësisë së entitetit të tillë ekonomik dhe të dhëna për shumën e këtyre aksioneve, saktësia e të cilave garantohej nga nënshkrimi i aplikantit;
- 3) dëshmi se personi juridik, i cili do të jetë mbajtës i licencës pasi të jetë bërë ndryshimi i statusit, do të përmbushë kërkesat teknike dhe organizative për prodhimin e programit, në bazë të të cilit është lëshuar licenca, si dhe planin e konceptit organizativ-teknik dhe strukturën e burimeve njerëzore.

Nëse licenca i transferohet një personi juridik që është mbajtës i licencës ose entitet juridik që është i lidhur me ndonjë mbajtës të licencës, sipas kriterëve të identifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, bashkëngjiten edhe dokumentet e mëposhtme:

- 1) deklarata që tregon mbajtësin e licencës me të cilën personi i tillë juridik është i lidhur dhe në cilën mënyrë;
- 2) deklarata nga përfaqësuesit ligjorë të aplikuesit ose aplikantëve se ndryshimi i statusit nuk do të rezultojë në shkelje të pluralizmit të medias, në përputhje me nenin 45, paragrafi 1, pika 2, dhe nenin 46 të Ligjit për Informimin Publik dhe Mediat ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 83/14 dhe 58/15), ose që të dhënat e anketimit për matje të audiencës së regjistruar në zonën e mbulimit gjatë vitit kalendarik që i paraprin bashkimit të mos kalojë 35% të audiencës totale në zonën e mbulimit.

Aplikanti që plotëson kërkesën po ashtu dorëzon dokumente të tjera të kërkuara nga Rregullatori në përputhje me ligjin.

Aplikanti mund të paraqesë edhe dokumente të tjera nëse beson se ato mund të jenë të rëndësishme për vendimmarrje.

Dokumentet e paraqitura janë kopje origjinale dhe të vërtetuara.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj përkthehen në gjuhën serbe dhe vërtetohen nga një përkthyes gjyqësor.

Vlerësimi i plotësimit të kërkesës

Neni 11

Nëse kërkesa nuk është e plotë ose përmban të dhëna të pasakta, ose nëse dokumentet që i janë bashkëngjitur kërkesës nuk janë të plota, Rregullatori i lejon aplikantit një afat të përshtatshëm, jo më të gjatë se 30 ditë, për të korrigjuar defektet e identifikuar.

Nëse aplikanti nuk korrigjon defektet brenda afatit të caktuar, kërkesa refuzohet në përputhje me nenin 58, paragrafi 2, të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 33/97 dhe 31/01 dhe "Gazeta Zyrtare RS", Nr. 30/10).

Mbrojtja e pluralizmit mediatik

Neni 12

Nëse licenca i transferohet një entiteti juridik, i cili është mbajtës i licencës ose entitet juridik i lidhur me një mbajtës të licencës, Rregullatori, duke ndjekur metodologjinë e përshkruar me një akt nënligjor që miraton, në përputhje me nenin 22, paragrafi 1, pika 16) të Ligjit për Media Elektronike, përcakton nëse transferimi i planifikuar i licencës mund të rezultojë në një situatë që shkel pluralizmin mediatik.

Marrja e vendimit për kërkesën

Neni 13

Rregullatori, me vendim të tij, refuzon kërkesën nëse ka përcaktuar që personi juridik, të cilit i transferohet licenca, nuk përmbush kërkesat nga neni 10, paragrafi 2, pika 3) të kësaj Rregulloreje ose nëse përcakton se transferimi i licencës do të rezultonte në një situatë që shkel pluralizmin e medias, ose nëse përcakton se person privat të cilit do t'i transferohej licenca nuk i pranon të gjitha obligimet.

Rregullatori vendos të miratojë aktin për transferimin e licencës nëse përcakton se personi juridik, të cilit i transferohet licenca, do të përmbushte kërkesat nga neni 10, paragrafi 2, pika 3) të kësaj Rregulloreje ose nëse përcakton se transferimi i licencës nuk do të rezultonte në një situatë që shkel pluralizmin mediatik, ose nëse personi privat, të cilit i transferohet licenca, i pranon të gjitha obligimet.

Vendimet nga paragrafi 2 i këtij neni përfshijnë një urdhër që aplikanti të paraqesë marrëveshjen e nënshkruar për transferimin e licencës.

III. PROCEDURA PAS NJOFTIMIT TË NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN E PRONËSISË

Njoftimi i ndryshimit në strukturën e pronësisë

Neni 14

Mbajtësi i licencës njofton Rregullatorin me shkrim për çdo ndryshim të strukturës së pronësisë së kapitalit të aksioneve (ndryshimi i themeluesit ose ndryshimi i aksioneve të themeluesit në kapital) duke paraqitur një raport mbi ndryshimin në strukturën e pronësisë.

Ndryshimi i strukturës së pronësisë për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni nënkupton çdo ndryshim në kapitalin e aksioneve të mbajtësve të licencës dhe ndryshimin në kapitalin e aksioneve të personit juridik që merr pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi në strukturën e pronësisë.

Raporti mbi ndryshimet në strukturën e pronësisë i dorëzohet Rregullatorit nga mbajtësi i licencës drejtpërsëdrejti ose me postë.

Përmbajtja e raportit

Neni 15

Raporti për ndryshimin në strukturën e pronësisë tregon llojin e ndryshimit të synuar në strukturën e pronësisë (p.sh., ndryshimi i themeluesit ose ndryshimi i aksioneve të themeluesit në kapital), informacione për personat juridikë që marrin pjesë në ndryshim dhe struktura e pronësisë pasi të jetë bërë ndryshimi (themeluesit dhe aksionet në kapitalin e tyre).

Dokumentet që paraqiten me raportin Neni 16

Nëse ndryshimi i strukturës së pronësisë përfshin edhe një person juridik i cili është mbajtës i licencës, që ka hise indirekte ose të drejtpërdrejta në kapitalin e një mbajtësi tjetër të licencës ose të lidhur me një mbajtës tjetër të licencës, raporti për ndryshimet e strukturës së pronësisë do të përfshijë me sa vijon:

- 1) të dhëna në lidhje me licencën që ka subjekti ose mbajtësi i licencës me të cilën është lidhur ky entitet dhe në cilën mënyrë;
- 2) deklaratë nga përfaqësuesit ligjorë të entitetit që dorëzon raportin se ndryshimi i strukturës së pronësisë nuk do të rezultojë në shkelje të pluralizmit të medias, në përputhje me nenin 45, paragrafi 1, pika 2, dhe nenin 46 të Ligjit për Informimin Publik dhe Mediat ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 83/14 dhe 58/15), ose që të dhënat e anketimit për matje të audiencës së regjistruar në zonën e mbulimit gjatë vitit kalendarik që i paraprin bashkimit tregojnë se audiencia nuk kalon 35% të audiencës totale në zonën e mbulimit.

Nëse ndryshimi në strukturën e pronësisë përfshin edhe një person juridik i cili nuk është mbajtës i licencës dhe i cili nuk është i lidhur me ndonjë mbajtës tjetër të licencës raport mbi ndryshimin e strukturës së pronësisë po ashtu përmban dokumentet e mëposhtme:

- 1) nëse themeluesi i ardhshëm është person juridik:
 - (1) një ekstrakt nga regjistri i mbajtur nga autoriteti kompetent për personin juridik përkatës;
 - (2) një deklaratë me të dhëna mbi personin juridik (emri, vendi, struktura e pronësisë dhe numri i regjistrimit) ose personin fizik (emri, vendbanimi dhe numri unik i identifikimit personal (JMBG) ose numri i pasaportës dhe emri i shtetit që lëshon pasaporta në rast të shtetasve të huaj) të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përmes subjekteve të tjerë, kanë një stok (aksione, etj.) në strukturën e pronësisë së entitetit të tillë ekonomik dhe të dhëna për shumën e këtyre aksioneve, saktësia e të cilave garantohet nga nënshkrimi i aplikuesit;
 - (3) një deklaratë me të dhëna për personin juridik (emri, selia, struktura e pronësisë dhe numri i regjistrimit) në të cilën themeluesi ose themeluesi i ardhshëm i entitetit që paraqet raportin ka hise në kapitalin e aksioneve dhe të dhënat mbi entitetin juridik me të cilin është i lidhur themeluesi i ardhshëm i entitetit që paraqet raportin, siç parashihet me ligjin që rregullon statusin juridik të kompanive, saktësia e të cilit garantohet nga nënshkrimi i aplikuesit;
- 2) nëse themeluesi i ardhshëm është person fizik:
 - (1) kopje të letërnjoftimit të personit, ose kopje të pasaportës në rastin e një shtetasi të huaj;
 - (2) një deklaratë me të dhëna për personin juridik (emri, selia, struktura e pronësisë dhe numri i regjistrimit) në të cilën personi fizik ka hise në kapitalin e aksioneve dhe të dhëna mbi personat juridikë me të cilët është i lidhur personi fizik, siç parashihet me ligjin që rregullon statusin juridik të kompanive, saktësia e të cilit garantohet nga nënshkrimi i aplikuesit.

Entiteti që dorëzon raportin po ashtu dorëzon dokumente të tjera të kërkuara nga Rregullatori në përputhje me ligjin.

Entiteti që dorëzon raportin mund të paraqesë edhe dokumente të tjera nëse beson se ato mund të jenë të rëndësishme për vendimmarrje.

Dokumentet e paraqitura janë kopje origjinale dhe të vërtetuara.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj përkthehen në gjuhën serbe dhe vërtetohen nga një përkthyes gjyqësor.

Vlerësimi i plotësimit të raportit

Neni 17

Nëse raporti nuk është i plotë ose përmban të dhëna të pasakta, ose nëse dokumentet që i janë bashkëngjitur raportit nuk janë të plota, Rregullatori i lejon aplikantit një afat të përshtatshëm, jo më të gjatë se 30 ditë për të korrigjuar defektet e identifikuara.

Nëse entiteti që dorëzon raportin nuk korrigjon defektet brenda afatit të caktuar, raporti refuzohet në përputhje me nenin 58, paragrafi 2, të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 33/97 dhe 31/01 dhe "Gazeta Zyrtare RS", Nr. 30/10).

Përcaktimi i shkeljes së pluralizmit mediatik

Neni 18

Rregullatori, duke ndjekur metodologjinë e përshkruar nga ligji që ai miraton, në përputhje me nenin 22, paragrafi 1, pika 16) të Ligjit për Media Elektronike, përcakton nëse ndryshimi i planifikuar i strukturën e pronësisë mund të rezultojë në një situatë që shkel pluralizmin mediatik.

Marrja e vendimit për raportin

Neni 19

Nëse Rregullatori përcakton se ndryshimi i synuar i strukturës së pronësisë së mbajtësit të licencës nuk do të rezultojë në një situatë që shkel pluralizmin e medias, Rregullatori merr vendim në atë frymë.

Nëse Rregullatori përcakton që ndryshimi i synuar i strukturës së pronësisë së mbajtësit të licencës mund të rezultojë në një situatë që shkel pluralizmin e medias, Rregullatori merr vendim duke i rekomanduar mbajtësit të licencës të harmonizojë harmonizuar ndryshimet në mënyrë që të shmangët një situatë e tillë.

Nëse mbajtësi i licencës nuk vepron në përputhje me rekomandimin e Rregullatorit, që rezulton me raste të pluralizmit mediatik, siç parashihet me ligj, Rregullatori revokon licencën në përputhje me nenin 89, paragrafi 1, pika 6) të Ligjit për Media Elektronike.

Shtojca 2:

Raste që lidhen me pluralizmin e mediave

1. SHQIPËRI

Vendimet e AMA-s

Gjatë shqyrtimit të kërkesave për licencë transmetuese, kishte diskutime për këtë temë. Mes tjerash, kishte një sqarim të situatave të pronësisë së tërthortë (p.sh., kompania amë) e cila merrte parasysh pronësinë e tërthortë të një kompanie aksionare me dy kompani të tjera, ku secila ka licencë në tregun e transmetimeve audiovizive.

Vendimet e autoriteteve të tjera

Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës, që daton nga 25 qershori 2018, "Për lëshimin e disa rekomandimeve për Autoritetin e Mediave Audiovizive", një vendim në lidhje me vendimin e lartpërmendur të AMA-s, i cili merrte parasysh pronësinë e tërthortë të një kompanie aksionare me dy kompani të tjera, ku secila ka licencë në tregun e transmetimeve audiovizive.

2. BOSNJË DHE HERCEGOVINË

Transparenca e pronësisë së mediave në Bosnjë dhe Hercegovinë rregullohet vetëm pjesërisht përmes procesit të regjistrimit të bizneseve dhe organizatave në pronësi të mediave.

CRA mban një regjistër⁸² të të gjithë të licencuarve të tij që përmban informacione mbi personin juridik ose fizik që ka në pronësi ofruerin e shërbimit mediatik në fjalë, por nuk përmban informacion mbi strukturën e pronësisë së mbajtësve të licencës, d.m.th., pronësisë së tërthortë. Edhe pse CRA ishte e interesuar të bënte këto informata publike, ajo nuk mori opinion pozitiv për këtë çështje nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave për shkak të ndërhyrjes në të drejtën e privatësisë dhe përpunimin e të dhënave personale.

82 Shih këtu: <https://rak.ba/bs-Latn-BA/brdcst-license-holders>

Megjithatë, edhe po të mund të mbante CRA një regjistër të tillë, kjo do të kufizohej në mediat elektronike, të cilat përfaqësojnë vetëm një pjesë të tregut të përgjithshëm të mediave. Këshilli i Mediave të Shtypit dhe Elektronike në Bosnjë dhe Hercegovinë e bën të pamundur vlerësimin e pronësisë së përzier.

Mungesa e legjislacionit adekuat pasqyrohet veçanërisht në mediat elektronike, të cilat shpesh nuk regjistrohen as si biznese mediatike. Nuk ka një regjistër të veçantë të mediave elektronike, por vetëm ato të krijuara si subjekte afariste, të cilat janë të shpërndara në një varg regjistrash të ndryshëm varësisht nga gjykata ku është bërë regjistrimi. Askush nuk e di numrin e saktë të mediave elektronike në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe për shumë prej tyre, informatat në lidhje me strukturën e pronësisë, metodat e financimit dhe punonjësit janë plotësisht të panjohura. Mediat elektronike me mbulim kombëtar (.ba) ofrojnë një farë transparence falë informacionit të siguruar nga Qendra Universitare për Informim, e cila është përgjegjëse për lëshimin e domeneve ".ba". Në uebsajtin e tyre www.nic.ba, është e mundur të përcaktohet pronësia e secilës faqe me domen kombëtar, por këto informata nuk ofrojnë një pasqyrë të detajuar të ekzistencës së pronarëve të tërthortë ose të ndërlidhur⁸³.

Vendimet e CRA-s

Gjatë procesit të licencimit të transmetuesve tokësorë, në rastet kur ka dy ose më shumë aplikantë në të njëjtën zonë gjeografike që plotësojnë të gjitha kriteret për marrje të licencës, CRA zbaton një analizë krahasuese ku preferenca i jepet aplikantit që ofron përmbajtjen e programit e cila ose mungon ose është e rrallë në atë zonë gjeografike.

Për sa i përket çështjeve të pronësisë, ekziston një kufizim i pronësisë nga partitë politike. Respektivisht, sipas Ligjit për Financimin e Partive Politike⁸⁴, Neni 2, kompanitë në pronësi të partive politike mund të kryejnë vetëm aktivitete kulturore ose botuese. Kjo do të thotë që një parti politike nuk mund të jetë pronare e një kompanie që mban licencë transmetimi.

Për më tepër, kufizime të caktuara zbatohen për pronësinë e investimeve të huaja të kompanive të huaja, në përputhje me Ligjin për Politikën e Investimeve të Huaja Direkte në Bosnjë dhe Hercegovinë⁸⁵, neni 4:

“(a) Pavarësisht nga politika e pranimit të lirë të investimeve të huaja direkte në Bosnjë dhe Hercegovinë të përcaktuara në Nenin 3 të këtij Ligji, aksionet e kapitalit të huaj të një entiteti biznesi të angazhuar në prodhimin dhe shitjen e armëve, municioneve, eksplozivëve për përdorim ushtarak, pajisjet ushtarake dhe media nuk mund të kalojnë 49% të kapitalit në atë entitet ekonomik.

83 <https://bhnovinari.ba/wp-content/uploads/2019/09/Media-Ownership-Transparency.pdf>

84 <http://www.ohr.int/ohr-dept/legal/laws-of-bih/pdf/New2015/BH%20Law%20on%20Political%20Party%20Financing%2095-12.pdf>

85 http://www.fipa.gov.ba/publikacije_materijali/zakoni/05.08.2016.Cleansed%20text%20of%20the%20LAW%20ON%20THE%20POLICY%20OF%20FOREIGN%20DIRECT%20INVESTMENT%20IN%20BiH.pdf

(b) Në rast të investimeve në sektorë që u nënshtrohen kufizimeve të përmendura në paragrafin (a) të këtij neni, investitorët e huaj duhet të marrin miratimin paraprak nga organi kompetent i entitetit përkatës."

Në atë kuptim, gjatë procesit të licencimit ose kërkesave për miratim të ndryshimit në strukturën e pronësisë që përfshin investime të huaja, CRA i kërkon aplikantit të paraqesë mendimin e organit kompetent.

Sipas mendimeve të marra nga CRA në rastet e mëparshme, rastet në të cilat një kompani e themeluar në Bosnjë dhe Hercegovinë ka pronësi të huaj nuk përbëjnë investim të huaj të drejtpërdrejtë.

CRA vendos për kërkesat për transferimin e licencës ose ndryshimet në pronësinë origjinale të të licencuarit që tejkalon 5% të aksioneve, në përputhje me nenin 22, paragrafi (2) dhe (3) të Rregullores 77/2015 për ofrimin e shërbimeve të mediave audiovizive. Gjatë kësaj procedure, Agjencia shqyrton nëse struktura e ndryshuar e pronësisë do të sigurojë të paktën të njëjtat standarde dhe kushte në bazë të të cilave u lëshua licenca në radhë të parë. Për ta vërtetuar këtë, Agjencia i kërkon aplikantit të sigurojë dokumentacionin përkatës financiar, pëlqimet me shkrim të të gjithë pronarëve, si dhe deklaratën për çdo ndryshim në program, operacionet teknike ose financiare që kanë ndodhur që nga lëshimi i licencës.

Duhet të theksohet se ndryshimi në strukturën e pronësisë së një kompanie nuk është në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të Agjencisë. Andaj, pëlqimi paraprak i Agjencisë nuk kërkohet nga gjykata për të kryer ndryshimin aktual. Pëlqimi i Agjencisë kërkohet për të ruajtur licencën e transmetimit, në mënyrë që të garantohet që pronarët e rinj të vazhdojnë të respektojnë të njëjtat kriteret dhe kushte të aprovuara nga Agjencia kur lëshon licencën.

Në rastet kur vërtetohet se ndryshimi në strukturën e pronësisë që tejkalon 5% të aksioneve ka ndodhur pa miratimin paraprak të CRA, Agjencia mund të shqiptojë një sanksion për shkeljen e Rregullores 77/2015. Pavarësisht nga shkëlja e vërtetuar, ajo ende mund të kryejë procedurën e duhur dhe të lëshojë një pëlqim pasues.

Vendimet e autoriteteve të tjera

Këshilli i Konkurrencës ka miratuar tri vendime në lidhje me shpërndarjen e kanalit "Sport Klub" përkatësisht në 2013, 2015 dhe 2017.

Baza legjislative: Ligji për Konkurrencën i Bosnjë dhe Hercegovinës⁸⁶, Neni 10 (Shpërdorimi i pozitës dominuese):

- a) imponimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i çmimeve të padrejta të blerjes dhe shitjes ose kushte të tjera tregtare që kufizojnë konkurrencën;
- b) kufizimi i produksioneve, tregjeve ose zhvillimit teknik në dëm të konsumatorëve;
- c) aplikimi i kushteve të ndryshme për transaksione ekuivalente ose të ngjashme me palët e tjera, duke i vendosur ato në një pozitë të pabarabartë dhe të pafavorshme konkurruese;

86 <http://bihkonk.gov.ba/en/competition-act-unofficial-consolidated-text.html>

d) lidhja e kontratave që i nënshtrohen pranimit nga pala tjetër e detyrimeve shtesë të cilat, për nga natyra e tyre ose praktika tregtare, nuk kanë asnjë lidhje me një temë të një kontrate të tillë.

1) Në vendimin e parë, u vërtetua se kompania IKO Balkan SRL G-RAL David Prapogescu, Rumani, drejtpërsëdrejti dhe/ose përmes përfaqësuesit të tij Sport Klub d.o.o Sarajevë, kishte abuzuar me pozitën dominuese në tregun e shpërndarjes së kanaleve sportive me përmbajtje futbollit, që përfshinte pakon e transmetimeve të drejtpërdrejta (live streaming) të premier ligës angleze në Bosnjë dhe Hercegovinë, duke imponuar një numër minimal të obligueshëm të parapaguesve në Kontratën për shpërndarjen e kanaleve të Sport Klub të dakorduar me operatorët kabllorë në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kjo përfaqëson imponimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kushteve të tjera tregtare që kufizojnë konkurrencën brenda kuptimit të Nenit 10 (2) (a) të Ligjit të Konkurrencës dhe duke zbatuar kushte të ndryshme në Kontratën për shpërndarjen e Sport Klub me operatorët në Bosnjë dhe Hercegovinë, duke i vendosur ata në pozicion të pabarabartë dhe të pafavorshme konkurruese, brenda kuptimit të Nenit 10 (2) (c) të Ligjit të Konkurrencës. Këshilli i Konkurrencës i ka urdhëruar ata të harmonizojnë kontratat e shpërndarjes së Sport Klub me Ligjin e Konkurrencës, si dhe u ka shqiptuar gjobë prej 125.000 KM.

2) Në vendimin e dytë në vitin 2015, Këshilli i Konkurrencës përcaktoi që kompania "United Media Distribution SRL" G-RAL David Prapogescu, Rumani, përmes përfaqësuesit të saj Sport Klub d.o.o Sarajevë, nuk ka zbatuar vendimin e parë dhe ka vazhduar me abuzimin e pozitës dominuese. Ata u urdhëruan përsëri të ndërprisnin menjëherë këtë praktikë dhe të lidhin një kontratë shpërndarjeje me të gjithë ofruesit e interesuar në Bosnjë dhe Hercegovinë me të njëjtat kushte si kontratat e lidhura me "Total TV BH" dhe "Telemach". Duhet të përmendet se në kohën e fillimit të këtij procedure, "United Media" ishte nën kontrollin e "United media Ltd", një kompani e regjistruar në Qipro e lidhur me SBB, Telemach, Sport Klub dhe Total TV Bosnje dhe Hercegovinë. U shqiptua një gjobë në vlerë prej 250.000 KM.

3) Në vendimin e tretë në vitin 2017 u vërtetua se praktika e "United Media Distribution SRL" G-RAL David Prapogescu, Rumani, përmes përfaqësuesit të saj Sport Klub d.o.o Sarajevë, duke vonuar qëllimisht dhe duke refuzuar të nënshtrohet kontratën për shpërndarjen e kanalit Sport Klub me BH Telecom. Ata vazhdimisht vendosnin, gjatë negociatave, kushte shtesë që nuk ishin të përshkruara nga Kushtet e përgjithshme dhe kushtet për ofrimin e shërbimit, të cilat nuk ishin përmbushur nga kompanitë që tashmë kishin kontrata shpërndarjeje për kanalit në fjalë, duke kufizuar kështu tregun përkatës në dëm të përdoruesve të BH Telecom. U shqiptua një gjobë në vlerë prej 250.000 KM.

3. KROACI

Ka pasur një numër të vogël të rasteve në të cilat ofruesit e shërbimeve mediatiqe kanë aplikuar për tender, por AEM HR përcaktoi se ekziston një rast i kufizimit të përqendrimit. Tenderi është anuluar dhe ofruesi i shërbimit mediatic zgjidhi problemin dhe aplikoi përsëri për tender. Rasti i përqendrimit midis broadbendit të Sll-ovenisë srl dhe Nova TV dd. Sllovenia Broadband nuk arriti të merrte miratim nga AEM HR dhe Agjencia e Konkurrencës nuk e miratoi përqendrimin.

4. KOSOVË*

Çështjet e pluralizmit/pronësisë së mediave merren parasysh gjatë procesit të licencimit nga KPM, ndërsa nuk ka pasur raste për të cilat do të kishte qenë e nevojshme të merrej vendim nga autoritetet e tjera, përkatësisht nga Autoriteti i Konkurrencës.

5. MALI TË ZI

Vendimet e AEM ME

Pas shqyrtimit të gjithë informatave dhe deklaratave të transmetuesit, në rastin e ndërmarrjes "Jumedia Mont" d.o.o, Drejtori i AEM ME lëshoi mori vendim më 18 qershor 2013, i cili vërtetonte ekzistencën e përqendrimit të paligjshëm të medias për shkak të pronësisë së tërthortë të pronarit të kësaj kompanie si transmetues rajonal i medias elektronike "Radio D" dhe medias së shkruar ditore "Dan", në rastet e:

- pronësisë së Mladen Milutinovic (pronar i transmetuesit) në kapitalin aksionar të "MD Company" d.o.o, transmetuesit rajonal të medias elektronike "Radio D plus", i cili arriti në 50%, dhe;
- pronësisë së Slavica Jovanović dhe Vojin Jovanović (pronarët e transmetuesit), si të afërm në vijën e drejtpërdrejtë të shkallës së parë të farefisnisë, në kapitalin aksionar të kompanisë "MD Company" d.o.o, transmetuesi rajonal i medias elektronike "Radio D Plus ", e cila e vetme arrinte 25%, dhe së bashku 50%.

Me Vendimin në fjalë, ndërmarrja "Jumedia Mont" d.o.o u udhëzua të harmonizonte strukturën e pronësisë brenda 3 muajve në mënyrë që të eliminonte përqendrimin e paligjshëm të medias në mënyrë që pjesa e Mladen Milutinović dhe pjesa e përbashkët e Slavica Jovanović dhe Vojin Jovanović, si të afërmit në vijën e drejtpërdrejtë të shkallës së parë të farefisnit, në kapitalin aksionar të kompanisë "MD Company" d.o.o të mos e kalonin 30%.

Në atë mënyrë, struktura e pronësisë sipas neneve 132 dhe 133 të Ligjit për Media Elektronike do të harmonizohet. Respektivisht, neni 132, pika 3) përcakton, mes tjerash, se ekziston një përqendrim i paligjshëm i medias kur një transmetues radiofonik ose televiziv i autorizuar për të transmetuar me mbulim lokal ose rajonal merr pjesë në kapitalin aksionar të një transmetuesi tjetër me mbulim rajonal ose lokal në të njëjtën zonë me më shumë se 30%. Veç kësaj, neni 133 i të njëjtit ligj përcakton se përqendrimi i paligjshëm i medias ekziston edhe kur, si në rastin e referuar, një person fizik i cili është themeluesi i transmetuesit ose personat që janë të afërmit e tij/saj në linjë të drejtpërdrejtë deri në shkallën e dytë e farefisnisë ose personat në lidhje bashkëshortore marrin pjesë në kapitalin aksionar të një transmetuesi tjetër ose themeluesit të një mediumi të shtypit ditor ose agjencisë së lajmeve përmes një shume të caktuar të kapitalit aksionar.

Kompania "Jumedia Mont" d.o.o nga Podgorica paraqiti një ankesë kundër Vendimit të lëshuar dhe kërkoi anulimin e tij sepse, sipas vlerësimit të tyre, ai nuk ishte i bazuar në fakte të vërtetuara si duhet dhe plotësisht, në dispozitat e të drejtës ma-

teriale, Ligjit për Media Elektronike dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Duke vepruar në bazë të ankesës në fjalë, Këshilli i AEM ME vendosi që procedura që i paraprinte vendimit në shkallën e parë ishte kryer siç duhet dhe se Vendimi ishte i saktë dhe i bazuar në ligj, dhe se ankesa ishte e pabazuar. Prandaj, udhëzoi kompaninë "Jumedia Mont" d.o.o nga Podgorica të harmonizonte strukturën e pronësisë brenda tre muajve në mënyrë që të eliminonte përqendrimin e paligjshëm të medias. Transmetuesi paraqiti një padi në Gjykatën Administrative, e cila më vonë u hodh poshtë, dhe Gjykata Administrative mori vendim për pezullimin e procedurës.

Në anën tjetër, brenda afatit kohor të caktuar nga Këshilli i Agjencisë, transmetuesi informoi AEM ME se themeluesit e tij dhe themeluesit e kompanisë "MD Company" vendosën të ndryshojnë strukturën e pronësisë së "MD Company" për eliminimin e përqendrimit të paligjshëm të medias për shkak të pronësisë së tërthortë të pronarëve të të dy kompanive dhe se stuktura e pronësisë së ndërmarrjes "Jumedia Mont" d.o.o mbetej e pandryshuar.

Në përputhje me këtë që u tha më lart, pas marrjes së aprovimit nga Këshilli i AEM ME në lidhje me ndryshimin e dukshëm në strukturën e pronësisë së kompanisë "M.D. Company" d.o.o, 50% e aksioneve të themeluesit Mladen Milutinov nga Podgorica u transferua te Ljiljana Martinovic, dhe 25% të aksioneve të secilit themelues Slavica Jovanović dhe Vojin Jovanović u transferuan te Dejan Ražnatović nga Podgorica, i cili fitoi kështu 50% të aksioneve në kapitalin themelues.

Duke iu referuar "MD Company" d.o.o, pasi ishin shqyrtuar të gjitha informatat dhe deklaratat përkatëse të transmetuesit, Drejtori i AEM ME lëshoi një Vendim më 18 qershor 2013, i cili vërtetonte ekzistencën e një përqendrimi të paligjshëm të medias për shkak të pronësisë së tërthortë të pronarit të "M.D Company" d.o.o, si transmetues rajonal i medias elektronike "Radio D Plus" në rastet e:

- pronësisë së Mladen Milutinovic (pronar i transmetuesit) në kapitalin aksionar të "Jumedia Mont" d.o.o, transmetuesi rajonal i mediumit elektronik "Radio D" dhe publikuesi shtypit ditor "Dan", që arrinin 50%, dhe;
- pronësisë së Slavica Jovanović dhe Vojin Jovanović (pronari i transmetuesit), si të afërm në vijën e drejtpërdrejtë të shkallës së parë të farefisnisë, në kapitalin aksionar të kompanisë "Jumedia Mont" d.o.o, transmetuesi rajonal i medias elektronike "Radio D" dhe botuesi i gazetës ditore "Dan", që i vetëm arrinte 25%, dhe së bashku 50%.

Me Vendimin në fjalë, kompania "M.D. Company" d.o.o udhëzohej të harmonizonte strukturën e pronësisë brenda tri muajve në mënyrë që të eliminonte përqendrimin e paligjshëm të medias në mënyrë që pjesa e Mladen Milutinović dhe pjesa e përbashkët e Slavica Jovanović dhe Vojin Jovanović, si të afërmit në vijën e drejtpërdrejtë të shkallës së parë të farefisit, në kapitalin aksionar të kompanisë "Jumedia Mont" d.o.o të mos e kalonin 30%. Duke vepruar në bazë të ankesës në fjalë, Agjencia vendosi që procedura që i paraprinte vendimit në shkallën e parë ishte kryer siç duhet dhe se Vendimi ishte i saktë dhe i bazuar në ligj, dhe se ankesa ishte e pabazuar. Prandaj, udhëzoi kompaninë "Jumedia Mont" d.o.o nga Podgorica të

harmonizonte strukturën e pronësisë brenda tre muajve në mënyrë që të eliminonte përqendrimin e paligjshëm të medias.

Transmetuesi prapë paraqiti ankesë në Këshillin e AEM Me kundër vendimit të shkallës së parë dhe kërkoi anulimin e tij sepse, sipas vlerësimit të tyre, ai nuk ishte i bazuar në fakte të vërtetuara si duhet dhe plotësisht, në dispozitat e të drejtës materiale, Ligjit për Media Elektronike dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Duke vepruar në bazë të ankesës në fjalë, Këshilli i AEM ME vendosi që procedura që i paraprinte vendimit në shkallën e parë ishte kryer siç duhet dhe se Vendimi ishte i saktë dhe i bazuar në ligj, dhe se ankesa ishte e pabazuar. Kështu, ai udhëzoi kompaninë "M.D Company" d.o.o nga Podgorica të harmonizonte strukturën e pronësisë brenda tre muajve në mënyrë që të eliminonte përqendrimin e paligjshëm të medias.

Për ta anuluar vendimin e shkallës së dytë, transmetuesi paraqiti padi në Gjykatën Administrative, e cila më vonë u hodh poshtë, dhe Gjykata Administrative mori vendim për pezullimin e procedurës.

Siç është thënë tashmë, brenda afatit kohor të caktuar për eliminimin e një përqendrimi të paligjshëm të medias, transmetuesi ka filluar procedurën për marrjen e miratimit nga Këshilli i AEM ME në lidhje me ndryshimin e rëndësishëm të strukturës së pronësisë. Respektivisht, pronarët e këtij transmetuesi kanë vendosur që t'ua transferojnë pronësinë e tyre tërësisht personave të tjerë dhe kështu të eliminojnë përqendrimin e paligjshëm të medias. Pas marrjes së aprovimit nga Këshilli i AEM ME struktura e pronësisë së "M.D. Company" d.o.o. ka ndryshuar në atë mënyrë që 50% e aksioneve të themeluesit Mladen Milutinov nga Podgorica u transferua te Ljiljana Martinovic, dhe 25% të aksioneve të secilit themelues Slavica Jovanović dhe Vojin Jovanović u transferuan te Dejan Ražnatović nga Podgorica, i cili fitoi kështu 50% të aksioneve në kapitalin themelues ⁸⁷.

Procedura për përcaktimin e përqendrimit të paligjshëm të mediave u iniciua, në lidhje me pronësinë e tërthortë të pronarëve, personave fizikë Zheljko Ivanović, Katarina Perović dhe Ljubiša Mitrović si themelues të ndërmarrjes "Televizija Vijesti" d.o.o (transmetues i "Radio Vijesti" dhe "Televizija Vijesti"), në kapitalin aksionar të ndërmarrjes "Daily Press" d.o.o, si themelues i medias së gazetës së përditshme "Vijesti".

Ndonëse transmetuesi fillimisht kishte kundërshtuar arsyetimin për kryerjen e procedurës, ai kërkoi një zgjatje të afatit për dhënie të deklaratës në mënyrë që të shqyrtonte më për së afërmi të gjitha aspektet e rëndësishme të këtij rasti. Më 25 qershor 2013, kompania "Televizija Vijesti" d.o.o informoi AEM ME se po bëheshin ndryshime në strukturën e pronësisë së këtij transmetuesi dhe me atë rast, u kërkua një afat shtesë kohor për dorëzimin e informatave që do të shqyrtoheshin (pasi ato mund të ndikojnë në rezultatin) kur vendoset në procedurën e rastit për vërtetimin e ekzistencës së përqendrimit të paligjshëm të medias. Bazuar në kërkesën e paraqitur, duke marrë parasysh rëndësinë e deklaratës së subjektit, si dhe faktin se ishte e nevojshme kohë shtesë për përgatitjen e saj, AEM ME ia zgjati afatin kohor për dorëzimin e deklaratave kompanisë "Televizija Vijesti" d.o.o.

87 Vendimi Nr. 01- 897/1 i datës 27.09.2013

Ndërkohë, transmetuesi filloi procedurën për marrjen e miratimit nga Këshilli i AEM ME në lidhje me një ndryshim të rëndësishëm në strukturën e pronësisë për shkak të transferimit të aksioneve të kapitalit të "Televizija Vijesti" d.o.o nga anëtarët Miodrag Perović në shumën prej 6.54% dhe Katarina Perović në shumën prej 6.68% të Andrej Perović nga Podgorica, aksionet totale të të cilëve në Kompani, pas këtyre ndryshimeve, arrinin në 13.22%.

Këshilli i AEM ME vendosi të miratojë ndryshimin e planifikuar të strukturës së pronësisë, pas zbatimit të të cilit transmetuesi paraqiti informacionin mbi strukturën e re të pronësisë. Në bazë të kësaj, u përcaktua që Zheljko Ivanović, Katarina Perović dhe Ljubiša Mitrović nuk kishin aksione pronësie në kapitalin e kompanisë "Televizija Vijesti" d.o.o sepse ata i kishin transferuar aksionet e tyre të pronarët e tjerë (Miro Perović, Slavoljub Šćekić) ose pronarë të rinj (Andrej Perović).

Pasi u vërtetua që pas ndryshimit të strukturës së pronësisë nuk kishte asnjë pronësi të tërthortë në transmetuesin "Televizija Vijesti" d.o.o dhe botuesin e gazetës ditore "Daily Press" d.o.o, Drejtori i AEM ME lëshoi një Konkluzion për pezullimin e procedurës për vërtetimin e ekzistencës së përqendrimit të mediave të paligjshme.

6. MAQEDONI E VERIUT

Vendimet e AVMU-s

AVMU merr parasysh mbrojtjen e pluralizmit të mediave kur jep licencat. Para se të shpallet një konkurs për dhënien e licencës për transmetim televiziv ose radio përmes një burimi të kufizuar, AVMU është e detyruar që së pari të kryejë një studim për të përcaktuar nëse shpallja e një konkursi të tillë është e justifikuar, në drejtim të përmbushjes së objektivave të legjislacionit që lidhet me mediat, dhe sa i përket nevojave të audiencës.

Këto studime përfshijnë:

1. një analizë ekonomike (analiza e tregut përkatës, vlerësimi i përqendrimit në treg dhe analiza e investimit të mundshëm);
2. një analizë të ofertës ekzistuese të medias (analiza e formateve të shërbimeve të programit, gjuhës së transmetimit, përmbajtjes së programit të ofruar sipas zhanrit) dhe nëse ajo transmeton në nivelet shtetërore ose rajonale;
3. një analizë të nevojave të audiencës (përmes një sondazhi të audiencës, i cili siguron informacion nëse audienca është e kënaqur me ofertën e stacioneve televizive vendase dhe deri në çfarë mase, cilat përmbajtje programore mungojnë nga oferta programore e stacioneve televizive vendore dhe të dhëna në lidhje me qëndrimin e audiencës në lidhje me cilësinë e përmbajtjes së programit të ofruar).

Që nga viti 2014, janë kryer gjithsej 13 studime të tilla, tri për dhënien e licencave të transmetimit televiziv dhe dhjetë për dhënien e licencave të transmetimit të radios.

Kur jep leje, AVMU gjithashtu merr parasysh pluralizmin e pronësisë së medias, d.m.th përcakton nëse kandidati në konkurs i plotëson kushtet për fitimin e pronësisë. AVMU e bën këtë duke marrë të dhëna nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut për të gjitha ndërmarrjet tregtare në pronësi të kandidatit. AVMU nuk jep licencë nëse vërtetohet se kandidati ka në pronësi media të tjera deri në atë shkallë që tejkalojnë pragjet e përcaktuara në ligj, ose që kandidati është pronar i një botuesi të medias së shkruar që boton një gazetë ditore në zonën ku programi do të transmetohej; një agjenci lajmesh; një kompani reklamash dhe marketingu; një kompani për shpërndarjen e punëve audiovizive; një kompani për prodhimin e filmit; një operator të rrjeteve të komunikimit elektronik që siguron ritransmetimin ose transmetimin e programeve radio/televizive, ose një kompani që kryen studime të tregut dhe sondazhe të opinionit publik.

Në vitin 2019, AVMU mori gjithsej gjashtë vendime që miratojnë ndryshimin e pronësisë së pesë radio stacioneve dhe një stacioni televiziv dhe një vendim që ndalon ndryshimin e planifikuar në strukturën e pronësisë së një radio stacioni, pasi kishte arritur në përfundimin se kjo do të çonte në krijimin e paligjshëm përqendrimi mediatik.

Po atë vit, AVMU shqiptoi masa ndaj dy transmetuesve (një televizion dhe një radio) për ndryshimin e strukturës së tyre të pronësisë pa njoftuar më parë AVMU ose kërkuar aprovimin për ndryshimin.

Në një nga seancat e tij në shkurt 2019, Këshilli i AVMU diskutoi fillimin e një procedure kundër një stacioni televiziv në mënyrë që të konstatonte një shkelje të dispozitës së ligjit nga ana e këtij të fundit, sipas së cilës, mbajtësit e funksioneve publike dhe anëtarët e familjeve të tyre nuk mund të kryenin veprimtarinë e transmetimit dhe as nuk mund të ishin themelues, bashkëthemelues ose të merrnin hise në pronësinë e një subjekti transmetues. Arsyeja për këtë ishte fakti që bashkëshortja e njërit prej pronarëve të këtij stacioni televiziv ishte emëruar në një zyrë publike nga Parlamenti i Maqedonisë. Të njëjtën ditë kur po mbahej seanca (agjendat e seancave të Këshillit janë publike dhe publikohen në uebfaqen e AVMU dhe profilin e saj në Facebook të paktën 24 orë para se të mbahen seancat), ky stacion televiziv informoi AVMU-në se një ditë më parë, gruaja e pronarit të stacionit televiziv kishte paraqitur dorëheqje të parevokueshme nga zyra publike (vetëm shtatë ditë pas emërimit të saj). Parlamenti maqedonas pranoi dorëheqjen e saj dhe mandati i saj si zyrtare publike pushoi, duke hequr kështu shkakun për shkeljen e ligjit.

Disa muaj më vonë, AVMU filloi një procedurë kundër të njëjtit stacion televiziv për të vërtetuar nëse ai kishte shkelur ndalimin e një partneri të pazbuluar, pasi një partner i panjohur nuk mund të merrte pjesë në pronësinë e një transmetuesi përmes kontributit të kapitalit monetar ose jomonetar. Procedura u iniciua sepse një person i cili, sipas dokumentacionit zyrtar, nuk zotëronte asnjë hise të këtij stacioni televiziv, ishte prezantuar si pronari i tij. AVMU ndërmori një varg aktivitete për të siguruar prova materiale përkatëse në mënyrë që të mund të shqyrtonte plotësisht nëse gjetjet që nënkuptojnë shkeljen e ndalimit të një partneri të pazbuluar ishin të bazuara. Sidoqoftë, licenca e këtij stacioni televiziv u revokua për arsye të tjera para përfundimit të procedurës së lartpërmendur.

AVMU po ashtu filloi një procedurë për vërtetimin e përqendrimit të paligjshëm të medias në rastin e një radio stacioni, sepse kishte gjetur se menaxheri i personit juridik që zotëronte këtë radio stacion ishte edhe pronar i një kompanie që shpërndante programe filmike, video dhe televizive. Sipas ligjit, AVMU kërkoi që ky radio stacion të paraqiste të gjitha dokumentet përkatëse për marrjen e vendimit. Në vend që të paraqiste ndonjë dokument, radio stacioni informoi AVMU-në, se pas fillimit të procedurës nga ana e AVMU, personi në fjalë ishte hequr nga pozita udhëheqëse.

7. SERBI

REM nuk lëshon licencë për ofrimin e shërbimeve mediatike nëse përcakton se kjo do të çonte në shkelje të pluralizmit të mediave në kuptim të ligjit që rregullon informacionin publik dhe mediat.

Sipas nenit 82 të Ligjit për Media Elektronike, aplikimi për licencë përfshin, mes tjerash:

- informata mbi strukturën e pronësisë së aplikuesit, përfshirë informata mbi personin juridik (emri, selia dhe struktura e pronësisë) ose personin fizik (emri, vendbanimi dhe shtetësia), të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përmes subjekteve të tjera, marrin pjesë (kanë aksione, etj.)) në strukturën e pronësisë së aplikuesit, si dhe informata mbi përqindjen e asaj pjesëmarrjeje;
- një deklaratë që dhënia e licencës nuk do të krijojë një gjendje që shkel pluralizmin e medias

REM tërheq licencën për të ofruar një shërbim mediatik nëse, për shkak të një ndryshimi në strukturën e pronësisë së ofruesit të shërbimit mediatik, pas lëshimit të licencës, nuk është e mundur të përcaktohet me besueshmëri se kush ka kontroll mbi ofruesin e shërbimit mediatik brenda kuptimit të ligjit që rregullon fushën e mbrojtjes së konkurrencës (neni 89, paragrafi 1, pika 9) Ligji për Media Elektronike).

Vendimet e REM

Një licencë e lëshuar në një konkurs publik nuk mund të transferohet, përveç në rastin e ndryshimeve të statusit të mbajtësit të licencës, në kuptim të ligjit që rregullon statusin e kompanive dhe me kusht që kjo të mos dëmtojë pluralizmin e medias në lidhje me rregulloret që drejtojnë mediat dhe informimin publik.

Licenca e lëshuar me kërkesë mund t'i transferohet një personi tjetër vetëm nëse ai person pranon të gjitha detyrimet që dalin nga licenca.

Transferimi mund të ndodhë vetëm nëse është bërë me shkrim dhe me pëlqim paraprak nga Rregullatori.

Çdo ndryshim në strukturën e pronësisë në kapitalin aksionar (d.m.th., ndryshim i themeluesit ose ndryshim në përqindjen e pjesëmarrjes së themeluesit në kapital) duhet t'i raportohet Rregullatorit paraprakisht me shkrim.

Nëse REM përcakton se ndryshimet e planifikuara në strukturën e pronësisë të pjesëmarrjes në kapitalin aksionar mund të krijojnë një gjendje që shkel pluralizmin e medias, ai do t'i rekomandojë mbajtësit të licencës për ofrimin e shërbimit mediatik që të përshtatë ndryshimet në atë mënyrë që të shmangë situatë.

Nëse i Licencuari për ofrimin e shërbimit mediatik nuk respekton rekomandimin e REM, gjë që shkakton disa nga rastet e parashikuara ligjërisht të shkeljes së pluralizmit të medias, REM ia revokon licencën në përputhje me dispozitat e Ligjit për Media Elektronike.

REM publikon të gjitha vendimet në lidhje me pluralizmin e mediave në uebsajt. Kjo përfshin si miratimet e ndryshimeve të pronësisë ashtu edhe rastet kur REM heq licencën.

Vendimet e autoriteteve të tjera

Komisioni i Përqendrimit ka për detyrë të marrë vendim për njoftimin e përqendrimit brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit të plotë, dhe praktika gjyqësore përkatëse e këtij organi është në dispozicion këtu dhe këtu.

Shtojca 3:

Masat legislative të parashikuara

1. BOSNJË DHE HERCEGOVINË

Siç është përmendur në Tabelën 1: Pikëpamjet e palëve të interesuara, ekziston një projektligj për transparencën e pronësisë së mediave, i cili është hartuar nga një konsorcium i organizatave joqeveritare, por ecuria e tij legislative nuk është e sigurt për momentin.

Ministria e Komunikimit dhe Transportit e Bosnje dhe Hercegovinës ka formuar një Grup Punues të ngarkuar me hartimin e ligjeve për komunikimet elektronike dhe mediat elektronike. Sipas Ministrisë, ky projektligj ishte parashikuar të mbulonte fushën e transparencës së pronësisë së medias dhe të kufizonte përqendrimin e pronësisë së medias, por nuk do të mbulonte mediat e shkruara. CRA ka propozuar, përmes angazhimit të saj në grupin e sipërpërmendur të punës, përgjegjës për hartimin e ligjeve për komunikimet elektronike dhe mediat elektronike, krijimin e një fondi të pluralizmit të medias, por ende nuk është marrë vendim për këtë çështje.

Përveç punës për hartimin e ligjit për komunikimet elektronike dhe mediat elektronike, i cili parashikohet të përfshijë disa dispozita të përgjithshme që transpozojnë pjesërisht AVMSD-në e rishikuar (si dhënia e përgjegjësive CRA-së për rregullimin e platformave të ndarjes së videove), CRA aktualisht po rishikon kornizën e saj rregullatore për të zbatuar dispozitat e mbetura të AVMSD. Sipas regjistrimit të CRA, Bosnja dhe Hercegovina ka një numër të madh të transmetuesve radio dhe televizivë: 3 transmetues të shërbimit publik, 38 stacione televizive në transmetime tokësore (analoge), 62 stacione televizive që transmetojnë përmes rrjeteve të tjera të komunikimit - kabllor, DTH, IPTV dhe 152 radio stacione. Megjithatë, numri i madh i transmetuesve dhe disponueshmëria e përmbajtjes mediatike në të gjitha nivelet nga ato lokale në ato kombëtare vetëm krijojnë iluzionin e pluralizmit mediatik dhe larminë e përmbajtjes mediatike. Raporte të shumta tregojnë se ekziston një polarizim i mediave që pasqyrojnë ndarjen politike të shtetit dhe se mediat kryesisht ofrojnë informata paragjyquese dhe të njëanshme në shërbim të elitave politike e jo të interesit publik. Është theksuar se mungesa e një kornize ligjore për pronësinë e mediave dhe ndalimi i përqendrimit të mediave mund të çojë në raste të përqendrimit të konsiderueshëm të medias, d.m.th., në pronësi të shumëfishtë ose të përzier, e cila mund të paraqesë kërcënim të mundshëm ndaj pluralizmit të medias

dhe konkurrencës së drejtë dhe të hapur të tregut. Kjo gjithashtu mund të paraqesë problem për sigurimin e së drejtës për lirinë e shprehjes. Po ashtu është e nevojshme të kihet parasysh zhvillimet e mundshme në të ardhmen në skenën mediatike, si privatizimi i transmetuesve lokalë, shfaqja e lojtarëve të rinj përmes procesit të televizionit digjital, e në veçanti hyrja e korporatave mediatike ndërkombëtare në tregun e komunikimeve të Bosnjës dhe Hercegovinës. E gjithë kjo mund të ndryshojë ndjeshëm peizazhin e mediave në Bosnjë dhe Hercegovinë.

2. KROACI

Përgatitja e Ligjit të ri për Media Elektronike është në proces. Akti ishte në konsultime publike në periudhën shkurt-mars 2020. Megjithatë, puna u ngadalësua për shkak të pandemisë së koronavirusit dhe më pas Parlamenti Kroat miratoi një vendim për shpërbërjen e tij më 18 maj 2020. Projektligji aktualisht është në procedurë parlamentare. Sugjerimet e pikave në lidhje me pronësinë janë:

Neni 61

1) Ofruesit e shërbimeve mediatike janë të obliguar të dorëzojnë në Agjencinë e Mediave Elektronike të dhënat për personin juridik dhe selinë, d.m.th., emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e përhershëm të të gjithë personave juridikë dhe fizikë që bëhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi zotërues të stoqeve ose aksioneve në atë ofrues të shërbimit mediatik, bashkë me të dhënat mbi përqindjen e stoqeve ose aksioneve që ata posedojnë.

(2) Ofruesit e shërbimeve mediatike janë të detyruar t'i paraqesin Agjencisë për Media Elektronike kopjet e vërtetuara të certifikatave të stoqeve ose aksioneve ose për blerjen e stoqeve ose aksioneve në atë ofrues të shërbimit mediatik gjatë vitit paraprak, si dhe një fragment nga Regjistri i pronarëve të fundit përfitues. Këto certifikatat nuk do dorëzohen për aksione ose stoqe deri në 1% të vlerës së kapitalit.

(3) Një paralajmërim me shkrim i dërgohet një ofruesi të shërbimit mediatik i cili nuk përmbushë detyrimin e përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij udhëzimi me shpjegim të sanksioneve të mundshme për mosrespektim të detyrimit.

(4) Ofruesi i shërbimit mediatik është i detyruar të publikojë në Gazetën Zyrtare çdo ndryshim në strukturën e tij të pronësisë. Të dhënat për mbajtësit e stoqeve ose aksioneve deri në 1% të vlerës së kapitalit publikohen së bashku.

(5) Ndalohet fshehja e strukturës së pronësisë së një ofruesi të shërbimit mediatik ose pronësia e mbajtësve të stoqeve ose aksioneve të një ofruesi të shërbimit mediatik përmes çfarëdo transaksioni. Transaksionet që fshehin strukturën e pronësisë së një ofruesi të shërbimit mediatik ose pronësinë e mbajtësve të stoqeve ose aksioneve në një ofrues të shërbimit mediatik janë të pavlefshme.

Neni 62

(1) Ofruesit e shërbimeve mediatike duhet të njoftojnë me shkrim autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës në treg për çdo qëllim për të realizuar një përqendrim të ndërmarrjeve, i cili plotëson kërkesat për lindjen e një detyrimi për të njoftuar synimin për të realizuar një përqendrim brenda kuptimit të rregulloreve që rregullojnë mbrojtjen e konkurrencës në treg.

(2) Ofruesit e shërbimeve mediatike të cilët kanë një koncesion dhe/ose licencë për të kryer shërbime mediatike duhet të njoftojnë me shkrim Agjencinë për Media Elektronike pa vonesë për çdo qëllim të bashkimit ose blerjes, qëllim të çdo forme tjetër të një sipërmarrjeje të përbashkët ose veprimi të bashkërenduar, dhe çdo ndryshim pronësie, pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara në rregulloret që rregullojnë mbrojtjen e konkurrencës së tregut.

(3) Me kërkesë të autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës në treg, Agjencia për Media Elektronike dorëzon opinionin e ekspertëve brenda tridhjetë ditësh nga data e marrjes së kërkesës së tillë. Nëse Agjencia nuk dorëzon opinionin e kërkuar pas skadimit të këtij afati, konsiderohet se Agjencia nuk ka kundërshtime për realizimin e përqendrimit të njoftuar të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

4) Autoriteti i ngarkuar me mbrojtjen e konkurrencës në treg vlerëson njoftimin e përqendrimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij ligji dhe merr vendim në përputhje me dispozitat e rregullave që rregullojnë mbrojtjen e konkurrencës në treg.

Neni 63

(1) Agjencia për Media Elektronike vlerëson njoftimin e përqendrimit të përmendur në nenin 62, paragrafi 2, dhe efektet e tij, në lidhje me mbrojtjen e pluralizmit dhe larmisë së mediave elektronike.

(2) Bashkimi ose blerja ose ndonjë formë tjetër e një ndërmarrjeje të përbashkët ose veprimi i bashkërenduar dhe ndryshimi i pronësisë në lidhje me mbrojtjen e pluralizmit dhe larmisë së mediave elektronike konsiderohen të palejueshme në rastet e mëposhtme:

- ofruesin e shërbimit mediatic që ka koncesion në nivel shtetëror dhe aksione që tejkalojnë 25% të kapitalit të një ofruesi tjetër të shërbimeve mediatike me mbulim të njëjtë ose më të ulët dhe anasjelltas;
- ofruesin e shërbimit mediatic që ka koncesion në nivel shtetëror dhe një pjesë që tejkalon 10% të kapitalit të publikuesit që publikon gazeta ditore të shtypura në më shumë se 3,000 kopje dhe anasjelltas;
- ofruesin e shërbimit mediatic që ka koncesion në nivel shtetëror dhe boton njëkohësisht gazeta ditore të shtypura në më shumë se 3,000 kopje;
- ofruesin e shërbimit mediatic që ka koncesion në nivel rajonal apo lokal dhe që ka aksione që tejkalojnë 30% të kapitalit të një ofruesi tjetër të shërbimeve mediatike në zënë e njëjtë, do të thotë në zonën me mbulim më të lartë ose të ulët dhe anasjelltas;
- ofruesin e shërbimit mediatic i cili ka një koncesion dhe aksione që tejkalojnë 10% të kapitalit të një personi juridik, veprimtaria e të cilit është mbledhja, formësimi dhe ndërmjetësimi në reklama, dhe anasjelltas.

(3) Kërkesat e përmendura në paragrafin 2 më lart zbatohen në mënyrë të barabartë për personat fizikë dhe juridikë që mbajnë aksione në një ofrues të shërbimit mediatic.

(4) Kërkesat e përmendura në paragrafin 2 më lart zbatohen edhe për ofruesit e shërbimeve mediatike të cilët sigurojnë transmetime satelitore, internet, ose kablore dhe mënyra të tjera të lejueshme të transmetimit, ofruesit e shërbimeve mediatike sipas kërkesës, platformat e ndarjes së videoeve, si dhe ofruesit e publikimeve elektronike.

(5) Palët e ndërlihdura brenda kuptimit të këtij ligji përcaktohen në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullojnë çështjet e përgjithshme të tatimeve.

Neni 64

(1) Nëse pjesa e audiencës së të gjitha programeve të një ofruesi të vetëm të shërbimit mediatic arrin një mesatare vjetore prej 45%, ky ofrues i shërbimit mediatic konsiderohet të ketë pozitë dominuese në tregun e Republikës së Kroacisë, duke rezultuar në prishje të pluralizmit dhe diversitetit të mediave elektronike.

(2) Nëse një ofrues i shërbimit mediatic ka fituar një pozicion dominues në treg, ai nuk mund të blejë aksione në ofruesit e tjerë të shërbimeve mediatiche, përveç atyre që tashmë mban, as nuk mund t'i jepet ndonjë koncesion dhe/ose licencë tjetër nga Këshilli i Mediave Elektronike e as nuk mund të jetë ofrues i një publikimi të ri elektronik me të cilin do të zgjeronte operacionet e tij të biznesit.

(3) Këshilli i Mediave Elektronike përcakton metodat, kërkesat dhe mjetet për llogaritjen e arritjes së pjesës së audiencës ose mbulueshmërisë së një publikimi elektronik.

Neni 65

(1) Këshilli i Mediave Elektronike nuk i jep koncesion ofertuesit më të favorshëm të zgjedhur në procedurën për dhënien e koncesionit nëse është vërtetuar se dhënia e koncesionit do të rezultonte me prishjen e pluralizmit dhe diversitetit të mediave elektronike brenda kuptimit të nenit 62, paragrafi 2 dhe nenit 64, paragrafi 2, të këtij ligji.

(2) Secili ofertues që aplikon në një tender publik për dhënien e një koncesioni është i detyruar t'i bashkëngjitë ofertës një deklaratë të vërtetuar që tregon se një dhënie e mundshme e koncesionit nuk rezulton me prishjen e pluralizmit dhe larmisë së mediave elektronike brenda kuptimit të këtij ligji.

(3) Ofruesi i shërbimit mediatic nga neni 92 i këtij ligji është i detyruar t'i bashkëngjitë së kërkesës për licencë për satelit, internet, kabull ose mënyrë tjetër të transmetimit të programit audioviziv dhe/ose radio një deklaratë që tregon se lëshimi e kësaj licence nuk rezulton me prishjen e pluralizmit dhe larmisë së mediave elektronike brenda kuptimit të këtij ligji.

Neni 66

(1) Nëse në procedurën e kryer në përputhje me nenin 62, paragrafi 2, të këtij ligji është vërtetuar se ndryshimet e ndodhura rezultojnë me prishje të pluralizmit dhe larmisë së mediave elektronike, ofruesi i shërbimit mediatic urdhërohet të konfirmojë ndryshimet, brenda një afati të përshtatshëm, në një mënyrë që nuk është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Nëse ofruesi i shërbimit mediatic dështon të respektojë urdhrin e përmendur në paragrafin 1 të këtij ligji, zbatohen dispozitat e këtij ligji në lidhje me përfundimin e vlefshmërisë së koncesionit para skadimit të periudhës për të cilën është dhënë, ose ato në lidhje me përfundimin e vlefshmërisë së licencës për satelit, internet, kabullo, ose një mënyrë tjetër të transmetimit të programit audioviziv dhe/ose radio dhe se vendimi për revokimin e koncesionit ose licencës merret nga Këshilli i Mediave Elektronike.

3. MALI TË ZI

Pritet që një Ligj i ri për Shërbimet AVM të zëvendësojë Ligjin për Media Elektronike të vitit 2010. Ligji për Media dhe Ligji për RTCG (PBS kombëtar), miratuar në vitin 2020, priten të rishikohen deri në fund të vitit 2021 dhe të miratohen së bashku me Ligjin e ri për Shërbimet AVM⁸⁸.

Ligji i ri i propozuar për Media paraqet një sërë masash për të përmirësuar disponueshmërinë dhe transparencën e të dhënave të përgjithshme të financimit publik, dhe krijon një Fond për Promovimin e Pluralizmit dhe Diversitetit të Mediave. Për më tepër, AEM ME do të vazhdojë të mbikëqyrë pronësinë e AVMS, në përputhje me Ligjin e ardhshëm AVMS. Projektligji AVMS po ashtu përmend edhe mekanizmat vetërregullues, veçanërisht për platformat e ndarjes së videove. Karakteristikat e tjera të draftit përfshijnë një ndryshim që ndan ofruesit e shërbimeve AVM sipas kërkesës nga "operatorët kabllorë" (shpërndarësit e programeve të radios dhe televizioneve për përdoruesit përfundimtarë). Risi tjetër është dispozita që saktëson që të drejtat dhe përgjegjësitë e publikimeve elektronike (uebportale) rregullohen me Ligjin për Mediat, ku ato përcaktohen si "publikime me bazë në internet". Drafti ende parashikon ekzistencën e një rregullatori të pavarur për shërbimet AVM (Agjencia e sotme për Media Elektronike do të riemërohet Agjencia për shërbimet AVM). Ai ofron një përkufizim të qartë të mandatit, financimit, funksionimit dhe menaxhimit të saj, si dhe të drejtave dhe përgjegjësi në ndjekjen e funksionit në mënyrë llogaridhënëse, transparente dhe profesionale, në përputhje me forcimin e konsiderueshëm të roleve dhe përgjegjësi të rregullatorëve të pavarur. Drafti më tej parashikon përmirësimin e procedurës për emërimin dhe shkarkimin e AEM ME dhe këshillave të transmetuesve publikë, përfshirë mundësinë e rishikimit gjyqësor të vendimeve të marra nga parlamentet përkatëse për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit, etj. AEM ME nuk është kompetente për të mbikëqyruar respektimin e standardeve profesionale nga mediat elektronike pasi këto çështje duhet të adresohen përmes vetërregullimit, sipas Ligjit për Media.

4. MAQEDONI E VERIUT

Me kërkesë të AVMU, është përgatitur një studim si pjesë e projektit JUFREX 2, për të vlerësuar nëse dispozitat ekzistuese ligjore në lidhje me pronësinë e mediave në legjislacion sigurojnë mbrojtjen e pluralizmit dhe konkurrencën e ndershme në treg, por edhe zhvillimin e tregut, ose nëse ato dispozita janë tashmë të vjetruara dhe tepër kufizuese në kushtet e mjedisit digjital, d.m.th., nëse veçse përbëjnë pengesë për zhvillimin e tregut. Studimi më tej ofron udhëzime në lidhje me kufizimet e reja të mundshme të pronësisë dhe pragjet për përcaktimin e përqendrimit të paligjshëm të medias, si dhe në lidhje me refuzimin ose zbutjen e mundshme të disa prej kufizimeve ekzistuese. AVMU do t'ia paraqesë studimin ministrisë kompetente në mënyrë që të marrë parasysh gjetjet kur harton rregulloret.

88 Burimi: Drafti i Planit të Punës së Qeverisë së Malit të Zi për 2021, në dispozicion në: https://gsv.gov.me/spi/Program_rada_Vlade.

Bibliografia dhe Burimet

- Neni 11 - Liria e shprehjes dhe informimit për Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, në dispozicion në: <https://fra.europa.eu/en/eu-charter/article/11-freedom-expression-and-information>
- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare për pluralizëm medial dhe transparencë të pronësisë së mediave: gjendet në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=0900001680790e13
- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare për rolin dhe përgjegjësitë të pronësisë së ndërmjetësve në internetit gjendet në: https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=0900001680790e14
- Deklaratat e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nga 13 shkurti 2019 për qëndrueshmërinë e gazetarisë cilësore në epokën digjitale, gjendet në: https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=090000168092dd4d
- Deklaratat e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nga 13 shkurti 2019 për aftësitë manipuluese të proceseve algoritmike, gjendet në: https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?ObjectId=090000168092dd4b
- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare për masat për të promovuar të pronësisë së mediave: gjendet në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016804fa377
- Studim i Këshillit të Evropës: “Pluralizmi i pronësisë së mediave në mjediset e reja të mediave”, Gjendet në: <https://www.coe.int/en/web/skopje/-/pluralism-of-media-ownership-in-the-new-media-en> Environment-new-study-published
- Publikim i Këshillit të Evropës: “Autoritetet rregullatore të mediave dhe mbrojtja e të miturve, në dispozicion në: <https://rm.coe.int/media-regulatory-authorities-and-protection-of-minors/1680972898>
- Studimi i shoqërisë civile kroate: “Uska grla lokalnih radija u Hrvatskoj”, gjendet në: https://www.gong.hr/media/uploads/20140212_analiza_uska_grla_lokalnih_radija_u_hrvatskoj_finalno.pdf
- Pakoja e Aktit të Shërbimeve Digjitale, përfshirë Aktin e Shërbimeve Digjitale (DSA) dhe Aktin e Tregjeve Digjitale (DMA), i disponueshëm në: <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/digital-services-act-package>
- Direktiva (BE) 2018/1808 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 14 nëntorit 2018 që ndryshon Direktivën 2010/13/EU për bashkërendimin e disa dispozitave të

përcaktuara me ligj, rregullore ose veprime administrative në shtetet anëtare në lidhje me dispozitën e shërbimit medial audiovizuel (Direktivë e Shërbimit Medial Audiovizuel) sa i përket ndryshimit të realiteteve të tregut, në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2018/1808/oj>

Raportet dhe referencat e Komisionit Evropian për pluralizmin e mediave, të disponueshme në: <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/policies/media-freedom-and-pluralism>

Agjenda Digjitale e Komisionit Evropian 2010, e disponueshme në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0245:FIN:EN:PDF>

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, gjendet në:

https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf.

Standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me nenin 10 - E drejta për Lirinë e Shprehjes e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në dispozicion në: <https://rm.keshilli.it/Evropes.int/16806da515>

Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias (CMPF) Media Pluralism Monitor (MPM), në dispozicion në: <https://cmpf.eu.europa.eu/media-pluralism-monitor/>

Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian për forcimin e përmbajtjes evropiane në ekonominë digjitale, 2018, në dispozicion në: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52018XG1219\(01\)&from=GA](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52018XG1219(01)&from=GA).

Plani i veprimit i KE kundër dezinformimit, maj 2018, në dispozicion në: https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/54866/action-plan-against-disinformation_en

Kodi i Praktikës i KE për dezinformimin, i disponueshëm në: <https://ec.europa.eu/digital-single-market/news-redirect/660940>

Kollokiumi i KE për të Drejtat Themelore kushtuar Pluralizmit dhe Demokracisë në Media, 2016, në dispozicion në: https://ec.europa.eu/newsroom/just/item-detail.cfm?item_id=31198.

Agjenda Digjitale e KE 2010, e disponueshme në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0245:FIN:EN:PDF>.

Raporti i Grupit të Rregullatorëve Evropianë për Media Audiovizive (ERGA) për aktivitetet e kryera për të ndihmuar Komisionin Evropian në monitorimin e përkohshëm të Kodit të praktikës kundër dezinformimit, i disponueshëm në: https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2019/06/ERGA-2019-06_Report-in-termediate-monitoring-Code-of-Practice-on-disinformation.pdf

Raporti i ERGA për dezinformimin: Vlerësimi i zbatimit të Kodit të Praktikës, i disponueshëm në: <https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2020/05/ERGA-2019-report-published-2020-LQ.pdf>

Vjetari i Vëzhguesit Evropian Audiovizual 2019/2020, trendët kryesorë, gjendet në: <https://rm.coe.int/yearbook-keytrends-2019-2020-en/16809ce58d>

Evens, Tom dhe Donders, Karen (2018) Fuqia dhe politika e platformës në transformimin e tregjeve televizive. Palgrave Global Media Policy and Business. Referenca gjithashtu gjendet në hyrje të dokumentit EPRA: Përafrimi i qasjeve rregullatore me ato të tregut: Kuptimi i trendëve kryesorë të tregut, 2020. në dispozicion në:

https://cdn.epra.org/attachments/files/3672/original/Understanding_market_trends_introductory_paper.pdf?1589806403

Projekti i financuar nga BE në Bosnjë dhe Hercegovinë: “Mediat dhe Reputacioni Publik” me qëllim për të promovuar transparencën e pronësisë së mediave dhe format legjitime të financimit dhe reklamimit të mediave në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjendet në: <https://europa.ba/wp-content/uploads/2017/11/transparency-ownership-financing-media-eng.pdf>

I. Berlin, “Two Concepts of Liberty”, in Four Essays on Liberty, Oxford 1969. Cf. W. Galston, Liberal Pluralism, Cambridge 2002, p. 6, available at: https://cactus.dixie.edu/green/B_Readings/I_Berlin%20Two%20Concepts%20of%20Liberty.pdf

Deklaratë e përbashkët e presidentit të autoritetit rregullator francez CSA, Roch-Olivier Maistre dhe drejtorit të autoritetit rregullator gjerman DLM, Tobias Schmid, në favor të një rregulloreje të re evropiane, gjendet në: <https://www.csa.fr/Informer/Espace-presse/Interventions-publiques/Tribune-commune-de-Roch-Olivier-Maistre-et-Tobias-Schmid-en-faveur-d-une-nouvelle-regulation- evropian>

Kevin R. Davis, “John Milton”, gjendet në: <https://www.mtsu.edu/first-amendment/article/1259/john-milton>

Monitoruesi i Pluralizmit të Mediave 2020, në dispozicion në: <https://cmpf.eu.eu/mpm2020-results/>

Mill, J.S., On Liberty. Indianapolis: Hackett Publishing.1978.

Analiza e Institutit të Mediave të Maqedonisë së Veriut: “Roli i Autoriteteve Rregullatore në Formësimin e Pluralizmit Struktural në Sektorin Audiovizual në Maqedoni, Kroaci dhe Mal të Zi”, në dispozicion në: https://mim.org.mk/attachments/article/1093/Analiza_Ulogata%20na%20regulatornrite%20tela%20vo%20oblikuvanjeto%20na%20strukturiniot%20pluralizam%20vo%20TV%20sektorot.pdf

Studimi i Agjencisë së Maqedonisë së Veriut për Shërbime të Mediave Audio dhe Audiovizive “Pluralizmi politik gjatë një fushate elektorale”, në dispozicion në: https://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Politickiot_pluralizam_zavreme_na_izborna_kampanja.pdf

Agjencia e Maqedonisë së Veriut për Shërbime të Mediave Audio dhe Audiovizive Strategjia për Zhvillimin e Industrisë së Mediave Audio dhe Audiovizive 2019-2023, në dispozicion në: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2019/03/Regulatornata-strategija-za-periodot-od-2019-do-2023-godina.pdf>

Vendimi i Agjencisë së Maqedonisë së Veriut për Shërbime të Mediave Audio dhe Audiovizive për të dhënë ndihmë financiare, në dispozicion në: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2020/03/Odлуka-za-dodeluvanje-finansiska-pomos-donacija-koronavirus.pdf>

Lajmet dhe informacioni i Ofcom UK rreth COVID-19: konsumi dhe qëndrimet, Rezultatet nga javët një deri në tre të sondazhit në internet të Ofcom, prill 2020, në dispozicion në:

https://www.ofcom.org.uk/__data/assets/pdf_file/0031/194377/covid-19-news-consumption-weeks-one-to-three-findings.pdf

Raphael Satter, "Lajmet e rreme (deepfake) të përdorura për të sulmuar një çift aktivist tregon kufirin e ri të dezinformimit", në dispozicion në: <https://www.reuters.com/article/us-cyber-deepfake-activist/deepfake-used-to-attack-activist-couple-shows-new-disinformation-frontier-idUSKCN24G15E>.

Raporti i lajmeve digjitale Reuters2020, në dispozicion në: <http://www.digitalnewsreport.org/>

Rezoluta për ekonominë e medias dhe pluralizmin politik dhe kulturor të miratuar në Konferencën e tretë Ministrove Evropiane për Mediat Masive në 1991,

Rezoluta për liritë gazetareske dhe të drejtat e njeriut e miratuar në Konferencën e katërt Ministrove Evropiane për Mediat Masive në 1994,

Rezoluta drejt një nocioni të ri të mediave e miratuar në Konferencën e Ministrave përgjegjës për Mediat dhe Shërbimet e reja të Komunikimit në 2009,

Rezoluta për Ruajtjen e rolit thelbësor të medias në epokën digjitale në Konferencën e Ministrave përgjegjës për Media dhe Shoqërinë e Informacionit në 2013, të gjitha në dispozicion në: <https://rm.coe.int/16806461fb>

Thomas Poell, University of Amsterdam, David Nieborg, University of Toronto, Jose van Dijck, Utrecht University, "Platformisation", gjenden në:

https://www.researchgate.net/publication/337717560_Platformisation

Konventa e UNESCO-s 2005 mbi Diversitetin Kulturor, gjendet në:

<https://en.unesco.org/creativity/convention/texts>

Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit 2020, Hyrja në një dekadë vendimtare për gazetarinë, të rënduar nga koronavirusi, gjendet në: <https://rsf.org/en/2020-world-press-freedom-index-entering-decisive-decade-journalism-exacerbated-coronavirus>.

Të gjitha informacionet për kornizat ligjore dhe rregullative të Përfituesve dhe praktikave të ndërlidhura janë marrë nga pyetësi i cili është shpërndaer dhe plotësuar nga Përfituesit.

Qëllimi kryesor i këtij botimi është t'i kontribuojë të kuptuarit më të mirë të konceptit të pluralizmit mediatik, rëndësisë dhe ndërlihdjes me politikat institucionale dhe rolit kyç të autoriteteve rregullatore të mediave në këtë fushë. Botimi analizon çështjen e pluralizmit mediatik përmes prizmës së standardeve evropiane, kornizave ligjore dhe institucionale, praktikave ekzistuese dhe masave të propozuara që kanë për qëllim rritjen e diversitetit.

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu janë përgjegjësi e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merren si pasqyrim i qëndrimit zyrtar të asnjërës palë.

SH

Këshilli i Evropës është organizatë lidere e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, duke i përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të

Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ato kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është zotuar të shkëmbejë arritjet dhe vlerat e veta me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.coe.int

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës